ISSN 1857-6443

Ndryshimet
VMRO para çarjes së madhe

Fq.3

Husamedin Pasha restaurohet apo gërmohet për Shën Ilinë

Fq.4

Marrëveshja e duhur
Forum

Fq.11

www.koha.mk

Koha

Khashoggi u vra brenda konsullatës

Fq.17

E PËRDITSHME INFORMATIVE · Viti XII · Numri 3483 · e shtunë-e diel, 13-14 tetor 2018 · 9°c | 24°c · 15 DEN

FORUM

"Kurora e Artë" e Fatos Arapit

Edhe pse Mbrëmjet Strugane të Poezisë janë nga manifestimet më të njohura poetike në botë, ku vijnë dhjetëra poetë nga mbarë bota, atë vit(2008) në shtypin shqiptar për fituesin Fatos Arapi nuk u shkrua fare ose u shkrua pak! Madje ne disa krijues dhe gazetarë nga Maqedonia shprehnim habinë se si ministri shqiptar i kulturës (nëse nuk gaboj, as ambasadori i Shqipërisë në Maqedoni), nuk...

Fq.10

RAJON

Tërheqja e njohjeve, propagandë e Serbisë

Fq.16

SPECIALE

"Gastarbeiter". Erdhën për një vit, por mbetën përgjithmonë

Fq.14

INTERESIMI I TË RINJVE PËR GJUHËT E HUAJA

GJERMANISHTJA, SI MJET PUNE

Një prej kushteve kryesore që kërkohen për t'u punësuar në Gjermani, gjithsesi është njohja e gjuhës gjermane dhe ky është shkaku që interesimi për njohjen e kësaj gjuhe tashmë është bërë preokupim kryesor i të rinjve, ndërkohë që kurset private janë të stërngarkuar me ndjekës. Po rritet edhe numri i studentëve që vendosin të studiojnë gjermanishten

Fq.7

Njohje automatike e kualifikimeve akademike

Shkup, 12 tetor - Shtetet e Ballkanit Perëndimor kanë filluar bisedimet për pranimin e ndërsjellë të kualifikimeve profesionale të mjekëve të përgjithshëm, stomatologëve, arkitektëve dhe inxhinierëve të ndërtimit.

Kjo ndër të tjerash u theksua në takimin që u mbajt në fillim të javës në Bruksel, midis negociatorëve kryesorë, të mbledhur nga Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal. Pritet që procesi të përfundojë me njohjen automatike të kualifikimeve akademike të fituara në shtetet e rajonit si Maqedonia, Shqipëria, Kosova, Serbi, Mali i zi dhe Bosnje e Hercegovina në mesin e vitit 2019. Pritet që të zbatohen procedura transparente dhe korrekte në pajtim me Konventën e Lisbonës për njohje, që do të ndihmojë edhe përgatitjet për aderimin e shteteve në Bashkimin Europian. Negociatat dhe...

Fq.6

EDITORIAL

DRITËHIJET E KAPITALIT NJERËZOR TE NE

Emin AZEMI

Sipas studimit më të ri të Bankës Botërore, rezulton që të miturit në Maqedoni studiojnë 11.2 vjet, por dinë sikurse të mësojnë vetëm 6.8 vjet

Investimi në shëndetësi dhe arsim nuk ka marrë vëmendjen që meriton gati në të gjitha vendet e rajonit. Kjo është bërë e ditur në një Studim të Bankës Botërore, i prezantuar ditëve të fundit, që është edhe një udhërrëfim për politikëbërësit, si dëshmi bindëse se ngritja e kuotave të cilësisë në shëndetin dhe shkollimin e fëmijëve mund t'i rrisë ndjeshëm të ardhurat e një vendi, me përfitime që do të kenë efekte edhe në të ardhmen e largët.

Jo rastësisht kapitali njerëzor është konsideruar si një ndër faktorët vendimtarë në stimulimin e rritjes së qëndrueshme gjithëpërfshirëse ekonomike. Jo rastësisht thuhet që për më të varfrit, shpesh kapitali njerëzor është kapitali i vetëm që kanë. Por, kjo nuk mjafton. Detyrë e qeverive është që ka rrisin mbulimin dhe cilësinë e arsimimit dhe kujdesit në fëmijërinë e hershme, si faktor vendimtar në produktivitetin e mëpastajmë, në moshat madhore.

Kapitali njerëzor, do të kishte rëndësi të veçantë për të gjitha vendet, në të gjitha performansat e të ardhurave, vetëm me kusht nëse ai me përvojë dhe dije konkurron në ekonominë e së ardhmes. Ky kapital është i matshëm përmes një indeksi që ndryshe studiuesit e kanë kualifikuar si Indeksi i Kapitalit Njerëzor (IKNJ). Zakonisht ky Indeks mat nivelin e kapitalit njerëzor që një fëmijë i lindur sot mund të presë të arrijë deri në moshën 18-vjeçare, ndërkaq ai përbëhet nga pesë tregues: probabiliteti i të arriturit të moshës pesëvjeçare, sa vjet shkollim pritet të kryejë fëmija dhe sa do të mësojë, norma e të jetuarit në moshë të rritur (përqindja e 15-vjeçarëve që do të arrijnë moshën 60-vjeçare) dhe përqindja e fëmijëve me zhvillim normal.

Indeksi është pjesë e një projekti të Bankës Botërore, Projekti për Kapitalin Njerëzor, i cili e njeh kapitalin njerëzor si faktor të rritjes gjithëpërfshirëse. Krahas Indeksit, Projekti për Kapitalin Njerëzor përfshin një program për fuqizimin e punës kërkimore dhe matjeve mbi kapitalin njerëzor, si edhe për mbështetjen e vendeve për ta përshpejtuar progresin në rezultatet e kapitalit njerëzor.

Sipas studimit më të ri të Bankës Botërore rezulton që të miturit në Maqedoni studiojnë 11.2 vjet, por dinë sikurse të mësojnë vetëm 6.8 vjet. Të dhënat mbi Indeksin e Kapitalit Njerëzor (IKNJ) të gjetura nga ky studim tregojnë se fëmijët e lindur në Maqedoni arrijnë 53 për qind të potencialit të tyre të kapitalit njerëzor kur rriten, ndërkaq në Shqipëri produktiviteti shkon deri në 62%, me kusht që të ndodhë një arsimim i përfunduar dhe shëndet i plotë.

Arsyeja pse bëhen studime të tilla, gjithsesi, lidhet me nevojën e vendosjes së një lidhjeje të drejtpërdrejtë midis përmirësimit të rezultateve në shëndetësi dhe arsim, produktivitetit dhe rritjes ekonomike. Por, kjo do të ishte e pamjaftueshme nëse politikat publike nuk hartojnë strategji afatgjate për përmirësimin e cilësisë së arsimit dhe shëndetësisë, si shtyllat bartëse në zhvillimin e resurseve humane.

Për rrjedhojë, që konfirmon edhe në studimin e fundit të Bankës Botërore, në periudhën afatgjate, mundësitë e hershme për mësim sjellin arritje më të larta mësimore, produktivitet më të lartë pas shkollës dhe të ardhura më të larta dhe kanë një shkallë më të lartë përfitimi për grupet në pozita të cenueshme.

FUQIA E PAMJAFTUESHME DHE KRIZA E MENDIMIT



"Kosova nuk është çliruar nga fuqia e shqiptarëve, po nga NATO-ja dhe për këtë shkak, vazhdon të jetë e papranuar si shtet nga OKB-ja, nga BE-ja, nga OSBE-ja e madje edhe nga vetë NATO-ja. Bile, tashmë janë hapur edhe projeksione ogurzeza për të ardhmen e saj, që mund të shkojnë edhe në drejtim të zhbërjes së saj si shtet. E dyta, edhe demokracia është imponuar nga zhvillimet gjeopolitike në Europën Lindore, e jo si një proces i brendshëm i shoqërive shqiptare a i kombit shqiptar. Bile, dekontaminimi i elitave nga ideologjia markiste dhe adresimi ligjor i krimeve të komunizmit, nuk kanë ndodhur ende, si ka ndodhur në shtetet e tjera të ish bllokut komunist. Pra, kombi shqiptar nuk i ka realizuar me fuqinë e vet projektet, për të cilat krekosemi.
Meqë nuk i ka realizuar me fuqinë e vet, ka mbetur ne pozitë neokoloniale, veçmas Kosova, po edhe në pozitë inferiore si komb në përmasat europiane. Nga një pozicion dhe konfuzion i tillë, kombi ynë as nuk ka arritur që të formojë një mendim të përpunuar për atë që ka ndodhur.
Prandaj, edhe mund të thuhet se kriza më e madhe aktuale e neve shqiptarëve si komb është kriza e mendimit. Rrallë bën vaki të gjendet edhe një komb i dytë në faqe të tokës që krahas ndryshimeve që i kanë ndodhur, falë ndihmave të huaja dhe koniukturave të ndryshuara gjeopolitike e gjeokulturore, të mos i ketë shoqëruar ato ndryshime me ndryshimin e mendimit për veten, për realitetin dhe për botën, në pajtim me kohën në të cilën jeton.
Për dallim nga koha e Rilindjes Kombëtare, kur mendimi kulturor e politik u parapriu projekteve të kombformimit e të shtetndërtimit, në kohën tonë ka një ngurtësim në mënyrat e deplasuara të mendimit, ashtu që shumica e çështjeve me të cilat përballemi ne shqiptarët e sotëm, nuk marrin fare përgjigje adekuate.
Me gjithë këto universitete, kolegje, institute dhe medie, kjo krizë e mendimit kulturor, akademik e politik është paradoks më vete", ka shkruar një status në Facebook, pedagogu universitar dhe shkrimtari Milazim Krasniqi.

KUJTOHUNI PËR SHKRIMTARËT E POETËT SA JANË GJALLË

"Ajo që më bën përshtypje në jetëshkrimin e poetit Fatos Arapi, është fakti që ai nuk ka marrë asnjë çmim zyrtar nga Republika e Shqipërisë. E nëse kjo mungesë vinte për shkak të biografisë së tij, askush nuk pengonte askënd që ta vinte në vend këtë padrejtësi pas rënies së diktaturës. Por shteti ynë as atëherë nuk e bëri këtë. Siç duket dikush ka qenë mjaft i interesuar ta mbajë përherë të spastruar majën e Olimpit. Ju ftoj të lexoni poezinë e tij 'Te varri i lirisë'. Kur e kam lexuar për herë të parë, pa emrin e autorit poshtë, kam menduar se do të ishte shkruar prej një poeti të pas 90-ës, dhe u surprizova mjaft (dhe bukur) kur mësova se ishte e Fatos Arapit, lindur në vitin 'e largët' 1929. Një poezi tronditëse, aspak skematike dhe në kuptimin e plotë të fjalës MODERNE. Ja që viti i lindjes nuk ka asnjë lidhje me lirinë e brendshme të individit (në këtë rast; poetit).
Këto ditë mediat sociale po gëlojnë me poezitë e tij, dhe me cilësime si: 'Më i madhi', 'Më i miri', 'Më shkëlqyeri' (shqiptarët i pëlqejnë shumë cilësimet përjashtuese), por unë do t'iu thosha këtyre njerëzve: - Kujtohuni për shkrimtarët e poetët sa janë gjallë, duajini dhe kujdesuni për ta, sepse pas vdekjes i gjithë ky lum dashurie atyre nuk u hyn në punë!...", ka shkruar një status në Facebook, shkrimtarja nga Tirana, Arlinda Guma.

MEDIACitate

SHTOHET RREZIKU I SULMEVE KIBERNETIKE

Në fund të vitit të kaluar, hakerët sulmuan një platformë mësimore në një shkollë të lartë të federatës, për të krijuar atje akses në rrjetin e Ministrisë së Jashtme. Ministri i Brendshëm Horst Seehofer e konsideron këtë një shembull paralajmërues për rrezikun e sulmeve kibernetike. Sulmuesit jo vetëm dështuan gjatë kësaj përpjekjeje, por ata u vrojtuan gjatë gjithë kohës prej Entit Federal për Sigurinë në Teknikën e Informacionit (BSI). BSI është përgjegjëse për mbrojtjen nga sulmet kibernetike dhe konsulton shoqatat dhe ndërmarrjet. Ministri Seehofer e vlerësoi punën e këtij institucioni gjatë prezantimit të enjten në Berlin të raportit të BSI-së për gjendjen aktuale.
Sipas raportit me rritjen e akseseve në rrjet në jetën e përditshme shtohet edhe numri i pikave të ndjeshme ndaj sulmeve në sistem. Megjithatë ministri i Brendshëm është i preokupuar për të garantuar që rrjetet elektronike të autoriteteve gjermane, të furnizuesve të energjisë apo të sipërmarrjeve të tjera të rëndësishme të jenë imune edhe në të ardhmen prej sulmeve të tilla. Gjendja e rrezikshmërisë në Gjermani është ashpërsuar për shkak të një cilësie të re të sulmeve kibernetike, thekson Seehofer. "Kërcënimet në hapësirën kibernetike kanë një dinamikë të lartë", tha Seehofer. Presidenti i BSI Arne Schönbohm raportoi, se autoriteti i tij ndërkohë njeh 800 milionë programe dëmtuese. Çdo ditë atyre u shtohen rreth 390.000 versione të reja. Për aparaturat mobile ndërkohë kam bi 27 milionë programe dëmtuese vetëm për sistemet Android. Përmes kushteve laboratorike është arritur p.sh. që të sulmohen dhe të riprogramohen aparaturat e frymëmarrjes artificiale, shkruan BSI në raportin e publikuar. Njëkohësisht në të tilla apartura shpesh nuk vendosen kodet e sigurisë, për t'u mundësuar mjekëve në raste emergjence që të kenë akses të menjëhershëm në to. Meqenëse gjendja e rrezikshmërisë është kritike, duhet të hulumtohet më intensivisht në mekanizmat special të sigurisë, shkruhet në raportin e BSI-së. Në periudhën nga 1 korriku 2017 deri më 31 maj 2018 BSI i kanë mbërritur nga operatorët gjermanë të infrastrukturave sensibël 145 njoftime për raste ndërhyrjeje – kryesisht bëhet fjalë për raste në fushën e Teknologjisë së Informacionit (IT) dhe Telekomunikacionit dhe në sektorin e energjetikës. Mundësia e suksesit të sulmuesve ndaj infrastrukturave sensibël është rritur, sepse ka rritje edhe të numrit të pikave të ndjeshme ndaj sulmeve si dhe vet infrastrukturat po bëhen gjithnjë e më komplekse dhe po shumëfishohet sasia e të dhënave, thuhet në raportin e BSI-së.

(DW, 12 tetor)

PËRFUNDON DEBATI NË KOMISIONIN KUSHTETUES

VMRO PARA ÇARJES SË MADHE

Lideri i VMRO-së tha se po përgatitet për zgjedhje të reja, por se në parti, sipas informatave jozyrtare, nuk ka përkrahjen e të gjithë "deputetëve të vjetër". Gjasat janë që të hënën, kur duhet të nis seanca plenare për ndryshimet kushtuese, deputetët që nuk janë në vijë me liderin Mickovski, mes tyre dhe deputetja Daniella Rangellova, bashkë me deputetë të pakicave të marrin pjesë në votim

DANIELLA RANGELLOVA

Gjendja aktuale në parti flet për tone disonance në kontekst të përkushtimit ndaj partisë në të ardhmen, të cilat sillen nga pozita djathtiste radikale, në pozita djathtiste qendrore, por shpresoj dhe besoj se për një kohë të shkurtër, gjendja do të kristalizohet, veçanërisht nëse merret parasysh se partia jonë në fokus ka integrimin euroatlantik, dhe kjo çështje është absorbuar tashmë e një kohë të gjatë, dhe as që besoj për ndonjë opsion tjetër

Koha — Fatos RUSHITI

Shkup, 12 tetor - Të premten në Parlament, Komisioni për çështje kushtuese pati vazhdimin e dytë të debatit për ndryshimet kushtetuese, debat ky që pritej të mbyllej po të premten për shkak të numrit të paktë të diskutusve që mbetën të merrnin fjalën. Ndërkaq të hënën do të merret vesh përfundimisht, kur edhe duhet të fillojë seanca plenare, nëse vendi do të shkojë në zgjedhje të parakohshmë apo deputetët e opozitës do të përkrahin ndryshimet kushtetuese me çka edhe do të mbyllet implementimi në Parlament i Marrëveshjes për emrin me Greqinë. Tani për tani, topi gjendet tek kryetari i VMRO-së, Hristijan Mickovski se çfarë do të veprojë në raport me këtë Marrëveshje. Para se të fillojë mbledhja në Komisionin parlamentar të kushtetutës, Mickovski thirri në koordinim të gjithë deputetë e partisë së tij dhe partive që ka në koalicion, ndërsa për mediat tha se kanë filluar përgatitjet për zgjedhje të parakohshme. Ai madje ka demantuar se janë shkarkuar nga partia nënkryetari i partisë, Mitko Jançev dhe anëtarja e Komitetit Ekzekutiv e deputetes Daniella Rangellova.

"As që e kam menduar, as që planifikoj të ndodhë një gjë e tillë. Ne përgatitemi për zgjedhje dhe nuk kemi qëllim të merremi me spekulimet e LSDM-së pas referendumit të pasuksesshëm. Me Jançevin kemi marrëdhënie të mira, pikërisht sot në mëngjes biseduam", tha Mickovski dhe shtoi se bëhet fjalë për seancë të rregullt të Komitetit Ekzekutiv të partisë.

Megjithatë, dëshira e liderit të VMRO-së për të shkuar në zgjedhje të parakohshme vështirë se mund të bëhet pa aminin e "senatorëve të partisë", deputetët e disa mandateve dhe njerëz me ndikim të madh partiak si deputeti Antonio Milloshovski, Ilija Dimosvki, Trajko Vellanovski, Daniella Rangellova, Liljana Zaturovska, dhe deputetë të tjerë. Kjo, pasi kuluareve partiake flitet që këta deputetë dhe shumë të tjera, përfshirë dhe ata që lidhen drejtpërdrejt me 27 Prillin, nuk priten të përfshihen në lista për deputetë. Në VMRO pikërisht nga ky grup i deputetëve ka gjasa që në seance plenare të jenë të pranishëm për të votuar në lexim të parë pro ndryshimeve kushtetuese. Informatat ende të paverifikuara janë se Zaevi mund të ketë siguruar tashmë votat prej 80 deputetësh, kjo pasi debati nuk zgjati shumë siç pritej deri në dhjetë ditë dhe kaq shpejtë të shkohet në seancë plenare.

Shenja për këtë dy ditë më parë dha deputetja Daniella Rangellova gjatë një intervistë për "Birn". "Gjendja aktuale në parti flet për tone disonance në kontekst të përkushtimit ndaj partisë në të ardhmen, të cilat sillen nga pozita djathtiste radikale, në pozita djathtiste qendrore, por shpresoj dhe besoj se për një kohë të shkurtër, gjendja do të kristalizohet, veçanërisht nëse merret parasysh se partia jonë në fokus ka integrimin euroatlantik, dhe kjo çështje është absorbuar tashmë e një kohë të gjatë, dhe as që besoj për ndonjë opsion tjetër", tha Rangellova. Ajo ka theksuar se për momentin e brengosin porositë që arrijnë në adresë të saj për çdo ditë, kurse ato janë porosi të qarta dhe pa hamendje nga Partia Popullore Evropiane, "sepse qëndrimet tona duhet të bashkohen me rrugën evropiane, e jo të veçohen". Por, lideri i VMRO-së, Hristijan Mickovski përmes zgjedhjeve dhe në një fitore eventuale të LSDM-së bashkë me partitë shqiptare, do të heq nga vetja barrën për Marrëveshjen me Greqinë. Nëse do të humb, atëherë deputetët e VMRO-së mund të jenë të lirë të votojnë si të duan, me arsyetimin se Zaev mori votat në popull me kauzën për këtë marrëveshje, kjo sipas asaj që flitej kuluareve në Parlament. Me interes do të jetë edhe mbledhja e Komitetit Ekzekutiv e paraparë të mbahet mbrëmjen së premtes.

Ndryshe, gjatë debatit në Komisionin Kushtetues, për dalim nga herët tjera kur diskutohej për çështje të rëndësishme politike, pushteti dhe opozita si e kësaj garniture parlamentare si ajo paraprake gjatë qeverisë teknike, kishte debate të ashpra. Kësaj radhe, situata ndihej tejet e relaksuar sidomos tek deputetë e VMRO-së që nuk janë në vijë me qëndrimet e liderit Mickovski. Gjatë debatit, Zaevi në replikë ndaj deputetit të VMRO-së, Trajço Dimkov, edhe njëherë përsëriti rëndësinë që ka për vendin marrëveshja për emrin. "Maqedonasit në Greqi lindën dhe jetuan më shpresën tek ne se do të gjejmë zgjidhje afatgjate. 25 vitet kaluan dhe kjo nuk ndodhi. Të gjithë tentuan të ketë një marrëveshje, por ja që unë përfundimisht mora përgjegjësinë. Tani pres që edhe ju ta bëni dhe bashkë të vendosim për ardhmërinë tonë në BE dhe në NATO", theksoi Zaev. Në kundër-replikë, Ilija Dimovski i tha Zevit se në dy momente të rëndësishme ka vepruar pa opozitën, nënshkrimi i Marrëveshjes me Greqinë dhe votimi i saj Parlament.

"Vonë jemi për konsensus. Për çfarë duhet të pajtohemi? Unë kuptoj se ju po bëni investimin tuaj të madh, por punët nuk janë siç po i shpjegoni ju. Kjo pasi fshihet preambula dhe dispozita ku thuhet që 'Republika Maqedonisë kujdeset për maqedonasit etnik jashtë territorit të saj', të gjithë doni ti bëni emigrant", tha deputeti i VMRO-së, Ilija Dimovski. Ndryshe, nënkryetari i Parlamentit, Goran Misovski, përmes një konference për shtyp u bëri thirrje deputetëve të VMRO-së në seancën plenare të hënën t'i mbështesin ndryshimet kushtetuese dhe bashkërisht të sigurojnë ardhmëri evropiane për qytetarët.

"Jam i bindur dhe nuk dua të besoj se deputetët e VMRO-DPMNE nuk do të votojnë për ndryshimet kushtetuese të hënën", tha Misovski, duke u bërë thirrje kolegëve nga partia opozitare njëkohësisht me mbështetjen e ndryshimeve kushtetuese ta mbrojnë edhe, siç tha ai, qëndrimin e përbashkët për proceset eurointegruese të shtetit. Sipas tij, me votimin e ndryshimeve kushtetuese, Maqedonia nuk humb asgjë, por përkundrazi, e siguron stabilitetin dhe sigurinë e saj.

"Si deputetë gjendemi përpara vendimit serioz, i cili do ta definojë ardhmërinë e shtetit tonë, ardhmërinë e qytetarëve, të gjeneratave të ardhshme. Kemi obligim historik që ta ndjekim zërin dhe dëshirën e shumicës së qytetarëve dhe t'i realizojë interesat strategjike të Maqedonisë për anëtarësim të Maqedonisë në BE dhe NATO. Propozimi i Qeverisë për hapjen e Kushtetutës, si hap nga Marrëveshja e Prespës, është publike përpara qytetarëve, përpara deputetëve, përpara opinionit. Me ndryshimet kushtetuese nuk humbet asgjë, përkundrazi, sigurohet ardhmëria në BE dhe NATO me përforcim të identitetit, i cili përfundimisht bëhet i pranueshëm nga tërë bota. Vendimi ynë që të votojmë për ndryshimet kushtetuese e konfirmon dhe e forcon kontinuitetin historik të shtetësisë së Maqedonisë. Sigurohet garanci i integritetit territorial", shtoi Miskovski.

DEPARTAMENTI I SHTETIT FUQISHËM E MBËSHTET MARRËVESHJEN E PRESPËS

Mbështetje për Marrëveshjen e Prespës dhe implementimin e saj të plotë ka shprehur funksionari i Stejt Departamentit në deklaratën për portalin informativ Real.gr. Në pyetjen e korrespondentit të portalit nga Uashingtoni, se cili është pozicioni i administratës amerikane lidhur me planin B të Panos Kamenos, që kinse është prezantuar në takimin e tij me Ves Miçel, funksionari ka përsëritur qëndrimin e SHBA-së, duke përmendur rezultatin e referendumit. "Publikisht nuk i kumtojmë detajet nga bisedimet tona personale diplomatike, por pozicioni i SHBA-së është i qartë: e përshëndesim rezultatin e referendumit në Republikën e Maqedonisë më 30 shtator, ku qytetarët e shprehën përkrahjen e tyre për NATO dhe BE me pranimin e Marrëveshjes së Prespës mes Maqedonisë dhe Greqisë. Fuqishëm e mbështesim implementimin e plotë të marrëveshjes që do t'i mundësojë Maqedonisë të fitoj pozicion ligjor në NATO dhe BE si Republika Maqedonia Veriore, duke kontribuar në stabilitetin financiar, sigurinë dhe prosperitetin", ka thënë funksionari i Stejt Departamentit për real.gr.

NDËRPRITEN PUNIMET NË XHAMINË NË SHTIP

HUSAMEDIN PASHA RESTAUROHET APO GËRMOHET PËR SHËN ILINË

Pretendimet e Muzeut të Qytetit ishin se po analizonin gjendjen e këtij monumenti të kulturës, ndërsa në Myftini dyshojnë se punimet e nisura pa i vënë në dijeni, kishin të bënin me gërmimet për të kërkuar themelet e kishës së Shën Ilisë, për të cilin edhe vetë Komuna e Shtipit beson se gjendet pikërisht në këtë xhami



Koha Evis HALILI

Shkup, 12 tetor - Myftnia e Shtipit ka ndërprerë punimet që nisën të enjten e kaluar në xhaminë Husamedin Pasha në Shtip nga ana e Muzeut të Qytetit. Pretendimet e Muzeut të Qytetit ishin se po analizonin gjendjen e këtij monumenti të kulturës, ndërsa në Myftini dyshonin se punimet e nisura pa i vënë në dijeni, kishin të bënin me gërmimet për të kërkuar themelet e kishës së Shën Ilisë, për të cilin edhe vetë Komuna e Shtipit beson se gjendet pikërisht në këtë xhami.

Myftiu i Shtipit, Naser Rexhepi thotë se me kërkesën e bërë prej tyre, punimet janë ndërprerë dhe ata kanë kërkuar nga Muzeu dhe Drejtoria e Mbrojtjes së Monumenteve të Kulturës që ekipi që do të merret me punimet, të shoqërohet edhe nga përfaqësues të tyre. "Xhamia gjendet vetëm pak metra nga myftinia, përdoret si faltore prej nesh kur na e lejojnë kushtet dhe prandaj kishim shumë hapësirë për të dyshuar, pasi filluan me punime pa asnjë lloj informimi.

Kështu ka ndodhur me shumë xhami të tjera, në Manastir, Ohër, Resnjë..., ku kanë nisur me ekzaminimin e gjendjes statike dhe kanë përfunduar duke gërmuar për të gjetur gjoja themele kishe apo manastiri. Hasëm në mirëkuptimin e përfaqësuesve të muzeut dhe DMT dhe punimet janë ndërprerë. Javën e ardhshme do të duhet të takohemi sërish dhe kemi kërkuar prej tyre që t'i shoqërojë një përfaqësues i BFI-së, ose ekspert", thotë myftiu Rexhepi.

Sipas historianit të artit dhe kryetar i Këshillit nacional për trashëgiminë në Ministrinë e Kulturës, Behixhudin Shehapi, ndërhyrje të tilla në një objekt që mbrohet nga shteti janë të ndaluara. Por edhe për faktin se nga hulumtimet e bëra nga institucionet kompetente, është konstatuar se nuk ka ekzistuar kishë në themelet e faltores. Shehapi sqaron se xhamia e Husamedin pashës është një monument me karakteristika kulminante të stilit klasik të periudhës osmane të shekullit të 16-të dhe si e tillë - është shpallur dhe regjistruar si monument kulture.

"Çdo dilemë nëse ka pasur kishë apo jo në themelet e saj, është eliminuar me kohë. Në bazë të konventave ndërkombëtare, por edhe të Ligjit aktual, nuk lejohet të zhvillohen gërmime ose hulumtime tek një objekt i valorizuar, aq më pak kur ka indikacione me tendenca për asgjësimin ose shndërrimin e tij në një objekt tjetër. Mund të ketë hulumtime në këtë objekt, por vetëm sa u përket fazave të ndërtimit të vetë xhamisë ose për restaurimin e godinës ekzistuese. Siç duket, njerëzit kompetentë në Shtip, por edhe më gjerë, nuk mund të pajtohen me këtë realitet, pra me ekzistimin e një objekti të religjionit tjetër, prandaj insistojnë në afirmimin e idesë së ekzistimit të kishës (Shën Ilija) në vendin e xhamisë. Kjo gjë nuk është në dobi as të shkencës - trashëgimisë kulturore e as në frymën e ruajtjes dhe kultivimit të marrëdhënieve ndëretnike e ndërfetare jo vetëm për Shtipin me rrethinë, por për të gjithë shtetin", thotë Shehapi për KOHA. Në fakt, vetë Komuna e Shtipit ka dilema. Në ueb faqen e këtij institucioni, ky objekt i kulturës përshkruhet si një kishë.

"Xhamia Husa Medin Pasha ngrihet mbi një kodër, në anën e majtë të qytetit. Objekti njihet edhe si kisha Shën Ilija, pasi besohet se është ndërtuar mbi themelet e një tempulli të lashtë kristian. Sipas legjendës, xhamia është ndërtuar në shekullin e 17-të. Kisha që i kushtohet Shën Ilisë është ndërtuar mes shekullit të 13-të dhe 14-të. Pranë xhamisë gjendet edhe varri i Husamedin Pashës", shkruhet në faqen e Komunës.

11 vjet burg për serbin që përpunonte drogë në Reçicë të Tetovës

Shkup, 12 tetor - Millan Zarubica, serbi që kryesonte prodhimin e drogës në një prej laboratorëve më të mëdha të Evropës Juglindore në Reçicë të Tetovë, u dënua me 11 vite burg. Prokuroria kishte kërkuar 12 vite, por meqë e pranoi fajin, dënimi iu zbut me një vit. Zarubica u arrestua gjatë vitit të kaluar në Tetovë, në bashkëpunim edhe me autoritetet Serbe, që e njihnin mirë aktivitetin e tij dhe që ishte një farmacist i zoti. Përveç Zarubicës, fajin e pranoi edhe një i akuzuar tjetër nga Serbia, dhe tre shtetas të Maqedonisë, që e kanë ndihmua atë në prodhimin e drogës në një bodrum shtëpie në Reçicë të Vogël. Shtetasi tjetër serb është dënuar me 9 vite burg, dy të dënuarit nga Maqedonia kanë marrë nga 7 vite burg, ndërsa njëri u dënua me 4 vjet.

NDRYSHOHET SËRISH PROPOZIM-LIGJI PËR SHLYERJEN E KAMATAVE

Borxhlinjtë nuk do të paguajnë shpenzimet e përmbaruesve

Shkup, 12 tetor - Propozim-ligji për shlyerjen kamatave të qytetarëve për borxhet e mbetura ndaj kreditorëve privat apo institucione publike u miratua nga anëtarët e Komisioni parlamentar për Financim dhe Buxhet. Pasi propozim-ligji e kaloi filtrin e deputetëve në leximin e parë një muaj më parë, në leximin e dytë anëtarët e Komisionit për financim dhe buxhet pranuan amendamentet plus të dorëzuara nga partia shqiptare në pushtet - BDI. Amendamentet e propozuara nga deputeti i BDI-së, Rexhail Ismaili, njëherësh dhe anëtar i këtij Komisionit, saktë përcaktojnë se cilët kreditorë privat dhe institucionet publike me miratimin e ligjit, detyrohen të shlyejnë kamatat për çka borxhliu do të duhet të paguajë vetëm borxhin bazë.

"Kërkoj që përveç kompanive private siç është EVN, operatorët e telefonisë celulare dhe fikse, operatorët kabllovik dhe institucionet publike për shërbime komunale, me këtë ligj të përfshihet edhe Radio Televizioni i Maqedonisë, gjegjësisht qytetarët të paguajnë vetëm borxhin bazë të taksës radiodifuzive. Kërkojmë gjithashtu që qartë të precizohet që qytetarët lirohen nga pagesa e kamatave për borxhet e mbetura nga viti 2006 e deri në fund të vitit 2011. Gjithashtu, kërkojmë plotësimin e nenit 4 të propozim-ligjit, pasi i njëjti duhet të hyjë në fuqi 8 ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare dhe jo 3 muaj siç parashihet në propozim-ligjin e miratuar në leximin e parë. Po ashtu, obligohen që kreditorët në periudhë prej 12 muajve të sjellin vendim për informimin e të gjithë borxhlinjve se fillojnë me procesin për shlyerjen e kamatave të borxheve të mbetura dhe për këtë detyrohen të informojnë në kohë përmbaruesin që të ndërpret procesin e përmbarimit nëse është në fillim apo të ndërpres edhe procesin, i cili tanimë është i përmbaruar borxhliu", tha Ismaili gjatë sqarimit se pse ishte më se i nevojshëm pranimi i këtyre amendamenteve të propozuar nga partia e tij.

Më pas, sipas deputetit Ismaili, Ligji obligon borxhlinjtë që në afat prej 12 muajve të paguajnë borxhin e mbetur ndërkohë do të zvogëlohen harxhimet e avokatëve, noterëve dhe përmbaruesve, të cilat nuk mund të jenë më të larta se 20 për qind nga borxhi bazë, si dhe pas kësaj, përmbaruesit detyrohen të debllokojnë xhirollogarinë e borxhliut. Se me ligjin e ri parashihen dhe zvogëlimet e harxhimeve të qytetarëve ndaj përmbaruesve, këtë e vërtetoi dhe iniciatori dhe propozuesi i ligjit të ri për shlyerjen e kamatave të borxheve të mbetura, deputeti Pançe Minov.

"Bëhet fjalë për një problem që qytetarët po ballafaqohen me vite dhe si pasojë e harxhimeve të lartë pas përmbarimit të lëndës që shkojnë deri më 10 herë më larta se borxhi bazë, qytetarët nuk kanë mundur në kohët të paguajnë borxhet e mbetura. Në këtë proces, më të shkelur kanë qenë qytetarët. Me miratimit e këtij ligji, tanimë qytetarët nuk u detyrohen përmbaruesve të paguajnë harxhimet e tyre, por për këtë, kreditori do të njofton përmbarues se lënda ndërpritet dhe se harxhimet e përmbaruesve i mbulon kreditori", tha Minov. *(Z.V)*

Paraburgim 30-ditor për trafikantin e marihuanës

Shkup, 12 tetor - Prokuroria e Shkupit miratoi urdhër për zbatimin e procedurës hetuese kundër një personi për vepër penale "prodhimtari të paautorizuar dhe lëshim në qarkullim të drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursore". Për shkak të dyshimit se i dyshuari do të arratiset, gjykatësi i procedurës paraprake të Gjykatës Penale në propozim të prokurorit publik i caktoi masë paraburgimi prej 30 ditësh.

"Personi është i dyshuar se nga një person tjetër, tani për tani i panjohur, pa autorizim për shkak të shitjes ka furnizuar rreth 1,8 kilogramë drogë narkotike marihuanë. Gjatë bastisjes së shtëpisë së tij në rrugën "Bllagoja Paroviq" në Shkup, nga ana e nëpunësve policorë është konfirmuar se drogën pa autorizim e ka mbajtur me vete për shkak të shitjes, të paketuar në fuçi plastike në hapësirën e ballkonit, në qese me neto masë të ndryshme, si dhe në thes të bardhë në hapësirat e bodrumit. Plotësisht, gjatë bastisjes te ai është gjetur edhe peshore digjitale me mbetje të drogës narkotike - marihuanë", kumtoi Prokuroria Publike.

Prokurori publik kompetent, siç kumtojnë prej atje, ka vlerësuar se ekzistojnë rrethana të cilat e arsyetojnë qëndrimin nga rreziku i arratisjes së të dyshuarit - mosha e tij, lloji, karakteri dhe pesha e veprës penale për të cilën dyshohet, kohëzgjatja e sanksionit penal të caktuar për këtë vepër, si dhe fakti që personi deri tani është dënuar, për shkak se mund të pritet se i dyshuari do të fshihet, përkatësisht do të arratiset.

Duke u nisur nga kjo, prokurori publik deri te gjykatësi i procedurës paraprake nga Gjykata Themelore Shkupi 1 dha propozim për përcaktimin e masës së paraburgimit, ndërsa gjykatësi e pranoi propozimin e tillë dhe të dyshuarit i caktoi masë paraburgimi në kohëzgjatje prej 30 ditësh.

PUBLIKOHEN 103 SMS-POROSITË E ISH-ZYRTARËVE TË VMRO-së

NIS TRAJEKTORJA, EDHE STAVRESKI NË BANKËN E TË AKUZUARVE

Përmes këtyre sms-porosive, opinioni pati rastin të shoh se si është realizuar marrëveshja me Eksim Bankën nga Kina dhe si janë realizuar takimet në Kinë, më datë 17 dhe 18 korrik të vitit 2018. Në njërën prej 103 sms-porosive, ishte edhe përkujtimi i Janakieskit që ia bën Stavreskit: "Nëse je në Komitet ekzekutiv, përmendja shefit udhëtimin për në Kinë"

Koha — Omer XHAFERI

Shkup, 12 tetor - Duke e proceduar lëndën "Trajektroja", në Gjykatën Penale të Shkupit ka vazhduar procesi gjyqësor kundër Nikolla Gruevski, Mile Janakieskit, Vlladimir Peshevski dhe Lupço Georgievski. Ky rast, i cili përfaqësohet nga Prokuroria Speciale Publike fillo në mars të këtij viti dhe deri më tani ka arritur në fazë prezantimi të dëshmive, respektivisht të premten u prezantuan 103 sms-porosi, kryesisht mes ish-ministrit të Transportit dhe Lidhjeve, Mile Janakieski dhe Zoran Stavreski, ish-ministër i Financave. Publikimi i këtyre materialeve ka pësuar pasi në seancën e kaluar ishin prezantuar bisedat telefonike mes të akuzuarve, përmes të cilëve PSP e mbështeti akuzën se janë bërë keqpërdorime gjatë shpalljes së tenderit për autostradën Kërcove-Ohër dhe Milladinovci-Shtip.

Duke i prezantuar sms-porositë, prokurorja speciale Lile Stefanova, u ndalë në detaje, me çka tha se shkëmbimi i porosive mes Janakieskit dhe Stavreskit është realizuar gjatë viteve 2012 dhe 2013. Në mesin e shumë sms-porosive, opinioni pati rasti të shoh se si ish-ministri i Financave, Stavreski, me datë 20.02.2013 i shkruan kolegut të tij, JanakieskiT: "Nuk mundesh në këtë mënyrë ti futësh njerëzit në kurth". Tutje, Janakieski ia kthen se nuk është e saktë se ai e bën një punë të tillë. Mes tjerash, Stavreski, shton se: "Turp është, një të përgjigjet dhe tjetri të vihet në kurth".

Përmes këtyre sms-porosive, opinioni pati rastin të shoh se si është realizuar marrëveshja me Eksim Bankën nga Kina dhe si janë realizuar takimet në Kinë, më datë 17 dhe 18 korrik të vitit 2018. Në njërën prej këtyre sms-porosive, ishte edhe përkujtimi i Janakieskit që ia bën Stavreskit: "Nëse je në Komitet ekzekutiv, përmendja shefit udhëtimin për në Kinë" (26 korrik 2012).

Ndryshe, Janakieski në sms-porosinë dërguar Stavreskit, më 7 nëntor 2012, i thotë se një kompani ka ofruar 280 milionë euro dhe tjera 288 milionë, respektivisht qëndrim i tyre i përbashkët është se njëra prej tjetër e kanë përshkruar ofertën. (O.Xh)

Zbulohen 40 policë me diploma të falsifikuara

Shkup, 12 tetor - Në Ministrinë e Punëve të Brendshme janë zbuluar 40 të punësuar të cilët kanë pasur diploma të falsifikuara të fakultetit, deklaroi ministri Oliver Spasovski në emisionin "Klik-Plus" në TV 21. Këto persona, sipas Spasovskit, kanë mbërritur edhe deri në funksione të rëndësishme në MPB, por, pas zbulimit janë shkarkuar dhe kundër tyre është ngritur kallëzime penale. Kallëzimet penale, siç tha ministri i Punëve të Brendshme, janë ngritur edhe deri te fakultetet të cilat i kanë dhënë ato diploma. Në kontekst të debatit aktual për ndryshimet kushtetuese në Kuvend dhe pohimet për kërcënime ndaj deputetëve, ministri Spasovski tha se deri më tani asnjë deputet nuk ka denoncuar çfarëdo shkelje të ligjit. Por, thotë se ka denoncime nga persona udhëheqës në partinë opozitare VMRO-DPMNE, dhe anëtarë të të njëjtës parti. Në emisionin e TV 21. Spasovski tha se edhe se kërkohet amnisti për ish udhëheqësinë e opozitës dhe siç thotë për njerëz të tjerë të cilët janë me interes për ata.

PLOTËSOHET KËSHILLI PENAL NË "TITANIK 3"

Gjykimi i Alimit dhe Gurit nis nga e para

Shkup, 12 tetor - "Titanik 3", lëndë e Prokurorisë Speciale Publike, të premten filloi nga e para. Ndryshimi i Këshillit Penal nga njëra anë dhe mos fillimi i gjykimit në afat prej 90 ditëve nga ana tjetër, paraqesin arsyet kryesore se pse procesi gjyqësor kundër deputetit të BDI-së, Ejup Alimi dhe anëtarit tjetër të BDI-së, Ismet Guri, po shqyrtohet nga fillimi. Me propozim të PSP-së, në këtë seancë u paraqitën edhe dy dëshmitarë, të cilët thanë se asnjëherë nuk e kishin parë të akuzuarin, dhe aq më pak kishin njohuri se kush janë e çka kanë bërë. Kundër të akuzuarve Alimi dhe Guri, prokurorja speciale Fatime Fetai, ka përgatitur një listë të gjatë të dëshmive, respektivisht përveç provave materiale, si dëshmitarë në këtë lëndë pritet të paraqiten rreth 50 persona.

Ndërkohë, avokati Mefail Asllani, gjatë rrjedhës së deritanishme të procesit ka theksuar se me prezantimin e provave të tyre do të dëshmojnë pafajësinë e klientëve të tyre.

Pala mbrojtëse e të akuzuarve në rastin "Titanik 3" ka bërë të ditur se me pjesë e dëshmitë të tyre do të jetë edhe njoftimi i policisë së shtetit se gjatë zgjedhjeve lokale të vitit 2013, të realizuar në Komunën e Çairit, nuk janë regjistruar parregullsi zgjedhore.

Seanca e radhës për rastin "Titanik 3", para Gjykatës Penale të Shkupit është caktuar të mbahet më 18 tetor. Ndryshe, në aktakuzën e ngritur nga PSP, i akuzuari Alimi dhe sekretari i Komisionit zgjedhor, Ismet Guri thuhet se kanë bërë shkatërrimin e materialit zgjedhor.

"Gjatë periudhës 24.03.2013 deri me 26.03.2014, përderisa janë zhvilluar zgjedhjet lokale në Komunën e Çairit, në hapësirat e kësaj komune i akuzuari I.G, si person zyrtar në Komisionin zgjedhor dhe E.A, së bashku me dëshmitarët B.M (anëtar i Komisionit) dhe Q.T (zëdhënës i Komisionit), kanë ndryshuar shkresat dhe procesverbalet që shërbejnë për zgjedhjet (votat), mbledhjen dhe vërtetimin e rezultateve përfundimtare për rrethin e parë të zgjedhjeve lokale në Çair", thuhet mes tjerash në aktakuzën e PSP-së. *(O.Xh)*

60 milionë euro vetëm për rrugët e Koçanit!

Koçan, 12 tetor - Kanë filluar punët ndërtimore për rikonstruimin dhe asfaltimin e drejtimit rrugor nga Koçani drejt qendrës rekreative turistike Ponikvë të Maleve të Osogëvës, për të cilën shteti ka investuar afër 87 milionë denarë. Ministri për Transport dhe Lidhje, Goran Sugareski, i cili bashkë drejtorin e Ndërmarrjes publike për rrugë shtetërore, Zoran Kitanov dhe kryetari i Koçanit, Nikollço Ilijev ka vizituar vendin e ndërtimit, tha se në këtë zonë kanë filluar investime të mëdha në infrastrukturën rrugore. "Ministria për Transport dhe Lidhje, bashkë me Ndërmarrjen për Rrugë Shtetërore ka investuar 60 milionë euro për rrugë në rajonin e Koçanit. Mes kaheve më të rëndësishme është ndërtimi i rrugës së shpejtë nga Shtipi deri në Koçan, rikonstruimi i qarkores rreth Koçanit, rruga regjionale drejt Ponikvës, ndërsa së shpejti do të fillojnë të ndërtohen edhe rrugë tjera lokale", ka thënë Sugareski. Rikonstruimi i rrugës, gjatësia e së cilës është rreth 22 kilometra ka filluar nga drejtimi i Ponikvës, ku dëmet kanë qenë më të mëdha. "Kjo rrugë është ndërtuar para rreth 40 vitesh dhe deri tani nuk ka pasur asnjë intervenim. Sipas dokumentimit teknik, është planifikuar të asfaltohet rruga në gjatësi prej 10.4 kilometra dhe gjerësi prej gjashtë metra. Gjatë fillimit të javës së ardhshme do të fillojë ndërtimi i rrugës rajonale mes fshatrave Tërkanjë dhe Pishicë", ka thënë drejtori i Ndërmarrjes publike për rrugë shtetërore, Zoran Kitanov. Kryetari i Komunës së Koçanit, Ilijev ka thënë se rehabilitimi i rrugës, bashkë me zgjerimin e hapësirë së parkingut në Ponikvë do të ndihmojë në realizimin e planeve të komunës për mbarëvajtje dhe zhvillim të turizmit malor.

SHTETET E RAJONIT DREJT HEQJES SË BARRIERAVE

NJOHJE AUTOMATIKE E KUALIFIKIMEVE AKADEMIKE

Këto nisma për bashkëpunimin më të madh midis shteteve të rajonit në fusha të ndryshme janë ngritur nga Gjermania. Një prej qëllimeve është që në Ballkanin Perëndimor të krijohet rrjeti i lidhjeve infrastrukturore siç janë autostradat në mënyrë që të lidhen Shqipëria, Kosova dhe Serbia si dhe Bosnja dhe Hercegovina në mes veti

Koha — Fisnik PASHOLLI

Shkup, 12 tetor - Shtetet e Ballkanit Perëndimor kanë filluar bisedimet për pranimin e ndërsjellë të kualifikimeve profesionale të mjekëve të përgjithshëm, stomatologëve, arkitektëve dhe inxhinierëve të ndërtimit.

Kjo ndër të tjerash u theksua në takimin që u mbajt në fillim të javës në Bruksel, midis negociatorëve kryesorë, të mbledhur nga Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal. Pritet që procesi të përfundojë me njohjen automatike të kualifikimeve akademike të fituara në shtetet e rajonit si Maqedonia, Shqipëria, Kosova, Serbi, Mali i zi dhe Bosnje e Hercegovina në mesin e vitit 2019. Pritet që të zbatohen procedura transparente dhe korrekte në pajtim me Konventën e Lisbonës për njohje, që do të ndihmojë edhe përgatitjet për aderimin e shteteve në Bashkimin Europian.

Negociatat dhe marrëveshjet që pritet të arrihen për njohjen reciproke të diplomave universitare, janë pjesë e Planit Shumëvjeçar të Veprimit në hapësirën ekonomike rajonale (MAP REA), të miratuar nga kryeministrat e rajonit në Trieste të Italisë në vitin e kaluar.

"Heqja e pengesave për mobilitetin e profesionistëve dhe arritjen në këtë mënyrë të qëllimeve për një hapësirë ekonomike rajonale ka për qëllim të lejojë lëvizjen e papenguar të mjekëve , dentistëve, arkitektëve dhe inxhinierëve të ndërtimit si dhe do të krijojë mundësi reale për mbajtjen e talenteve brenda rajonit", thotë sekretari i përgjithshëm i RCC apo Këshillit për Bashkëpunim Rajonal, Goran Svilanoviq.

Nicholas Cendrovicz nga Drejtoria e Përgjithshme e Komisionit Evropian për politikën e fqinjësisë dhe negocimeve për zgjerim, theksoi rëndësinë e bashkëpunimit rajonal për zgjerimin e BE-së.

"Bashkëpunimi rajonal është në zemër të zgjerimit të BE. Realizimi i angazhimeve rajonale të përshkruara në planin aksional kanë një rëndësi të madhe për gjashtë ekonomitë e Ballkanit Perëndimor. Njëherësh marrëveshja e njohjes së ndërsjellë do të kontribuojë në përgatitjet e rajonit për të përballuar presionin e konkurrencës në tregun e brendshëm", thekson Cendrovicz. Sipas tij, objektivi kryesor i takimit ishte të dakordësohen për një plan negociatash të realizueshme dhe realiste për të identifikuar nevojat. Gjithashtu, RCC propozoi një plan veprimi për hapat drejt finalizimit të Marrëveshjes së Njohjes së Ndërsjellë nga Samiti i Ballkanit Perëndimor në Poloni, korrikun e ardhshëm. Nga ana tjetër pritet të vendoset edhe bazë e të dhënave për mobilitetin e profesionistëve që do të jetë kompatibile me të njejtën bazë në nivel të Bashkimit Evropian dhe në përputhje me direktivat evropiane të njohjes së kualifikimeve profesionale.

Ndryshe, këto nisma për bashkëpunimin më të madh midis shteteve të rajonit në fusha të ndryshme janë ngritur nga Gjermania. Një prej qëllimeve është që në Ballkanin Perëndimor të krijohet rrjeti i lidhjeve infrastrukturore, siç janë autostradat, në mënyrë që të lidhen Shqipëria, Kosova dhe Serbia si dhe Bosnja dhe Hercegovina në mes veti.

Qëllimi është që kështu të "kapërcehet" periudha e pasigurt prej disa viteve, në të cilën BE, nën presionin e krizave të shumta, nuk mendon të zgjerohet për momentin. Thënë ndryshe, arsye e fortë për aktivizimin e "Berlin plus" është zbutja i tensioneve në rajon. Thuhet se Gjermania ka përgatitur program të posaçëm për Ballkanin Perëndimor, i çili do të ishte kompensim për pritje të gjatë për hyrje në Bashkimin Evropian.

CAROVSKA NË TAKIMIN E MINISTRAVE NË VJENË

BARAZIA GJINORE, PRIORITET

Shkup, 12 tetor - Maqedonia po punon në mënyrë aktive në arritjen e barazisë gjinore dhe mbrojtje nga diskriminimi. Ne po zhvillojmë Indeks kombëtar për barazi gjinore, ku do të përfshihet një indikator për matjen e barazisë gjinore me të cilin do të bëhet krahasimi me BE-në dhe me vendet anëtare të saj. Gjithashtu me vendosjen e trajnimeve elektronike e gjithë administrata dhe vendosja e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor do të bëhet një mekanizëm me të cilin barazia gjinore nuk do të konsiderohet si një çështje e izoluar, por si pjesë e të gjitha politikave kombëtare të cilat sillen në vend.

Këtë, siç informojnë nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, e ka theksuar ministrja Mila Carovska në takimin joformal ministror në Vjenë kushtuar barazisë gjinore, organizuar nga presidenca austriake e Këshillit të BE-së, ndërsa ku kanë marrë pjesë ministra të resorëve nga vendet e BE28, EFTA dhe Ballkani Perëndimor. Ministrat kanë diskutuar për çështjen Si digjitalizimi kontribuon për një pjesëmarrje të barabartë civile dhe politike të vajzave dhe të meshkujve?

Gjatë takimit ministrja Carovska është takuar me ministren federal austriake për gratë, familje dhe të rinj, Zhulien Bogner Shtraus, si dhe me drejtoreshën e Zyrës federale zvicerane për barazi gjinore, Silvi Durer. Në takim është rënë dakord për bashkëpunim të mëtejshëm.

Progresi në barazinë gjinore shihet edhe nga të dhënat statistikore. Në Maqedoni sipas të dhënave të Entit Shtetëror Statistikor, në vitin 2016 nga numri i përgjithshëm i konsumatorëve të internetit 48,8 për qind kanë qenë gra dhe 51,3 për qind për burra, ky numër në vitin 2017 është rritur për 76,8 për qind për gra dhe 81 për qind për burra. Rritet edhe vetëdija tek vajzat dhe gratë për shkollim. Atë e tregojnë edhe numrat e përfaqësimit të vajzave në arsimin e lartë me 31 për qind në krahasim me numrin e meshkujve 22 për qind. Ndërsa numri i vajzave të cilët kanë diplomuar në shkencat matematiko-natyrore është më i madh se numri i burrave (2.8 për qind në vitin 2016 vajza kundrejt 1,8 për qind i burrave në vitin 2016). Ndërsa në shkencat teknike, numri i grave të diplomuara (5,07 për qind në vitin 2016) ndërsa më i vogël nga numri i studentëve meshkujve të diplomuar (8,2 për qind në vitin 2016), informojnë nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale.

INTERESIMI I TË RINJVE PËR GJUHËT E HUAJA

GJERMANISHTJA, SI MJET PUNE

Një prej kushteve kryesore që kërkohen për t'u punësuar në Gjermani, gjithsesi është njohja e gjuhës gjermane dhe ky është shkaku që interesimi për njohjen e kësaj gjuhe tashmë është bërë preokupim kryesor i të rinjve, ndërkohë që kurset private janë të stërngarkuar me ndjekës. Po rritet edhe numri i studentëve që vendosin të studiojnë gjermanishten

Koha Remzije BILALLI

Shkup, 12 tetor - Numri i folësve të gjuhës gjermane çdo ditë e më shumë po rritet në Maqedoni, ndërsa rreth 70% të studentëve në Gjermani janë nga vendet e sh Jugosllavisë. Raport i publikuar nga "Quartz", bazuar në të dhënat e siguruara nga aplikacioni për mësimin e gjuhëve të huaja "Duolingo", tregon se vendet e Ballkanit përpiqen që ta mësojnë më shumë gjuhën gjermane. Gjermania konsiderohet njëra ndër fuqitë e mëdha të Bashkimit Evropian, ndërsa gjuha gjermane është gjuha më e folur në Europë. Shumë të rinj në Maqedonia edhe më gjerë në rajon, po përpiqen të mësojnë gjermanisht dhe të transferohen me punë në Gjermani, falë programeve që ky shtet ka rinisur vitet e fundit për thithjen e krahut të punës.

Shtimin e interesimit për njohjen e gjuhës gjermane e konfirmuan profesorët universitar dhe ndjekësit e gjuhës gjermane. Gëzim Xhaferi profesor universitar i gjuhës gjermane dhe dekan i Fakultetit të Gjuhëve dhe Komunikimit në UEJL, për gazetën KOHA theksoi se në rritje është edhe numri i studentëve që studiojnë gjuhën gjermane, si rezultat i mundësive më të mëdha të punës.

"Pas gjuhës angleze menjëherë radhitet gjermanishtja duke i zënë vendin gjuhës frënge. Rritja e saj është e pa kontestueshme çdo ditë e më shumë. Tregu i hapur i punës, mundësitë për punësim, janë ndër arsyet kryesore që të rinjtë mësojnë gjuhën, për t'u larguar nga vendi sepse atje e shohin perspektivën. Mirëpo hov të madh ka edhe sektori privat gjerman në Maqedoni ku kërkohen një numër i madh i njohësve të gjermanishtes", tha Xhaferi.

Për tregun e punës gjuhët e huaja ofrojnë një avantazh konkurrues në zgjedhjen e karrierës, sidomos tani duke marrë parasysh rritjen e numrit të kompanive të huaja në vend. Se tregu i Maqedonisë gjithnjë e më tepër është synim i bizneseve gjermane, tregojnë edhe të dhënat e fundit sipas të cilave në vendin tonë punojnë rreth 200 kompani gjermane, të cilat kanë të punësuar rreth 20 mijë veta. Ndërkaq vitin e kaluar shkëmbimi tregtar në mes të dy vendeve arriti në 3,15 miliard euro, kurse Gjermania është një ndër partnerët kryesor tregtar të Maqedonisë. Rreth 20 për qind e importit të përgjithshëm të Maqedonisë, shkon në Gjermani, kurse 15 për qind e importit të përgjithshëm është me prejardhje gjermane.

Një prej kushteve kryesore që kërkohen për t'u punësuar në Gjermani, gjithsesi është njohja e gjuhës gjermane dhe ky është shkaku që interesimi për njohjen e kësaj gjuhe tash më është bërë preokupim kryesor i të rinjve, ndërkohë që kurset private janë të stërngarkuar me ndjekës. Profesoresha Teuta Ismaili e cila mban kurse private në gjuhën gjermane, për gazetën KOHA u shpreh se përveç moshave të reja ka edhe mosha më të vjetra, të cilët janë të interesuar ta mësojnë gjuhën gjermane. Sipas saj shumica e personave që vijnë për ta mësuar gjermanishten janë të interesuar për të ikur jashtë vendit,dhe ata kryesisht janë të rinj me shkolla profesionale si dhe të martuarit në mërgim, të cilët kusht për marrjen e vizës kanë njohjen e gjuhës. Përveç këtyre, është rritur edhe numri i studentëve për të studiuar gjuhën gjermane, në krahasim me vitet e kaluara.

"Në masë të madhe janë target-grupe të caktuar të rinjsh, të cilët orientohen nga nevojat e tregut të punës, siç janë motrat mediciniale, programuesit e IT-së, mjekët dhe të tjerë, por edhe të rinjë të cilët nuk kanë mundur ta gjejnë veten e tyre këtu. Kohën e fundit ka edhe të moshuar të cilët shkojnë të punojnë në Gjermani për disa muaj, të cilët gjithashtu dëshirojnë ta mësojnë gjuhën për nevojat e tyre", sqaron Ismaili.

Sipas saj, edhe studentët të cilët shkojnë gjatë pushimit për të punuar, kanë filluar të mësojnë gjermanishten, ndërsa shumë prej tyre gjejnë mundësi për të vazhduar jetën e tyre atje. Kjo është si rezultat i faktit se Gjermania dhe shtetet tjera gjermanofone u japin shanse profesionistëve që ta zhvillojnë karrierën e tyre, ndërsa punëtorëve të thjeshtë mundësi dhe të ardhura më të mira.

GJERMANISHTJA, GJUHA E DYTE SHKENCORE MË E PËRDORUR NË BOTË

Gjermanishtja është gjuha e dyte shkencore më e përdorur në botë, ndërkaq atë e flasin rreth 220 milion folës në mbarë globin. Viteve të fundit Gjermania mbetet destinacion emigrimi dhe ka interes për migrimin e fuqisë punëtore të kualifikuar, duke iu dhënë mundësi punësimi e karriere studentëve dhe shkencëtarëve nga e gjithë bota. Në Maqedoni ekziston një numër i madh i firmave të cilët u mundësojnë studentëve punë në Gjermani gjatë pushimit veror. Ndërsa siç kanë potencuar edhe ekspertët në të shumtë e rasteve, nevoja për të lëshuar vendin vjen si rezultat i politikës dhe kushteve jo të mira socio-ekonomike.

NË MAQEDONI VEPROJNË 200 KOMPANI GJERMANE

Se tregu i Maqedonisë gjithnjë e më tepër është synim i bizneseve gjermane, tregojnë edhe të dhënat e fundit sipas të cilave në vendin tonë punojnë rreth 200 kompani gjermane, të cilat kanë të punësuar rreth 20 mijë veta. Ndërkaq vitin e kaluar shkëmbimi tregtar në mes të de vendeve arriti në 3.15 miliard euro, kurse Gjermania është një ndër partnerët kryesor tregtar të Maqedonisë. Rreth 20 për qind e importit të përgjithshëm të Maqedonisë, shkon në Gjermani, kurse 15 për qind e importit të përgjithshëm është me prejardhje gjermane.

Rritet numri i turistëve për 15 për qind

Shkup, 12 tetor - Për 15 për qind është rritur numri i turistëve në periudhën janar - gusht të vitit 2018 në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, kumtoi Enti shtetëror për statistikë. Është rritur edhe numri i bujtjeve për 16.1 për qind. "Numri i turistëve vendas është rritur për 14.5 për qind, ndërsa tek ata të huaj për 15.3 për qind, ndërsa numri i bujtjeve tek turistët vendas është rritur për 14.8 për qind, ndërsa tek të huajt për 18 për qind", informojnë nga Enti. Numri i turistëve në muajin gusht të vitit 2018 ka qenë 211.746, ndërsa i bujtjeve 881.806 që është më shumë nga gushti i vitit të kaluar për 12.2 gjegjësisht për 15 për qind. Numri i turistëve vendorë në gusht të vitit 2018 në krahasim me gushtin e vitit 2017 është rritur për 18,1 për qind, ndërsa të të huajve për 5.8 për qind, ndërsa numri i bujtjeve të turistëve vendorë është rritur për 17.9 për qind, ndërsa i turistëve të huaj për 7.6 për qind.

Për një muaj, 349 qytetarë të Maqedonisë kërkuan azil në BE

Bruksel, 12 tetor - Në muajin gusht, 349 qytetarë të Maqedonisë kanë kërkuar azil në vendet e Bashkimit Evropian, ndërsa prej tyre një e treta janë azilkërkues të serishëm prejse njëherë janë refuzuar, tregojnë të dhënat e fundit të Zyrës Evropiane për Azil (EASO). Ende 919 persona nga Maqedonia janë në hap të përgjigjes nga autoritetet (pending).

Në korrik, shifra e kërkesës nga Maqedonia ka qenë 351, ndërsa në tetor të vitit 2017 ka qenë 505. Qytetarët e Serbisë, Maqedonisë dhe Taxhikistanit janë regjistrues rekord për numrin e kërkesave të serishme për azil, që, sipas EASO, tregon se këta persona janë të pranishëm kohë të gjatë në sistemet për azil në vendet anëtare të BE-së.

Banorët e Maqedonisë me një për qind dhe të Moldavisë me zero për qind kanë shkallë më të ulët të miratimit të lejes për azil, pas tyre vijojnë Gjeorgjia dhe Gana me dy për qind.

Në përgjithësi në BE në muajin gusht ka pasur 48 mijë kërkesa për azil, që paraqet rënie prej tetë mijë. Shkalla e miratimit të kërkesave është 33 për qind. Personat nga Siria, Jemeni, Eritrea dhe Palestina kanë shanse më të mëdha t'u pranohet kërkesa për azil.

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM nr 167/2015, 27/2016) dhe nenit 5, 6, 7, 8 dhe 9 të Marrëveshjes kolektive të SHA Elektranat e Maqedonisë, në pronësi të shtetit Shkup, ndërsa në lidhje me Vendimin për nevojën për lidhje të marrëdhënies së punës nr. 04-5410/1 të datës 12.10.2018

SHA ELEKTRANAT E MAQEDONISË – SHKUP
FILIALI REK "BITOLLA" – NOVACI
publikon
SHPALLJE PUBLIKE

Për nevojën e themelimit të marrëdhënien e punës për kohë të pacaktuar të punës në Filialin REK "Bitolla" – Novaci për realizim të punëve për vendet e punës në vijim:

- 1 (një) realizues në vendin e punës me numër 1600/530 "Inxhinier përgjegjës" në Mirëmbajtje të makinerisë – Departamenti për sallë të makinerisë dhe pikat e bashkëngjitura me sallën e makinerisë në NjP -Termoelektranat.
Kandidati krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me Ligj duhet të përmbushë edhe kushtet e posaçme në vijim: shkalla e VII, Fakulteti i makinerisë, 1 vjet përvojë pune.
Shuma në të holla e pagesës fillestare është 46.411,00 denarë.
Java e punës zgjatë 5 (pesë) ditë pune nga dita e hënë deri ditën e premte. Orari i plotë i punës së punëtorit është 40 orë në javë ndërsa gjatë ditës së punës zgjatë 8 orë edhe atë me fillim prej ora 07:00 deri në ora 15:00.
- 1 (një) realizues në vendin e punës me numër 1600/438 "Inxhinier përgjegjës i ndërrimit" në Sektorin e prodhimtarisë në NjP - Termoelektranat.
Kandidati krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me Ligj duhet të përmbushë edhe kushtet e posaçme në vijim: shkalla e VII, Fakulteti i makinerisë/elektroteknikës, 1 vjet përvojë pune.
Shuma në të holla e pagesës fillestare është 48.298,00 denarë.
Java e punës zgjatë 5 (pesë) ditë pune. Orari i plotë i punës së punëtorit është 40 orë në javë, do të realizohet me ndërrime ndërsa gjatë ditës së punës do të zgjasë 8 orë edhe atë: prej ora 07:00 deri në ora 15:00, prej ora 15:00 deri në ora 23:00 dhe prej ora 23:00 deri në ora 07:00.
.- 1 (një) realizues në vendin e punës me numër 1600/444 "Teknik për analizë të procesit" në Sektorin e prodhimit – Shërbimi për analizë të procesit në NJR-Termoelektranat
Kandidati krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me Ligj duhet të përmbushë edhe kushtet e posaçme në vijim: shkalla IV, Makinerisë/Elektroteknikës, 1 vjet përvojë pune.
Shuma në të holla e pagesës fillestare është 29.201,00 denarë.
Java e punës zgjatë 5 (pesë) ditë pune. Orari i plotë i punës së punëtorit është 40 orë në javë, ndërsa gjatë ditës së punës do të zgjasë 8 orë edhe atë me fillim prej ora 07:00 deri në ora 15:00.
.- 2 (dy) realizues në vendin e punës me numër 1600/450 "Drejtues të mullinjve RPV,VDG" në Sektorin e prodhimit – Departamenti për pikat e kazanëve për ngrohje në NJR-Termoelektranat.
Kandidati krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me Ligj duhet të përmbushë edhe kushtet e posaçme në vijim: shkalla III/IV, arsimi i mesëm, 1 vjet përvojë pune
Shuma në të holla e pagesës fillestare është 31.644,00 denarë.
Java e punës zgjatë 5 (pesë) ditë pune. Orari i plotë i punës së punëtorit është 40 orë në javë, do të realizohet me ndërrime ndërsa gjatë ditës së punës do të zgjasë 8 orë edhe atë: prej ora 07:00 deri në ora 15:00, prej ora 15:00 deri në ora 23:00 dhe prej ora 23:00 deri në ora 07:00.

.- 2 (dy) realizues në vendin e punës me numër 1600/457 "Drejtues të pompave kondenzuese dhe për furnizim me energji" në Sektorin e prodhimit – Departamenti për sallë të makinerisë në NJR-Termoelektranat.
Kandidati krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me Ligj duhet të përmbushë edhe kushtet e posaçme në vijim: shkalla III/IV, arsimi i mesëm, 1 vjet përvojë pune.
Shuma në të holla e pagesës fillestare është 31.644,00 denarë.
Java e punës zgjatë 5 (pesë) ditë pune. Orari i plotë i punës së punëtorit është 40 orë në javë, do të realizohet me ndërrime ndërsa gjatë ditës së punës do të zgjasë 8 orë edhe atë: prej ora 07:00 deri në ora 15:00, prej ora 15:00 deri në ora 23:00 dhe prej ora 23:00 deri në ora 07:00.

.- 1 (një) realizues në vendin e punës me numër 1600/461 "Kujdestar ndërrimi elektroteknik" në Sektorin e prodhimit – Departamenti për pika elektroteknike në NJR-Termoelektranat.
Kandidati krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me Ligj duhet të përmbushë edhe kushtet e posaçme në vijim: shkalla III/IV, arsimi i mesëm, 1 vjet përvojë pune.
Shuma në të holla e pagesës fillestare është 30.866,00 denarë.
Java e punës zgjatë 5 (pesë) ditë pune. Orari i plotë i punës së punëtorit është 40 orë në javë, do të realizohet me ndërrime ndërsa gjatë ditës së punës do të zgjasë 8 orë edhe atë: prej ora 07:00 deri në ora 15:00, prej ora 15:00 deri në ora 23:00 dhe prej ora 23:00 deri në ora 07:00.

- 1 (një) realizues në vendin e punës me numër 1600/471 "Drejtues të BOU" në Sektorin e prodhimit në Shërbimin kimiko-teknik në NJR-Termoelektranat
Kandidati krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me Ligj duhet të përmbushë edhe kushtet e posaçme në vijim: shkalla III/IV, arsimi i mesëm, 1 vjet përvojë pune.
Shuma në të holla e pagesës fillestare është 29.867,00 denarë.
Java e punës zgjatë 5 (pesë) ditë pune. Orari i plotë i punës së punëtorit është 40 orë në javë, do të realizohet me ndërrime ndërsa gjatë ditës së punës do të zgjasë 8 orë edhe atë: prej ora 07:00 deri në ora 15:00, prej ora 15:00 deri në ora 23:00 dhe prej ora 23:00 deri në ora 07:00.

- 1 (një) realizues në vendin e punës me numër 1600/489 "Elektricist" Sektori i hirit – Departamenti mirëmbajtja elektroteknike në NJR-Termoelektranat.
Kandidati krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me Ligj duhet të përmbushë edhe kushtet e posaçme në vijim: shkalla III/IV, arsimi i mesëm, 1 vjet përvojë pune.
Shuma në të holla e pagesës fillestare është 33.420,00 denarë.
Java e punës zgjatë 5 (pesë) ditë pune nga dita e hënë deri ditën e premte. Orari i plotë i punës së punëtorit është 40 orë në javë ndërsa gjatë ditës së punës zgjatë 8 orë edhe atë me fillim prej ora 07:00 deri në ora 15:00.

- 1 (një) realizues në vendin e punës me numër 1600/496 "Bravapunues me ndërrime" në Sektorin e hirit – Departamenti për mirëmbajtje të makinerisë në NJR-Termoelektranat.
Kandidati krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me Ligj duhet të përmbushë edhe kushtet e posaçme në vijim: shkalla III/IV, arsimi i mesëm, 1 vjet përvojë pune.
Shuma në të holla e pagesës fillestare është 34.197,00 denarë.
Java e punës zgjatë 5 (pesë) ditë pune. Orari i plotë i punës së punëtorit është 40 orë në javë, do të realizohet me ndërrime ndërsa gjatë ditës së punës do të zgjasë 8 orë edhe atë: prej ora 07:00 deri në ora 15:00, prej ora 15:00 deri në ora 23:00 dhe prej ora 23:00 deri në ora 07:00.

- 1 (një) realizues në vendin e punës me numër 1600/515 "Inxhinier për teknologji" në Sektorin për mirëmbajtje elektroteknike dhe të makinerisë në Departamentin për teknologji në NJR-Termoelektranat.
Kandidati krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me Ligj duhet të përmbushë edhe kushtet e posaçme në vijim: shkalla VI, Fakulteti i makinerisë/elektroteknikës.
Shuma në të holla e pagesës fillestare është 34.752,00 denarë.
Java e punës zgjatë 5 (pesë) ditë pune nga dita e hënë deri ditën e premte. Orari i plotë i punës së punëtorit është 40 orë në javë ndërsa gjatë ditës së punës zgjatë 8 orë edhe atë me fillim prej ora 07:00 deri në ora 15:00

- 2 (dy) realizues në vendin e punës me numër 1600/516 "Teknik për TPP" në Sektorin për mirëmbajtje elektroteknike dhe të makinerisë në Departamentin për teknologji në NJR-Termoelektranat.
Kandidati krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me Ligj duhet të përmbushë edhe kushtet e posaçme në vijim: shkalla IV, Makineri/Elektroteknikë, 1 vjet përvojë pune.
Shuma në të holla e pagesës fillestare është 28.091,00 denarë.
Java e punës zgjatë 5 (pesë) ditë pune nga dita e hënë deri ditën e premte. Orari i plotë i punës së punëtorit është 40 orë në javë ndërsa gjatë ditës së punës zgjatë 8 orë edhe atë me fillim prej ora 07:00 deri në ora 15:00

- 1 (një) realizues në vendin e punës me numër 1600/304 "Udhëheqës i ndërrimit për mirëmbajtje elektroteknike" në Sektorin për elektrooperativë, në Departamentin për eskavatorë në NJR-Rudnik "Suvodoll".
Kandidati krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me Ligj duhet të përmbushë edhe kushtet e posaçme në vijim: shkalla IV, Elektroteknikë, 1 vjet përvojë pune.
Shuma në të holla e pagesës fillestare është 36.529,00 denarë.
Java e punës zgjatë 5 (pesë) ditë pune. Orari i plotë i punës së punëtorit është 40 orë në javë, do të realizohet me ndërrime ndërsa gjatë ditës së punës do të zgjasë 8 orë edhe atë: prej ora 07:00 deri në ora 15:00, prej ora 15:00 deri në ora 23:00 dhe prej ora 23:00 deri në ora 07:00.

- 1 (një) realizues në vendin e punës me numër 1600/314 "Kontabilist për mirëmbajtje elektroteknike" në Sektorin për elektrooperativë në Departamentin për eskavatorë në NJR-Rudnik "Suvodoll".
Kandidati krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me Ligj duhet të përmbushë edhe kushtet e posaçme në vijim: shkalla IV, Elektroteknikë, 1 vjet përvojë pune.
Shuma në të holla e pagesës fillestare është 36.529,00 denarë.
Java e punës zgjatë 5 (pesë) ditë pune. Orari i plotë i punës së punëtorit është 40 orë në javë, do të realizohet me ndërrime ndërsa gjatë ditës së punës do të zgjasë 8 orë edhe atë: prej ora 07:00 deri në ora 15:00, prej ora 15:00 deri në ora 23:00 dhe prej ora 23:00 deri në ora 07:00.
- 1 (një) realizues në vendin e punës me numër 1600/159 "Inxhinier përgjegjës" në Shërbimin për prodhim fillestar – Sistemi i qymyrgurit në NJR-Rudnik "Suvodoll".
Kandidati krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me Ligj duhet të përmbushë edhe kushtet e posaçme në vijim: shkalla e VII/1, Fakulteti i xehetarisë, 3 vjet përvojë pune.
Shuma në të holla e pagesës fillestare është 49.297,00 denarë.
Java e punës zgjatë 5 (pesë) ditë pune nga dita e hënë deri ditën e premte. Orari i plotë i punës së punëtorit është 40 orë në javë ndërsa gjatë ditës së punës zgjatë 8 orë edhe atë me fillim prej ora 07:00 deri në ora 15:00.
- 2 (dy) realizues në vendin e punës me numër 1600/ 040 "Referent për evidencë kadrovike dhe punë të përgjithshme" në Sektorin për çështje juridike, kadrovike dhe të përgjithshme në Shërbimin për çështje kadrovike dhe të përgjithshme.
Kandidati krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me Ligj duhet të përmbushë edhe kushtet e posaçme në vijim: shkalla IV, Gjimnaz, 1 vjet përvojë pune.
Shuma në të holla e pagesës fillestare është 25.315,00 denarë.
Java e punës zgjatë 5 (pesë) ditë pune nga dita e hënë deri ditën e premte. Orari i plotë i punës së punëtorit është 40 orë në javë ndërsa gjatë ditës së punës zgjatë 8 orë edhe atë me fillim prej ora 07:00 deri në ora 15:00

- 1 (një) realizues në vendin e punës me numër 1600/070 "Referent i pavarur për planë dhe analizë" në Sektorin për çështje ekonomike-financiare, Shërbimi për plan dhe analizë.
Kandidati krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me Ligj duhet të përmbushë edhe kushtet e posaçme në vijim: shkalla e VII/1, Fakulteti ekonomik, 2 vjet përvojë pune,
Shuma në të holla e pagesës fillestare është 35.863,00 denarë.
Java e punës zgjatë 5 (pesë) ditë pune nga dita e hënë deri ditën e premte. Orari i plotë i punës së punëtorit është 40 orë në javë ndërsa gjatë ditës së punës zgjatë 8 orë edhe atë me fillim prej ora 07:00 deri në ora 15:00.

- 1 (një) realizues në vendin e punës me numër 1600/099 "Inxhinier përgjegjës për zhvillim" në Sektorin për investime, zhvillim dhe projektim, Shërbimi për investime dhe zhvillim.
Kandidati krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me Ligj duhet të përmbushë edhe kushtet e posaçme në vijim: shkalla e VII/1, Fakulteti teknik, 1 vjet përvojë pune.
Shuma në të holla e pagesës fillestare është 42.636,00 denarë.
Java e punës zgjatë 5 (pesë) ditë pune nga dita e hënë deri ditën e premte. Orari i plotë i punës së punëtorit është 40 orë në javë ndërsa gjatë ditës së punës zgjatë 8 orë edhe atë me fillim prej ora 07:00 deri në ora 15:00.

- 2 (dy) realizues në vendin e punës me numër 1600/103 "Inxhinier përgjegjës projektant" në Sektorin për investime, zhvillim dhe projektim, Shërbimi për projektim.
Kandidati krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me Ligj duhet të përmbushë edhe kushtet e posaçme në vijim: shkalla e VII/1, Fakulteti teknik, 3 vjet përvojë pune,
Shuma në të holla e pagesës fillestare është 42.636,00 denarë
Java e punës zgjatë 5 (pesë) ditë pune nga dita e hënë deri ditën e premte. Orari i plotë i punës së punëtorit është 40 orë në javë ndërsa gjatë ditës së punës zgjatë 8 orë edhe atë me fillim prej ora 07:00 deri në ora 15:00.

- 1 (një) realizues në vendin e punës me numër 1600/105 "Inxhinier i pavarur" në Sektorin për investime, zhvillim dhe projektim, Shërbimi për projektim.
Kandidati krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me Ligj duhet të përmbushë edhe kushtet e posaçme në vijim: shkalla e VII/1, Fakulteti teknik, 1 vjet përvojë pune.
Shuma në të holla e pagesës fillestare është 34.752,00 denarë.
Java e punës zgjatë 5 (pesë) ditë pune nga dita e hënë deri ditën e premte. Orari i plotë i punës së punëtorit është 40 orë në javë ndërsa gjatë ditës së punës zgjatë 8 orë edhe atë me fillim prej ora 07:00 deri në ora 15:00

- 1 (një) realizues në vendin e punës me numër 1600/082 "Referent përgjegjës komercial" në Sektorin për punë komerciale.
Kandidati krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me Ligj duhet të përmbushë edhe kushtet e posaçme në vijim: shkalla e VII/1, të gjitha drejtimet, 1 vjet përvojë pune.
Shuma në të holla e pagesës fillestare është 36.973,00 denarë.
Java e punës zgjatë 5 (pesë) ditë pune nga dita e hënë deri ditën e premte. Orari i plotë i punës së punëtorit është 40 orë në javë ndërsa gjatë ditës së punës zgjatë 8 orë edhe atë me fillim prej ora 07:00 deri në ora 15:00

- 4 (katër) realizues në vendin e punës me numër 1600/089 "Magazinier" në Sektorin për punë komerciale.
Kandidati krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me Ligj duhet të përmbushë edhe kushtet e posaçme në vijim: shkalla III/IV, arsimi i mesëm, të gjitha drejtimet, 1 vjet përvojë pune.
Shuma në të holla e pagesës fillestare është 27.202,00 denarë.
Java e punës zgjatë 5 (pesë) ditë pune nga dita e hënë deri ditën e premte. Orari i plotë i punës së punëtorit është 40 orë në javë ndërsa gjatë ditës së punës zgjatë 8 orë edhe atë me fillim prej ora 07:00 deri në ora 15:00

Shpallja zgjatë 3 (tre) ditë pune nga dita e shpalljes.
Së bashku me fletëparaqitjen (të shkruar me dorë) në të cilën theksohet se për cilin vend pune konkurrohet, kandidatët duhet të parashtrojnë:
- Dëshmi për arsimin e mbaruar (origjinal ose kopje të vërtetuara në noter)
- Dëshmi për përvojën e punës (listë nga SPIM)
- Certifikatë të shtetësisë (kopje)
- Biografi të shkurtë në gjuhën maqedonase
- Kontakt telefon

Fletëparaqitjet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit.
Zgjedhja do të realizohet në afat prej 45 ditëve pas kalimit të afatit për paraqitje.
dokumentet e nevojshme, nga të cilat shihet se kandidati i plotëson kushtet e përgjithshme dhe të posaçme, të dorëzohen në adresën:

FILIALI REK "BITOLA" – NOVACI, Novaçki pat pn, Novaci

FILIALI REK "BITOLLA"

Në përputhje me nenin 1, paragrafin 2 të Ligjit për Letra me Vlerë (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë 95/2005, 25/2007, 7/2008, 57/2010, 135/2011, 13/2013, 188/2013, 43/2014, 15/2015, 154/2015, 192/2015, 23/2016 dhe nr. 83/2018), neni 73 dhe neni 84 nga Ligji për Procedurë të përgjithshme administrative (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 124/2015), Komisioni për Letra me Vlerë i Republikës së Maqedonisë lëshon si vijon:

NJOFTIM

Komisioni i Letrave me Vlerë i Republikës së Maqedonisë kryen dorëzim me botim publik të akteve si vijon:

1. Konkluzioni nr. PRK UP 03-4 nga 21.09.2018 për Veles tabak ShA Veles me adresë në rr. "Alekso Demnievski – Bauman" nr. 63 , Veles dhe
2. Konkluzioni nr. PRK UP 03-7 nga 21.09.2018 për Luiza Janeva me adresë në rr. „Solunska,, 29, Veles, si person përgjegjës i shoqërisë Veles tabak ShA Veles.

Ftohen persona të autorizuar nga shoqëria e lartpërmendur që në afat prej 10 (dhjetë) ditë nga botimi i këtij njoftimi të lajmërohen në hapësirat e Komisionit të letrave me vlerë të Republikës së Maqedonisë dhe t'i marrin aktet e lartpërmendura.

VËREJTJE: Pala paralajmërohet që kjo mënyrë e dorëzimit konsiderohet si dorëzim i rregullt dhe çdo pasojë e mundshme negative që mund të ndodh do të bartet nga vet pala.

Nr 03-807/1
09.10.2018
Shkup

Komisioni i letrave me vlerë
i Republikës së Maqedonisë
Kryetar
Mr.Sc. Nora Aliti

Sipas nenit 97 faqja 1 dhe 2 i ligjit të procedurës e përgjithshme administrative bëhet korrigjimi i gabimit të numrit në aktin administrativ,, Shpallje Publike për punësimin e punëtorëve shëndetësorë dhe bashkëpunëtorëve për punësim në periudhë të pacaktuar kohore me numër. 02-1803/1 prej vitit 05.10.2018 shpallur ne ditë 08.10.2018 prej I.SH.P Spitali i Përgjithshëm – Strugë gazetat zyrtare ,,Slloboden peçat,,dhe ,,Koha,,.

Korrigjim i Shpallje Publike për punësimin e punëtorëve shëndetësorë dhe bashkëpunëtorëve për punësim në periudhë të pacaktuar kohore me numër. 02-1803/1 prej vitit 05.10.2018 shpallur ne ditë 08.10.2018.

Korrigjimi bëhet në pikat e mëposhtme:

1. Në paragrafin 1 të dispozitave në Shpalljen publike në vend të numrit „**18**,, duhet të jetë numri ,,20,, dhe në vend te fjalës (tetëmbëdhjetë) duhet të jetë fjala „**njëzet**,,.
2. Në paragrafin 2 pika 1 të dispozitave në Shpalljen publike në vend „ **Mjek i mediciës – 8 zbatues„** duhet të qëndrojë **„ Mjek i mediciës – 10 zbatues„**
3. Korrigjimi ka veprimin e duhur prej datës 08.10.2018 dmth. nga dita e publikimit të shpalljes publike në gazetat zyrtare ,,Slloboden peçat,,dhe ,,Koha,,.

Dorëzuar deri:
Strugë
-Agjencia për punësim
-Arkivi

I.SH.P Spitali i Përgjithshëm

THIRRJE PUBLIKE

Drejtoria për siguri radioaktive (DSR), në bazë të nenit 42 paragrafi 3 i Ligjit për shfrytëzim dhe posedim me mjetet në pronësi të shtetit dhe me mjetet në pronësi të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 78/15, 106/15, 153/15 dhe 190/16) dhe Vendimit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, nr. 44-7367/1 të datës 22.08.2018, për dhënie të pëlqimit për realizim të procedurës për zgjedhje të subjektit juridik që kryen veprimtari ose posedon leje për grumbullim dhe/ose transport të mbeturinave, për mjete të tundshme, të cilat për shkak të daljet nga afati, mospërdorimi i tyre ose vjetërisë së tyre teknologjike nuk përdoren nga DSR.

Subjektet e interesuara juridike në thirrjen publike kanë për obligim të marrin mjetet e tundshme lëndë e thirrjes publike dhe të njëjtat t'i transportojnë si mbeturina në mënyrën përkatëse, në pajtim me dispozitat ligjore.

Mjetet e tundshme gjenden në lokalet e DSR – bul. Partizanski Odredi nr. 143 – Shkup.

Të drejtë për pjesëmarrje në thirrjen publike kanë të gjitha subjektet e vendit juridike, që posedojnë leje valide për grumbullim dhe/ose transportim të mbeturinave, të dhënë nga organi kompetent.

Personi për kontakt në lidhje me thirrjen publike: Kabir Asani, telefoni për kontakt: 076 446 797, adresa elektronike: kabir.asani@drs.gov.mk.

Informacione më të detajuara për mjetet e tundshme (lista e mjeteve të tundshme), si dhe dokumentacioni i nevojshëm në lidhje me thirrjen publike mund të merren personalisht në lokalet e DSR në rr. bul. Partizanski Odredi nr. 143 – Shkup ose në mënyrë elektronike, përmes linkut në vijim https://drs.gov.mk/index.php/mk/najnovi-sodrzini/114-javen-povik të publikuar në ueb faqen e DSR.

Afati përfundimtar për parashtrimin e fletëparaqitjeve për pjesëmarrje është 5 (pesë) ditë duke konsideruar nga dita e parë e ditës së ardhshme së ditës së publikimit të thirrjes publike.

Në pajtim me Vendimin e Këshillit të shkollës për grumbullim të ofertave për ekskursione të nxënësve, Rregulloren për mënyrën e realizimit të ekskursioneve për nxënës dhe aktiviteteve tjera të lira të nxënësve nga shkollat fillore, Programin Vjetor për punë të shkollës për vitin shkollor 2018/2019 nr. 01-180/1 të datës 31.08.2018 dhe lejes së BZHA nr. 09-14/353 të datës 03.10.2018, SHFK "Krume Kepeski" – Kisella Vodë, Shkup publikon

SHPALLJE
Për grumbullim të ofertave për ekskursione të nxënësve

1. Grumbullim të ofertave për ekskursione të nxënësve:
- Ekskursion treditor për klasën e nëntë nëpër R. Maqedonisë
- Ekskursion dyditor për klasën e gjashtë nëpër R. Maqedonisë
- Ekskursion njëditor për klasën tretë
- Mësim në natyrë për klasën e pestë
- Verime njëditore
- Aktivitete jashtëmësimore – pushim dimëror për nxënësit e klasës VI-IX
- Aktivitete jashtëmësimore – pushim veror për nxënësit e klasës VI-IX

Kriteret minimale për ofertat dhe kriteret për zgjedhje të ofertës më të volitshme në pajtim me rregulloren e MASH për realizimin e ekskursioneve për nxënësit e shkollave fillore.
Ofertuesit e interesuar duhet të marrin dokumentacionin tenderues me programet në arkivin e shkollës çdo ditë pune prej ora 12:00 deri në ora 14:00.
Dokumentet e pakompletuara, jo të plota, të pakrahasueshme dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren aspak parasysh.
Hapja e ofertave do të realizohet pa prezencën e ofertuesve.
Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit.

Komisioni për grumbullimin e ofertave
pranë
SHFK "Krume Kepeski", Shkup

BRENDA VITIT, 850 PACIENTË TRAJTOHEN PËR MUSHKËRITË DHE TUBERKULOZIN

NDOTJA E AJRIT SHTON PACIENTËT NË LESHKË

"Kohëve të fundit kemi pacientë edhe që nuk kanë sëmundje kronike, por që ankohen për probleme shëndetësore dhe kjo vjen si pasojë e ndotjes së ajrit në rajonin e Pollogut", thotë Demiri

Koha Urim HASIPI

Tetovë, 12 tetor - Brenda vitit në Spitalin special për sëmundjet e Mushkërive dhe Tuberkulozës në fshatin Leshkë, trajtim marrin rreth 850 persona. Kryesisht bëhet fjalë për pacientë, të cilët kanë probleme me frymëmarrjen, respektivisht me mushkëritë dhe tuberkulozin. Kështu thotë mjeku Femi Demiri, pneumoftiozlog në këtë spital. Sipas tij, kapaciteti i këtij Spitali është 45 shtretër, ndërsa aktualisht trajtohen 30 pacientë.

"Në këto 45 shtretër mjekohen pacientë që vuajnë nga sëmundjet e mushkërive dhe ata me tuberkulozë. Momentalisht mjekohen 30 pacientë, ndërsa prej tyre katër janë me tuberkulozë, ndërsa tjerët janë me sëmundje tjera kronike të mushkërive, si me astmë, me bronkit, dhe sëmundje tjera të mushkërive, të cilët trajtohen prej 7 deri në 10 ditë më së shumti. Vitet tjera kemi patur prej 800 deri 850 hospitalizime në këtë spital. Nuk kemi ndonjë rritje të theksuar", thotë ai. Në këtë spital, trajtimi zgjatë rreth dy javë, ndërsa më pas pacientët vazhdojnë mjekimin me terapi në shtëpi. Mjekët thonë se më shumë pacientë ka gjatë sezonit të vjeshtës dhe dimrit, por nuk mungojnë edhe pacientët gjatë verës, kur për shkak të ftohjeve nga kondicionerët, ka pacientë që kërkojmë mjekim.

"Në vjeshtë dhe dimër kemi rritje të frekuentimit të pacientëve, të cilët kanë qenë më herët dhe vijnë sërish për shkak të ndezjeve apo përkeqësim i gjendjes së mëparshme tek pacienti me sëmundje kronike, si pasojë e ndryshimeve të temperaturave. Po ashtu, ndryshimi i koncetrimit të pluhurave dhe tymrave që më së shumti keqësohet në kohën e dimrit kur bëhet edhe djegia e materieve për ngrohje që më së shumti përdoren, drunjtë, qymyrit, naftës të cilët e rëndojnë gjendjen e koncetrimit të materieve të ndryshme në ajër. Bashkë me virozat e stinës, kjo e përkeqëson gjendjen e të sëmurëve kronik", thotë mjeku Demiri.

Ai thotë se ndotja e ajrit ka bërë që të rritet numri i pacientëve. "Zakonisht gjatë periudhës se vjeshtës dhe dimrit - viteve të fundit, ka shtim të numrit të pacientëve në krahasim me vitet e kaluara. Kjo si pasojë e ndotjes së ajrit, ku më së shumti pësojnë personat e sëmurë kronikë - sidomos ata që kanë probleme me organet e frymëmarrjes. Kohëve të fundit kemi pacientë edhe që nuk kanë sëmundje kronike, por që ankohen për probleme shëndetësore dhe kjo vjen si pasojë e ndotjes së ajrit në rajonin e Pollogut", thotë Demiri.

Aktualisht në këtë spital ka rreth 32 të punësuar, prej tyre pesë mjek. Ky spital është ndërtuar në vitin 1946, si Sanatorium për mjekimin e tuberkulozit që atë kohë, ka qenë në nivel të lartë, menjëherë pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore. Në vitin 1952, ky Spital transferohet në kuadër të objekteve të Kompleksit të Manastirit, me 120 shtretër. Në vitin 1980 zvogëlohet kapaciteti në 70 shtretër, dhe emërohet Spital i Sëmundjeve të Mushkërive dhe Tuberkulozit. Ndërkaq në vitin 1990, ky Spital integrohet në kuadër të Qendrës Medicinale të Tetovës si repart për këto sëmundje. Në vitin 2001 pushon së funksionuari për shkaqe sigurie deri në vitin 2007, kur edhe me ndihmën e Qeverisë dhe Ambasadës së Norvegjisë, ky spital rifillon me punë dhe funksionon si spital special në vete në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë.

RRITET NUMRI I PACIENTËVE QË KËRKOJNË NDIHMË MJEKËSORE

Koha e virozëve, me lëngje dhe çajëra larg antibiotikëve

Tek më të vegjlit, informojnë mjekët, forma e virusit ka qenë më e ashpër, duke u shoqëruar madje edhe me temperaturë

Koha Delvina KËRLUKU

Shkup, 12 tetor - Viroza e shoqëruar dhimbje koke, temperaturë, skuqje të syve dhe dobësi trupore, ka bërë që shumë qytetarët të vizitojnë poliklinikat dhe urgjencat e spitaleve. Përveç të rriturve, është rritur edhe numri i fëmijëve që po kërkojnë asistencë mjekësore në dyert e pediatrisë. Tek më të vegjlit, informojnë mjekët, forma e virusit ka qenë më e ashpër, duke u shoqëruar madje edhe me temperaturë. Por, sipas mjekëve, nëse trajtohet në kohë, viroza nuk zgjat më shumë se 4-5 ditë, ndërsa këshillojnë përdorim të vitaminës C dhe duke evituar në maksimum antibiotikët.

"Virusi po përhapet me anë të kollitjeve, teshtitjes, me rrjedhje të hundës. Ata që janë më kronik, kanë më shumë komplikacione, ku janë përfshirë të gjitha moshat - prej fëmijëve deri te të moshuarit. Sipas simptomave, duhet të merre edhe terapia, derisa nuk ka komplikacione", tha doktor Merale Ismaili Idriz, nga poliklinika e Bit Pazarit. Edhe në Spitalin e Tetovës janë lajmëruar pacientë me të njëjtat simptome, ku preket edhe sistemi respirator me pengesa në frymëmarrje edhe me kollitje, me temperaturë të lartë, vjellje, marramendje, etj.

"Ditët e fundit është paraqitur një mega-virus që prek sistemin respirator dhe sistemin pastro-intestinal me kokëdhimbje, marramendje, dhe disa simptoma të tjera që prekin sistemin nervor qendror. Ka përfshirë të gjitha grupmoshat, por më të rrezikuar janë pacientët me imunitet të dobët që vuajnë nga sëmundjet e ndryshme kronike qoftë ato kardiovaskulare e të tjera, ku nuk përjashtohen edhe fëmijët, gjegjësisht ata të moshës 2-8 vjeçare", tha për gazetën KOHA, doktor Rexhep Emurllai nga spitali i Tetovës. Mjekët thonë se kemi të bëjmë me një sëmundje virale, që shfaqet në formën e rrufës dhe laringjitit. Ata këshillojnë prindërit të përdorin antibiotikët vetëm kur i rekomandon mjeku. Sipas tyre, shkaqet e virozës janë ndryshimet e menjëhershme të temperaturave, lagështia, ndotja e ambientit... të cilat shkaktojnë probleme në pjesën e sipërme të rrugëve të frymëmarrjes, në faring dhe laring.

Më të predispozuar për t'u prekur nga këto viroza janë fëmijët, personat alergjikë dhe të moshuarit, të cilët janë më të ndjeshëm nga ndryshimet klimaterike dhe nga cilësia e ajrit. Por, nuk përjashtohet as pjesa tjetër e popullatës.

"Të gjithë jemi te rrezikuar për t'u prekur nga të tilla viroza", thonë mjekët. Ata sqarojnë se, nëse brenda 5 ditëve viroza nuk ka kaluar, atëherë kemi të bëjmë me komplikacione.

Tri ditët e para, thonë mjekët, është normale që temperatura të jetë e lartë dhe mund të zgjasë deri në pesë ditë. Por kurrsesi nuk duhet ndërhyrë me antibiotik, sepse i duhet lënë kohë organizmit të reagojë. Thjesht, këshillojnë mjekët, ajo duhet mbajtur nën kontroll dhe vetëm nëse ajo ripërsëritet, pra nëse pas një periudhe qetësie rishfaqet, atëherë duhet përdorur antibiotiku. Lëngjet e frutave dhe çajet e shumëllojshme bimore japin efekte lehtësuese në rrugët e frymëmarrjes dhe në fyt, duke bërë që kolla të zbutet. Mjekët thonë se është periudha e entro-viruseve, prandaj duhet patur kujdes në higjienë dhe në të ushqyerit.

“Kurora e Artë” e Fatos Arapit

Nga
Daut DAUTI

Pas Dritëro Agollit, shkoi në amshim edhe një emër nga “treshja”. Fatos Arapi...Një lajm i hidhur, por i natyrshëm(në moshë 89 vjeçare), si fatalitet jetësor.

Kur ishim nxënës (në fillore dhe gjimnaz), kur mësonim për letërsinë bashkëkohore, kishte një klishe. Kur përmendeshin shkrimtarët nga Shqipëria, përmendej një treshe e shkrimtarëve më të shquar: Ismail Kadare, Dritëro Agolli dhe Fatos Arapi. Kjo ishte treshja “olimpike” ta quash, treshja e Majës së Olimpit të letërsisë shqiptare(të paktën asaj që krijohej në Shqipëri në kohën e socializmit), kurse të tjerët ishin për të përmbushur “konkurrencën” që do të mateshin me treshen. Kështu zaten ishin trajtuar në vetë Shqipërinë. Dhe ne që ishin lexues të pasionuar, e merrnim pikërisht këtë status të tyre, i cili sa letrar, ishte dhe shoqëror. Kadareja e kishte zënë vendin me prozën e tij të magjishme, Dritëro Agolli ishte bërë “popullor” me poezitë që lexoheshin e kuptoheshin lehtë, ndonëse jo pa thellësi. Kurse Fatos Arapi, disi nën hijen e “të dytit”, i cili gjatë kohë ishte edhe “pushtet letrar”(si kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë), por që me lirikën e tij aspak nuk ishte inferior. Kur në gushtin e vitit 1990, si pjesëmarrës në Mbrëmjet Strugane të Poezisë pata rastin të takohem me Dritëro Agollin(me të cilin kisha bërë një intervistë shumë të kujdesshme për të mos e futur llugave!), nuk pandehja se vetëm një muaj e gjysmë më vonë, do t’më realizohej ëndrra për ta parë Shqipërinë, si pjesë e një delegacioni të shkrimtarëve nga Maqedonia(Mateja Matevski, Nijazi Muhamedi, Todor Çallovski dhe unë) me ftesë të Dritëro Agollit. Gjatë qëndrimit në Tiranë, në ato takime të shumta me nikoqirët, do të kem mundësi të takohem edhe me Fatos Arapin. Po shkrimtari im më i lexuar, Ismail Kadare, që prisja të më jepet mundësia ta takoj, ato ditë ishte në Paris, destinacionin e tij të kohëpaskohshëm kur i botoheshin veprat atje. Atë tetor të vitit 1990, që qe një muaj “i mbrapshtë” për socializmin shqiptar, Ismail Kadareja, gjersa pritej të kthehet, ai papritmas shpalli ekzilin politik në Francë, me çka pastaj mori hov edhe lëvizja studentore e dhjetorit që do ta çojë Shqipërinë drejt pluralizmit politik.

• *Në oborrin e shtëpisë së Fatos Arapit, me gazetarin Arben Muka*

Por, ky shkrim është për Fatos Arapin, për poetin e madh, i cili në ato takime m’u shfaq si tepër njerëzor, tepër për tokë, pa atë madhështinë e poezisë së tij gjersa ulej me një poet fillestar. Vetëm pak muaj më vonë, m’u dha mundësia të përcillja dhe të raportoja për zgjedhjet e para pluraliste të Shqipërisë(1991), e pastaj prapë të rejat (1992), në kohë ndryshimesh të mëdha, kur do të qëndroja nga më shumë ditë, dhe përherë do të gjeja kohë, pos takimeve me shkrimtarë të tjerë, për t’u takuar me Dritëronë ose Fatosin, të shpeshtën në kafenenë e Lidhjes së Shkrimtarëve, e ndonjëherë edhe mysafir në shtëpitë e tyre. Nga njëra prej këtyre vizitave është edhe kjo foto, kur patëm shkuar me gazetarin Arben Muka, në një rrugë afër Televizionit Shqiptar, kur na pati pritur me zonjën e tij, ashtu siç i ka hije në një shtëpi shqiptare. Më kishte habitur fakti kur prej tij kuptova se me profesion ishte ekonomist, sepse nuk mund ta paramendoja se si një profil i tillë të shkruajë poezi nga më të bukurat në letërsinë shqipe.

Ndonjë vit më pas, redaksia e botimeve të “Flakës së vëllazërimit” i botoi një libër me novela për çka ishte tejet i lumtur dhe disi relacionet tona ishin sa miqësore aq edhe krijuese.

Pluralizmi në Shqipëri solli edhe shumë prurje të reja edhe në fushën e krijimtarisë. U shfaqën në skenë edhe shkrimtarët të cilët kishin qenë të persekutuar ose të anatemuar, të cilët në kushte të reja shpërthyen me gjithë talentin dhe potencialin e tyre krijues. “Treshja” ku hynin Fatosi, Kadareja dhe Agolli ishte tashmë “e rrezikuar”, por krijimtaria nuk është një fushë sporti ku mund të maten rezultatet me precizitet sa të dihet kush është i pari(ndonëse këtë tashmë natyrshëm i takon Kadaresë), kush i

Edhe pse Mbrëmjet Strugane të Poezisë janë nga manifestimet më të njohura poetike në botë, ku vijnë dhjetëra poetë nga mbarë bota, atë vit(2008) në shtypin shqiptar për fituesin Fatos Arapi nuk u shkrua fare ose u shkrua pak! Madje ne disa krijues dhe gazetarë nga Maqedonia shprehnim habinë se si ministri shqiptar i kulturës (nëse nuk gaboj, as ambasadori i Shqipërisë në Maqedoni), nuk e gjeti të udhës të vijë e ta madhërojë këtë sukses të poetit të madh

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS

Koha
Epërdítshme informative
www.koha.mk

Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovasja lok.14 - përdhesë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi:“Adria Media Ballkan” - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e premte 12 tetor | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: **Lirim DULLOVI** | Kryeredaktor: **Vedat MEMEDALIU** | Redaktor përgjegjës: **Emin AZEMI** | Ndihmëskryeredaktor: **Evis HALILI** | Redaktor teknik: **Halil BERISHA**
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: **Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221**
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve **Inter Partes** - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhirollogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

dyti, i treti...i dhjeti, i njëqindti...Shumë autorë nisën ta ndjejnë veten "të fortë" sa të sfidojnë këtë treshe, shpesh dhe duke thënë se "midis tyre mund të futet dikush tjetër" dhe ta prishë rendin. Realisht edhe mund të ishte ashtu. Por, vlerat janë vlera, dhe ato i kanë që të tretë nga treshja, sikundër që i kanë edhe shumë autorë të tjerë po të kohës së tyre ose që do të shfaqen më vonë. Secili ka udhën e tij krijuese, stilin, gjuhën, temat ...me të cilat komunikon me lexuesin. Në këtë këndvështrim, nuk e kam shikuar se Fatos Arapi, me gjithë ato vepra pas vetes, të ndjehej "i rrezikuar".

Duke shkruar vite me radhë kolumna për gazetën "Dnevnik", pikërisht para auditorit maqedonas e kam vënë në shënjestër faktin se për dekada me radhë, në Mbrëmjet Strugane të Poezisë asnjëherë nuk i është ndarë Kurora e Artë ndonjë poeti shqiptar! Kanë fituar poetë serbë, maqedonas, bullgarë, turkë, kroatë..., por jo dhe shqiptarë.(Sikundër edhe për faktin se Akademia Maqedonase e Arteve dhe Shkencave është e mbyllur për shqiptarët...). Nuk mund të them sa ka pasur ndikim ndonjë tekst i këtillë nga unë ose ndonjë autori a medie tjetër në gjuhën shqipe, por edhe këto barriera u thyen një ditë, dhe në vitin 2008, fituesi i Kurorës së Artë në mbrëmjet poetike të Strugës, u bë pikërisht Fatos Arapi. Më kujtohet prapaskena e këtij vendimi, si një hall i madh i kështillit të këtij manifestimi, sepse nuk ka qenë lehtë të merrej vendimi kujt t'ia japin. Nga Shqipëria ka pasur shumë pretendentë (Dritëro Agolli, Visar Zhiti, Xhevahir Spahiu...) që kishin marrë pjesë shpesh në këtë manifestim, porse ka qenë e vështirë që prej atje të merrej ndonjë propozim nga Lidhja e

Shkrimtarëve për shkak të hatërmbetjes. Njësoj ka qenë edhe këndej, ku fjalën kryesore e kanë pasur disa shkrimtarë dhe kritikë letrarë...Nuk më është e njohur krejtësisht se si erdhi deri te zgjedhja e Fatos Arapit, por mendoj se poezia e tij meritonte çmimin e këtij manifestimi me përmasa botërore, por po t'më pyeste dikush paraprakisht, siguristh se pa hamendësime do ta kisha përmendur atë.

Por më vjen mirë që kur erdhi për ta marrë Kurorën e Artë, kishte pyetur edhe për mua dhe ndonëse nuk isha pjesëmarrës, shkova gjer në Strugë kastile për të. Ishte paksa shëndetlig dhe nuk mund t'i përcillte të gjitha aktivitetet e këtij manifestimi, por ishte gëzim që ta takoja përsëri. E meritonte poezia shqipe ta ketë një fitues, sepse kaherë edhe poeti Ante Popovski kishte thënë se poezia shqipe është njëra nga më të mirat në Ballkan dhe Evropë.

Mirëpo, edhe pse Mbrëmjet Strugane të Poezisë janë nga manifestimet më të njohura poetike në botë, ku vijnë dhjetëra poetë (më parë edhe qindra) nga mbarë bota, atë vit në shtypin shqiptar(gazeta, televizione...), për fituesin Fatos Arapi nuk u shkrua fare ose u shkrua pak! Madje ne disa krijues dhe gazetarë nga Maqedonia shprehnim habinë se si ministri shqiptar i kulturës (nëse nuk gaboj, as ambasadori i Shqipërisë në Maqedoni), nuk e gjeti të udhës të vijë e ta madhërojë këtë sukses të poetit të madh. Fatos Arapi edhe pa atë çmim letrar do të mbetej i madh, por ai kështu e afirmonte edhe i letërsisë shqipe, prandaj një ministër i kulturës duhej të merrte pjesë në ceremoninë e ndarjes dhe kjo në pikëpamje protokollare nuk ka qenë vështirë të realizohej. Jo vetëm për respekt të Fatos Arapit, por për vendin prej nga vinte ai.(Nga ana tjetër, Fatosi mbeti larg medias në gjuhën shqipe që donin ta intervistonin, ngase i biri, i cili e shoqëronte gjithë kohën, ndoshta për së tepërmi, kujdesej të mos e shqetësonin për shkak të gjendjes së hajthme fizike...)

Pas atyre disa ditëve shoqërim me Fatos Arapin në Mbrëmjet Strugane, disi u krijuan rrethanat për t'u larguar nga gazetaria dhe nuk kam shkuar më në Tiranë, por duke e parë se ka qenë larg syve të medias, kam supozuar se kondicioni i tij fizik nuk i ka mundësuar shumë për dalje në publik.

Por, fati i krijuesve dallon nga ai i njerëzve të rëndomtë, sepse veprat e tyre gjithnjë e sfidojnë vdekjen dhe i mbajnë gjallë përjetë. E tillë është edhe vepra e Fatos Arapit.

(Autori është kolumnist i rregullt i gazetës KOHA)

Marrëveshja e duhur

Nga
Dr.Arben TARAVARI

Si duket, saga e emrit të Maqedonisë po kërkon në formën e saj të vendosen pikat mbi "i". Ngadhnjimi emocional i disa maqedonasve se ndërrimi i emrit është tradhti e rëndë kombëtare bie ndesh madje përplaset keq me defaktorizimin, përndjekjen dhe injorimin ndërshekullor të tyre ndaj shqiptarëve!

Nuk dua të hyj në statistika jo zyrtare, ku thuhet se 400 mijë prej tyre janë shpallur bullgarë për të marrë pasaportë bullgare që të kenë mundësi të gjejnë punë e ushqim, por ja, le të mbetemi tek e tashmja zyrtare që na ofrohet. Lufta për ndërrimin e emrit u largua nga populli dhe është nisur drejt sallës së Parlamentit. Pasi në Maqedoni zbarkuan politikanë të niveleve më të larta duke arritur pikun me ardhjen e vet Kancelares Merkel frymëmarrja e të cilës vlen mijëra euro në sekondë, kjo gjë nuk mjaftoi, u kuptua që politika perfide e Maqedonisë ia hodhi dhe vet ndërkombëtarëve.

Dolën në darkë të trishtuar e të gëzuar, disa madje ja morën dhe valles nga gëzim që nuk kishin dalë aq votues sa duhej, në të njëjtin shesh ku kanë sharë e mallkuar deri në vdekje shqiptarët. Që atë natë partitë politike, me një tufë analistësh nga prapa, të mençur dhe jo, nxituan të drejtonin gishtat mbi fajtorë e mbi heronj e mbi tradhtarë... Kjo mesele do vazhdonte me muaj e me vite por Zaevi ka bërë pakt me botën dhe natyrisht që kjo e fundit nuk është mësuar me të ashtuquajturën politikë ballkanase që i zgjat aq shumë vendimet sa harrohen qëllimet, dështimet e sidomos krimet.

Kështu ndërkombëtarët kanë dhënë afat të qartë dhe tani duket se janë të përfshirë me një kontekst më ballkanik për të arritur qëllimin e tyre. Korridoreve parlamentare, të cilat ngjajnë kafeneve aq shumë në Maqedoni, spekulohet se ka filluar të flitet deri për shifra konkrete parash.

Deputetët e VMRO-së që janë vënë në tepsinë e artë janë ata që e miratojnë marrëveshjen e Prespës ose e çojnë në kosh të plehrave. Kështu mendon Zaevi, kështu mendon dhe do Ahmeti, e për fat të keq kanë bindur dhe ndërkombëtarët se ata individë mbajnë në dorë të ardhmen e vendit...duket kinse kanë harruar që ka dhe një parti tjetër e cila ka lirinë dhe fuqinë e vendimmarrjes, e cila është e përfaqësuar me dy deputetë në parlament, të cilët duan dhe bëjnë çmos që kjo marrëveshje të jetësohet por kanë edhe disa kërkesa korrekte, të cilët janë konkluza të Kuvendit Qendror të kësaj Partie. Po flas për partinë Aleanca për Shqiptarët, e cila çuditërisht është përllogaritur e mirëqenë si votuese e ndryshimit të emrit. Duket se partia ku bëj pjesë po injorohet nga të gjithë dhe jo nga naiviteti por nga

Zotërinj të veçantë, të cilët natën vrasin e ditën marrin pjesë në funerale, duhet të kujtohen se asgjë nuk është e përjetshme, as inati, as e mira dhe as frika e tyre. Ky është moment që duhet t'i ulemi përballë njëri-tjetrit kështu si jemi, me kërkesat tona, nëse duam të jetojmë në një shtet...

lojërat aspak të ndershme politike. Pse janë kaq mospërfillës ndaj ASH-së?!

Kjo parti e do NATO-n dhe BE-në dhe i sheh si rrugë të sigurta për të ecur, por aty do të shkojë me disa kushte që vet NATO dhe BE-ja i kanë shumë të rëndësishme. Meqë për arsye më shumë të errëta e aspak të qarta, tashmë pushteti ka nevojë për një marrëveshje ndërpartiake për të votuar nga dhoma parlamentare Marrëveshjen e Prespës atëherë ne jemi gati për Marrëveshje. Marrëveshje domethënë që dy ose më shumë palë ulen dhe dëgjojnë njëri-tjetrin. Domethënë flasin e merren vesh. Për t'u dëgjuar duhet të kesh dhe ç'të thuash, ndaj ne jemi gati për Marrëveshje se kemi ç'të themi.

Kemi disa pika që i cilësojmë të një rëndësie të madhe për harmoninë e të gjithë etnive që jetojnë në Maqedoni. Pika të cilat nuk shqetësojnë as faktorin e brendshëm e as të jashtëm por përkundrazi krijojnë klimë solide për një bashkëjetesë paqësore dhe me respekt të ndërsjellë. Aleanca për Shqiptarët nuk ka asnjë lloj frustracioni politik por ka dëshmi të shumta, reale, të mungesës së fjalës në politikë.

Në kuadër të kësaj përvoje, meqë situata erdhi që tashmë të ketë një Marrëveshje Zotërinjsh atëherë le të reagojmë si të tillë. Le të ulet LSDM-ja me ne dhe le të zyrtarizohet në letër të bardhë ajo çfarë i është premtuar shqiptarëve pas zbatimit të marrëveshjes. Nuk ka marrëveshje pa kërkesa. Këto janë tonat. Kërkesa të cilat janë kaq të lehta për t'u zbatuar aq sa fakti që janë menduar për një fazë tjetër duket se janë vetëm kapriço politike.

Evropa ka mbrojtur gjithnjë kombet, gjuhën dhe traditën e tyre, në thelb të saj kërkesa që ne të identifikohemi si popull shqiptar me gjuhën tonë zyrtare në një shtet ku marrim pjesë si fatvendosës, është një nga esencat e Evropës. Aleanca për Shqiptarët nuk ka asnjë kërkesë që lidhet me pozita apo nënpozita, të vetmet, të thjeshta, që nuk prishin asnjë ekuilibër diplomatik me Greqinë janë këto.

Presim që Kryeministri të na kontaktojë sa më shpejt pasi NATO dhe Evropa janë mundësi të jashtëzakonshme për të gjithë ne. Të gjithë ato subjekte të tjera partiake që krijojnë strategji komplikuese për të shpëtuar nga ndonjë batak ligjor apo për të përfituar ekonomikisht, janë në vendin dhe kohën e gabuar. Çdo përpjekje jona si parti politike duhet të përqendrohet në standardin e duhur demokratik, qytetarët duhet të kenë atë për të cilën pritën kaq gjatë, të ardhmen e tyre evropiane.

Zotërinj të veçantë, të cilët natën vrasin e ditën marrin pjesë në funerale, duhet të kujtohen se asgjë nuk është e përjetshme, as inati, as e mira dhe as frika e tyre. Ky është moment që duhet t'i ulemi përballë njëri-tjetrit kështu si jemi, me kërkesat tona, nëse duam të jetojmë në një shtet...

(Autori është kolumnist i rregullt i gazetës KOHA)

Rubrika "Forum" është krijuar si hapësirë për të botuar letrat, opinionet, reflektimet dhe reagimet e lexuesve dhe qytetarëve.
Redaksia mban të drejtën për të redaktuar e shkurtuar, si dhe mos botuar ato shkrime që nuk i përmbahen etikës.

REPUBLIKA E MAQEDONISË
AGJENCIA E ADMINISTRATËS

Në bazë të nenit 35 të Ligjit të Nëpunësve Administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16, 142/16 dhe 11/18) dhe Rregullores së mënyrës së zbatimit të procedurës për punësim të nëpunësve administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/18), lidhur me nenin 20-g të Ligjit të punësuarve në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18) dhe Rregullores së elementeve të obligueshme të shpalljes publike të plotësimit të vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe të formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrit të personave që kanë dhënë të dhëna të rrejshme gjatë punësimit në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 34/15), Agjencia e Administratës publikon

SHPALLJE PUBLIKE NUMËR – 206/2018

për punësimin e 10 nëpunësve shtetëror nga grupi I, nëngrupi I në „Qytetin e Shkupit "për vendet e punës në vijim:

1. UPR0101V04000 Bashkëpunëtor i ri 1 realizues(ë)
për evidencë, Njësia për koordinim të buxhetit, Sektori për çështje financiare

Kushtet e përgjithshme:
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:
- niveli i kualifikimeve VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, shkencat ekonomike
- me ose pa përvojë pune

Kompetencat e përgjithshme:
- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

Orari i punës :
- Ditët e punës e hënë-e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:30 - 16:30

Rroga neto: 20.961,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Shqiptar(e) 1.

2. UPR0101V02000 Bashkëpunëtor i lartë për rregullativë, Njësia për normativë, Sektori për punë juridike 1 realizues(ë)

Kushtet e përgjithshme:
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:
- niveli i kualifikimeve VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, shkencat juridike
- së paku 2 (dy) vjet përvojë pune në profesion

Kompetencat e përgjithshme:
- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

Orari i punës :
- Ditët e punës e hënë e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:30 - 16:30

Rroga neto: 23.231,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Shqiptar(e) 1.

3. UPR0101V04000 Bashkëpunëtor i lartë për kategorizimin dhe emërtimin e rrugëve, Njësia për kategorizimin, numërimin dhe emërtimin e objekteve infrastrukturore, Sektori për punë komunale 1 realizues(ë)

Kushtet e përgjithshme:
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:
- niveli i kualifikimeve VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, arkitekturë, urbanizëm dhe planifikim ose administratë publike dhe administratë ose shkencat ekonomike
- së paku 2 (dy) vjet përvojë pune në profesion

Kompetencat e përgjithshme:
- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

Orari i punës :
- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:30 - 16:30

Rroga neto: 23.231,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Shqiptar(e) 1.

4. UPR0101V03000 Bashkëpunëtor për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave dhe informacionit në fushën e arsimit të mesëm, Njësia për arsim, Sektori për arsim 1 realizues(ë)

Kushtet e përgjithshme:
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:
- niveli i kualifikimeve VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, shkencat ekonomike, sociologji ose arsim
- së paku 1 (një) vit përvojë pune në profesion

Kompetencat e përgjithshme:
- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

Orari i punës :
- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:30 - 16:30

Rroga neto: 22.474,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Shqiptar(e) 1.

5. UPR0101V04000 Bashkëpunëtor i ri për arsim të mesëm, Njësia për arsim, Sektori për arsim 1 realizues(ë)

Kushtet e përgjithshme:
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:
- niveli i kualifikimeve VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, shkencat politike ose arsim
- me ose pa përvojë pune

Kompetencat e përgjithshme:
- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

Orari i punës :
- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:30 - 16:30

Rroga neto: 20.961,00 denarë

Vazhdon →

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Turk(e) 1.

6. UPR0101V04000 Bashkëpunëtor i ri 1 realizues(ë)
për integrime evropiane, Njësia për integrime evropiane, Sektori për bashkëpunim ndërkombëtar dhe bashkëpunim dhe mbështetjen e shoqatave dhe fondacioneve

Kushtet e përgjithshme:
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:
- niveli i kualifikimeve VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, shkencat juridike
- me ose pa përvojë pune

Kompetencat e përgjithshme:
- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

Orari i punës :
- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:30 - 16:30

Rroga neto: 20.961,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Nacionalitete të tjera 1.

7. UPR0101V04000 Bashkëpunëtor i ri 1 realizues(ë)
për marrëdhënie me Publikun, Njësia për marrëdhënie me publikun dhe informim të qytetarëve, Sektori për mbështetje të Prefektit

Kushtet e përgjithshme:
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:
- niveli i kualifikimeve VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, arsim ose shkencat politike ose shkencat organizative dhe menaxhim (menaxhment)
- me ose pa përvojë pune

Kompetencat e përgjithshme:
- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

Orari i punës :
- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:30 - 16:30

Rroga neto: 20.961,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Rom(e) 1.

8. UPR)101V02000 Bashkëpunëtor i lartë 1 realizues(ë)
për përgatitjen e materialeve dhe dokumenteve të prokurimit publik, Njësia për furnizime publike, Sektori për punë të përgjithshme

Kushtet e përgjithshme:
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:
- niveli i kualifikimeve VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, shkencat juridike, shkencat ekonomike
- së paku 2 (dy) vjet përvojë pune në profesion

Kompetencat e përgjithshme:
- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

Kushtet shtesë:
- Vërteitm përkatës për provimin e kaluar për person për furnizime publike

Orari i punës :
- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:30 - 16:30

Rroga neto: 23.232,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Shqiptar(e) 1.

9. UPR0101B02000 Udhëheqës i Sektorit - Inspektorati i Qytetit të Shkupit - Kryeinspektor, Sektori - Inspektorati i Qytetit të Shkupit 1 realizues(ë)

Kushtet e përgjithshme:
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:
- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, arkitekturë, urbanizëm dhe planifikim, shkencat juridike ose punës sociale dhe politikës sociale
- më së paku 5 (pesë) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 2 (dy) vjet udhëheqës në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku 8 (tetë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 3 (tre) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat

Kompetencat e përgjithshme:
- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- punë me të tjerë/punë ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara
- udhëheqje; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- çertifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

Orari i punës :
- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:30 - 16:30

Rroga neto: 35.846,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.

10. UPR0101V02000 Këshilltar i lartë 1 realizues(ë)
për dokumentacionin teknik, Njësia për inspektim komunal, Sektori - Inspektorati i Qytetit të Shkupit

Kushtet e përgjithshme:
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:
- niveli i kualifikimeve VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, shkencat ekonomike
- së paku 2 (dy) vjet përvojë pune në profesion

Kompetencat e përgjithshme:
- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

Orari i punës :
- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:30 - 16:30

Rroga neto: 23.232,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Shqiptar(e) 1.

Kushtet e lartpërmendura në shpallje kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit në formë elektronike nëpërmjet profilit të përdoruesit të krijuar në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës.

Afati i aplikimit zgjatë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes. Pas mbarimit të afatit për aplikim, shpallja do të jetë e larguar nga faqja e internetit e Agjencisë.

Pas kalimit të afatit të aplikimit, shpallja do të jetë e hequr nga faqja e internetit e Agjencisë.

Kandidatëve u kërkohet fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, të jenë precizë dhe të japin të dhëna të sakta. Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike në faqen e internetit të Agjencisë së administratës do të informohen, për kohën dhe vendin e mbajtjes së çdo faze të ardhshme të procedurës për selektim të nëpunësit administrativ.

Faza e 1 – rë: selektimi administrativ realizohet në një afat prej 15 ditësh pas mbarimit të shpalljes së publikuar.

Faza e 2 – të: provimi i nëpunësit administrativ realizohet në një afat jo më të shkurtër se 10, dhe jo më të gjatë se 30 ditë pas mbarimit të fazës së 1 – rë. Ai incizohet dhe emetohet drejtpërdrejtë në faqen e internetit të Agjencisë së administratës.

Faza e 3 – të: kontrollimi i vërtetësisë së provave dhe intervista realizohet në një afat prej 10 ditësh pas mbarimit të fazës së 2 – të.

"GASTARBEITER". ERDHËN PËR NJË VIT, POR MBETËN PËRGJITHMONË

50 vjet më parë, më 12 Tetor 1968 Gjermania nënshkroi Marrëveshjen për Tërheqjen e Fuqisë Punëtore me Jugosllavinë socialiste, marrëveshja për "gastarbeiter". Shumë vetë erdhën për një vit, por qëndruan një jetë

Para pikërisht 50 vjetësh, më 12 Tetor 1968 Republika Federale Gjermane nënshkroi Marrëveshjen për Tërheqjen e Fuqisë Punëtore me Jugosllavinë atëherë socaialiste, të njohur si marrëveshja për "gastarbeiter" - punëtorë të ftuar për një kohë të caktuar. Shumë vetë erdhën për një vit, por qëndruan një jetë.

Gardh me gjemba, policia me mitralozë, qen kufiri, vështrime të rrepta dhe uniforma që të kujtonin kampet në Luftën e Dytë Botërore. Këto janë përshtypjet e para të Bosiljka Schedlich, atëherë 19 vjeçare, që erdhi si punëtore e (Gastarbeiter) para 50 vjetësh në Berlin. Aeroplani i solli punëtorët në Berlinin lindor, pastaj me një autobus ata kaluan kufirin për në Berlinin Perëndimor. Edhe në Berlinin Perëndimor dukeshin plagët e luftës. "I pashë gjurmët e luftës edhe në fytyrat e shumë grave të vetmuara, që dilnin të shëtisnin me qen. I pashë në krahët apo këmbët që mungonin, burra që shtyheshin me karrocën e invalidit dhe pyesja veten -ku ka qenë ata në luftë", kujton sot 69 vjeçarja.

Edhe në bodrumin e konviktit ku banonte Bosiljka me 1.200 punëtorë të tjerë, banonin gjermanë të dëbuar nga Prusia Lindore. "Për mua ishte një takim me të shkuarën që kishin përjetuar prindërit e mi". Por Bosiljka kish ardhur për të ardhmen në Gjermani, për të fituar para për studimet. "Erdha për një vit, por ky vit nuk po përfundon kurrë", thotë pensionistja, që ka ardhur të kalojë pushimet në një shtëpizë të vogël fshati në ishullin kroat Shipan.

GJYSMA E RROGËS PËR KURSIN E GJERMANISHTES

Rinovimi i kësaj shtëpie është për Bosiljkan edhe një "kthim tek rrënjët", sepse dalmatja lindi si Bosiljka Grgurević në Split dhe vendosi pas maturës, si shumë bashkëkombas të vij në Gjermani, kur u hap rruga për Marrëveshjen e Fuqisë Punëtore me Jugosllavinë. Ajo punoi fillimisht në një fabrikë, për të pnuar gjysmë viti më vonë si përkthyese në një konvikt për gratë. Deri në këtë moment historia e saj i ngjason shumë të tjerëve që erdhën si "gastarbeiter". Por pastaj ajo vendosi të ndjekë një rrugë tjetër. Gjysmën e rrogës e shpenzoi për të mësuar gjermanisht, filloi të gjejë punë më të mira dhe pastaj filloi studimet në Universitetin e Lirë të Berlinit (FU). "Jeta më kishte mbërthyer dhe nuk e mendoja më kthimin".

Josip Juratovic është sot deputet i Partisë Socialdemokrate në Gjermani

Shumë nga të ardhurit e tjerë nga Jugosllavia qëndruan në modelin e punëtorit. "Qëllimi i tyre nuk ishte largimi nga Jugosllavia", thotë historiani nga Beogradi, Vladimir Ivanovic", aktualisht studiues në Universitetin humboldt në Berlin, i cili e ka trajtuar nga ana shkencore temën e punëtorëve të ardhur me marrëveshjen e fuqisë punëtore në Gjermani. "Qëllimi i tyre ishte të fitonin në kohën më të shkurtër sa më shumë para, me qëllim që të zgjidhnin disa probleme të ekzistencës, probleme banimi, apo për të blerë makineri të caktuara. Disa erdhën vetëm për të blerë një motor, për të shitur mend në shëtitoren e Splitit. Pra motivet ishin nga më të ndryshmet, por të gjithë erdhën për të punuar për një kohë të caktuar".

FËMIJËT QË QËNDRUAN TEK GJYSHËRIT

Edhe deputeti socialdemokrat, Josip Juratovic e konfirmon këtë. "Punëtorët që erdhën atëherë në Gjermani, e kuptuan edhe veten si gastarbeiter, pra i ftuar për një kohë të caktuar. Gjenerata e parë mendoi pra të mblidhte ca para dhe të kthehej. Edhe Juratovic vetë është gastarbeiter. Nëna e tij erdhi për të punuar në një fabrikë konserve në Jugosllavi në vitin 1968 dhe e la djalin tek gjyshërit, si shumë familje të tjera. Pas shkollës Josip Juratovis erdhi tek nëna në Gjermani dhe filloi shkollën profesionale si mekanik në Heilbronn. Pas 20 vitesh punë filloi edhe karriera si politikan. "Unë erdha si gastarbeiter, u bëra emigrant, dhe sot jam gjerman me sfond migracioni".

Punëtorë jugosllavë duke pritur në stacionin e Frankfurtit të shkojnë për Krishtlindje në shtëpi, 19.12.1970

Një fjali që përshkruan fatin e më shumë se 1,5 milionë njerëzve që erdhën nga Jugosllavia në kuadër të Marrëveshjes së Fuqisë Punëtore me Gjermaninë. Ata u quajtën "Jugot" në Gjermani, dhe në vitet 80-të, siç thotë Juratovic e kuptuan se nuk mund të kthehen më, edhe për shka k të fëmijëve, që shkonin në shkollë, flisnin rrjedhshëm gjermanisht, dhe që po largoheshin gjithnjë e më shumë nga shoqëria, nga e cila kishin ardhur prindërit e tyre. "Ky ishte mësimi i parë se nuk ka më kthim pas. E dyta për ish-jugosllavët ishin lufta që shpërtheu në territorin e Jugosllavisë, ku shumë e kuptuan, tani as që bëhet fjalë për kthim".

JUGOSLLAVËT QË "NUK BININ NË SY"

Jugosllavët ndodheshin para një sfide - integrimi. Shoqëria gjermane ishte e mendimit, se ky grup mjaft punëtor migrantësh ishte i integruar, kishte integruar veten. Sepse kulturalisht ky grup nuk dallonte shumë nga gjermanët, thotë historiani Ivanovic, "sepse edhe jugosllavët e hanin mishin me patate, nga ana tjetër është një komunitet që flet gjermanisht, nga pamje nuk duket ndryshe dhe nuk binte në sy në këtë kontekst". "Një integrim në dukje", thotë Bosiljka Schedlich.

DUKE PUSHUAR NË AUTOSTRADË GJATË RRUGËS PËR NË SHTËPI

Por e vërteta është se shumë jugosllavë qëndronin me njëri-tjetrin më shumë, organizoheshin në klube apo në kisha si "Misioni Kroat Katolik".

Për më të moshuarit ishte e vështirë që ta mësonin mirë gjermanishten. Por fëmijët e tyre dhe gjenerata e tretë konsiderohen si të integruar shumë mirë. "Shumica e jugosllavëve i dhanë rëndësi të veçantë që nga fillimi shkollimit të fëmijëve, ashtu si ata ishin punëtorët më të mirë, edhe fëmijët duhet të ishin nxënësit më të mirë, ose nxënës shumë të mirë. Gjenerata e re ka kështu një shkollim më të mirë, shumë kanë studiuar. Ata janë ata që jetojnë me vetëdije në Gjermani".

Por shtrohet edhe çështja e atdheut. Çfarë është atdheu për gjeneratën e parë, të dytë apo të tretë? Bosiljka Schedlich ka një përgjigje të thjeshtë. Vendlindja e saj, atdheu i saj i parë dhe atdheu gjerman janë një. Bota sot është e ndërlidhur. "Unë jam gerade në Shipan tani në shtëpinë time, por kështu ndjehem edhe në Berlin Frohnau. Nuk mund t'i ndaj këto".

(DW)

KOMUNA E SARAJIT
SHPALLJE nr. 3/2018
për tjetërsim të tokës ndërtimore pronësi e Republikës së Maqedonisë të ankandit publik elektronik në Komunën e Sarajit

LËNDA E ANKANDIT PUBLIK ELEKTRONIK

Lënda e ankandit publik elektronik është toka ndërtimore e pa ndërtuar, pronësi e Republikës së Maqedonisë, e paraparë me **DOKUMENTACION TË PLANIT LOKAL URBANISTIK PËR NDËRTIMIN E KOMPLEKSIT PRODHUES NË PIJESËN E PK 10711/2 PIJES NGA PK 10712 PIJES NGA PK 13618 DHE 10711/7, V.Q. LLAKI, K.K. SARAJ – SHKUP,** e miratuar me vendim nga Kryetari i komunës së Sarajit nr.08-357/16 nga 12.01.2016, me dedikim të ndërtimit G2 – industri e lehtë dhe e pa ndotshme, me klasë kompatible të dedikuar B1 deri 30%, B2 deri 30%, b4 deri 30%, V2 deri 5%, D3 deri 30%, G3 deri 30% dhe G4 deri 30%- në pajtim me kontrollin tabelar në të cilin janë të dhënat: numri i parcelës ndërtimore, didikimi i parcelës ndërtimore, numri i parcelave kadastrale të përmbyllura me parcelë kadastrale, sipërfaqja e përgjithshme e parcelës kadastrale, sipërfaqja e ndërtimit, sipërfaqja e zhvilluar bruto, lartësia maksimale deri në kurorën dhe katet, çmimi fillestar në m2, çmimi fillestar i përgjithshëm dhe depozitimi për pjesëmarrje të ankandit publik.

Rishikimi Tabelarë:

Numri i parcelës ndërtimore.	Dedikimi i ndërtimit në parcelën ndërtimore	Nr i parcelës kadastrrale KK Saraj	Sipërf. E parc.ndërtimore (m^2)	Sipërfaqja e ndërtimit (m^2)	Përq. E ndërtimit. (%)	Koefic.i shfritzimit.	Sipërf.bruto e zhvilluar ($м^2$)	Lartësia maksimale për ndërtimin nga niveli i trotoari mbrojtës deri në kurorë	çmimi fillestarë në m2 në denarë	Çmimi fillestar i përgjithshëm	Garancia bankare për seriozitetin e ofertës
P.N nr.1	Г2	Pjesë nga PK 10712/4 PK 13618/3 PK 10711/7 PK 10711/16	30593	15000	48,83	0,59	18000	T.P = P+1	61.00	1.866.173,00	1.866.173,00

TË DREJTË PËR PIJESËMARRJE

Të drejtë për pjesëmarrje kanë:

1. Personat fizik: shtetas të Republikës së Maqedonisë, shtetas të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian dhe në OECD, si dhe shtetas të shteteve të cilat nuk janë anëtare të bashkimit Evropian dhe në OECD a në kushte të reciprocitetit mund të arin të drejtë të pronësisë në tokë ndërtimore në territorin e Republikës së Maqedonisë.

2. Personat juridik:personi juridik vendor, personi juridik në pronësi të përzier, personi juridik i themeluar nga personi fizik dhe juridik i jashtëm, të regjistruar në regjistrin Qendrorë në Republikën e Maqedonisë, Personat juridik të huaj rezident të shteteve anëtare të bashkimit evropian dhe në OECD, Si dhe persona juridik të huaj rezident të shteteve të cilat nuk janë anëtare të shteteve të bashkimit evropian dhe në OECD të cilat në kushte të reciprocitetit mund të arin të drejtë të pronësisë në tokë ndërtimore në territorin e Republikës së Maqedonisë.

KUSHTET PËR PJESËMARJE NË ANKANDIN PUBLIK ELEKTRONIK

Personat e interesuar fizik dhe juridik parashtrojnë paraqitjen për pjesëmarrje të ankandit publik (në formë elektronike, në www.gradezno-zemjiste.mk në të cilën është e potencuar se në cilën parcelë ndërtimore drejtohet paraqitja dhe cilat dokumentacione janë pjesë përbërëse të paraqitjes,) dëshmit vijuese të kompletuara:

1. Paraqitja nga dorëzuesi, nga të cilat janë të potencuara të dhënat për dorëzuesin e paraqitjes;

2. **Garanci Bankare për seriozitet të ofertës (garancia bankare për pjesëmarrje në ankandin publik elektronik për parcelat ndërtimore dorëzohet edhe në formë të shkruar në origjinal deri te Komuna e Sarajit – rr.„Qendra rekreative'' nr. 5, Shkup, më së voni deri në kalimin e afatit për dorëzim të paraqitjes për pjesëmarrje në ankand publik. Dorëzuesve të paraqitjes për pjesëmarrje në ankand publik të cilët nuk do të dorëzojnë garanci bankare në formë të shkruar në origjinal nuk do ti lejohet pjesëmarrje në ankand publik.).**

3. persona fizik vërtetim për nënshtetësinë;

4. Për persona juridik dëshmi për regjistrim të personit juridik nga regjistri kompetent;

5. E –mail adresë të dorëzuesit të paraqitjes, përmes së cilës do të kryhet procedura e regjistrimit për pjesëmarrje në ankand publik elektronik, respektivisht do t'ju dorëzohen emri i shfrytëzimit dhe shifra për qasje në faqen e internetit në të cilën do të zhvillohet ankandi publik elektronik.

(Për dorëzues të paraqitjeve të cilët do të dorëzojnë e-mail adresë të gabuar, Komuna e Sarajit nuk ka obligim të pranojë dhe kryejë korrigjim të së njëjtës).

6. Ofertuesi më i volitshëm i zgjedhur obligohet që ti mbuloj edhe harxhimet e veçanta të procedurës edhe atë:

- Harxhime për sigurim të dëshmive për tokën ndërtimore lëndë e ankandit publik;
- Harxhime për shpallje në mediume dhe gazetat publike;
- Harxhime për këqyrje në vend ngjarje dhe konstatimin e gjendjes faktike dhe për fillimin e pronësisë të tokës ndërtimore.

Lartësia harxhimet e lartpërmendura është 10% nga vlera e garancisë bankare për seriozitetin e ofertës dhe e njejta paguhet me virman ose përmes postës në Komunën e Sarajit, llogaria depozitare **781014116569614,** shifra e të ardhurave **733111** programi **00** me mbishkrim '' harxhime të veçanta të procedurës për ankand publik për tjetërsim të tokës ndërtimore '', për parcelën ndërtimore nr. PN1.

Paraqitjet të cilat nuk janë të kompletuara me këto dëshmi nuk do të marin pijesë në ankandin publik elektronik për çka parashtruesit e paraqitjeve jo të kompletuara do të njoftohen në formë elektronike.

KUSHTET E VEÇANTA PLOTËSUESE

1. Shuma minimale nga të ardhurat e përgjithshme në vitin financiar të personit fizik të cilët do të paraqiten për pjesëmarrje në ankandin publik, respektivisht të themeluesit të personit juridik, përderisa personi juridik i cili do të paraqitet për pjesëmarrje në ankandin publik është person juridik i regjistruar në Republikën e Maqedonisë, themeluar nga ana e personit juridik të huaj, të jetë mbi 400.000.000,00 denarë. Për dëshminë e këtij kushti dorëzohet bilanc i gjendjes dhe bilanc i suksesit dhënë nga organi kompetent ose bilanci revidues në sukses i vërtetuar nga shtëpia e revizionit të autorizuar.

2. Minimum 50 persona të punësuar në personin jurdik i cili do të marrë pjesë në ankandin publik, respektivisht të themeluesit të personit juridik, përderisa personi juridik i cili do të paraqitet për pjesëmarrje në ankandin publik është person juridik i regjistruar në Republikën e Maqedonisë, themeluar nga person juridik i jashtëm. Për dëshminë e këtij kushti dorëzohet dëshmi për numrin e të punësuarve i dhënë nga organi kompetent.

3. Numri i personave të cilët do të punësohen pas mbarimit të objektit afaristë është minimum 20.

ÇMIMI FILLESTAR

Çmimi fillestar në ankandin publik elektronik për parcelat ndërtimore është e theksuar në kontrollin tabelorë dhe përbëhet pre 61 denarë në metër katrorë.

AFATET PËR PARASHTRIMIN E FLETPARAQITJEVE

Fletëparaqitjet për pjesëmarrje në ankandin publik mund të dorëzohen deri më 11.11.2018, në formë elektronike në adresë vijuese: www.gradezno-zemjiste.mk

Ankandi publik do të mbahet në formë elektronike në faqen vijuese të internetin www.gradezno-zemjiste.mk

Ankandi publik për PN1 do të fillon në 14.11.2018, në ora 09.30
Dhe i njëjti do të zgjatë 15 minuta.

Ankandi publik për çdo parcelë ndërtimore nga rishikimi i njëanshëm tabelorë , vazhdohen për 2 minuta deri atëherë kur në 2 minutat e fundit nga ankandi ka ofertë të re.

Një ofertues mund të jetë pjesëmarrës me ofertë në një ose më shumë parcela, ose në të gjitha parcelat nga shpallja.

PROCEDURA

1. Komisioni i njofton parashtruesit e fletëparaqitjeve për kompletimin e të njëjtave në formë elektronike, në afat prej 24 orë pas mbarimit të afatit për parashtrimin e të njëjtave, nga çka parashtruesve të fletëparaqitjeve që kanë dorëzuar dokumentacion të kompletuar ju dorëzohet edhe emër shfrytëzimi dhe shifër për pjesëmarrje në ankand publik elektronik, parashtruesve të fletëparaqitjeve që nuk kanë dorëzuar dokumentacion të kompletuar ju dorëzohet njoftim me arsyetim se të njëjtit nuk do të marrin pjesë në ankandin publik;

2 .Në ditën e mbajtur të ankandit publik elektronik pjesëmarrësit kanë qasje në faqen elektronike me emrin shfrytëzues dhe shifrën të cilën e marrin në e-mail adresën, e dorëzuar në shtojcë të paraqitjes për pjesëmarrje në ankandin publik;

3. Ankandi publik elektronik mund të fillon me më pak një pjesëmarrës në ankandin publik, për çdo parcelë ndërtimore në veçanti;

4. Ankandi publik elektronik e ndjek Komisioni, i formuar nga Kryetari i komunës së Sarajit;

5. Ankandi publik elektronik fillon me shpallje të çmimit fillestar të tokës me metër katrorë, a miratohet në mënirë të ankandit nga ana e pjesëmarrësve;

6. Ankandi kryhet '' hap pas hapi'' me rritje të vlerës për çdo 'hap'' dhe atë:

-për parcelat ndërtimore me dedikim G2- Industri e lehtë jo më pak se 10,0 denarë/m2;

7. Ankandi publik elektronik llogaritet si i kryer në momentin e kalimit të kohës i përcaktuar me këtë shpallje, me çka derisa në kalimin e 2 minutave të fundit nga ana e paraqitësve është dhënë ofertë, afati i fundit për kryerje të ankandit publik vazhdohet edhe për di minuta a do të mbaroj kur në periudhë nga di minutat e ardhshme nuk ka ofertë të re të ofruar. Ankandi publik vazhdon pakufi deri atëherë kur në intervalin kohorë pre di minutave ka ofertë të re.

8. Për ofertues më të volitshëm për metër katror llogaritet pjesëmarrësi I cili në ankandin publik ka dhënë ofertë me çmimin e fundit, I cili paraqet çmimin më të lartë për tjetërsim të tokës ndërtimore;

9. Komisioni pas mbarimit të ankandit publik përgatitë procesverbal për ankandin publik që është zhvilluar

dhe në mënyrë elektronike e dërgon tek të gjithë pjesëmarrësit në ankandin publik;

10. Pas mbarimit të procedurës së ankandit publik Komisioni është I obliguar në afat prej tre ditë pune të dorëzojë kërkesë për mendim deri tek Prokuroria e përgjithshme shtetërore e Republikës së Maqedonisë në lidhje me draft-tekstin për marrëveshjen për tjetërsim të tokës ndërtimore në pronësi të Republikës së Maqedonisë.

11. Prokuroria e përgjithshme shtetërore e Republikës së Maqedonisë është e obliguar të jep mendim në lidhje me draft-tekstin për marrëveshjen për tjetërsim të tokës ndërtimore në pronësi të Republikës së Maqedonisë në afat prej 30(tridhjetë) ditësh nga dita e arritjes së kërkesës për mendim. Në rast se në afat prej 30(tridhjetë) ditësh Prokuroria e përgjithshme shtetërore e Republikës së Maqedonisë nuk na dorëzon mendim, do të llogaritet për pozitive;

12. Pas marrjes së mendimit pozitiv nga Prokuroria e përgjithshme shtetërore e Republikës së Maqedonisë, Komisioni në afat prej tre ditësh deri tek ofertuesi më o volitshëm dërgon informim me shkrim për zgjedhje të ofertuesit më të volitshëm;

13. Ofruesi më i volitshëm në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga marrja e informimit për zgjedhje të ofertuesit më të volitshëm është i obliguar që të bëjë pagesën e mjeteve dhe deri tek Komisioni të dorëzojë dëshmi për pagesën e realizuar me tërë dokumentacionin e nevojshëm për pjesëmarrje në ankandin publik;

14. Ofertuesi më i volitshëm në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga pranimi i informimit për zgjedhje të oferuesit më të volitshëm është i obliguar të bëjë pagesën e mjeteve për shpenzime të veçanta në procedure e tjetërsimit të tokës ndërtimore nëpërmjet ankandit publik, në lartësi prej 10% nga vlera e provizionit banker për seriozitet të ofertës;

15. Në rast se ofertuesi më i volitshëm nuk e bën pagesën e mjeteve në afatin e caktuar, do të llogaritet se toka ndërtimore nuk është tjetërsuar, nuk do të kalohet në përfundim të marrëveshjes dhe garanci bankare për seriozitet të ofertës do të aktivizohet dhe i njëjti nuk do të mund të marrë pjesë në çdo ankand publik tjetër në të ardhmen për parcelën ndërtimore në fjalë;

16. Në qoftë se ofertuesi më i volitshëm e bën pagesën e mjeteve në përputhshmëri me çmimin e fundit të ankandit në afatin e caktuar dhe në bazë të dokumentacionit të dorëzuar nuk mund të arrihet marrëveshje, mjetet e paguara për tjetërsim të tokës ndërtimore ofertuesit më të volitshëm nuk i kthehen, garancia bankare për seriozitet të ofertës aktivizohet dhe nuk do të ketë qasje në arritjen e marrëveshjes;

17. Në afat prej 5 (pesë) ditë pune pas dorëzimit të dëshmisë për pagesën e bërë dhe dorëzimit të dokumentacionit të përgjithshëm i nevojshëm për pjesëmarrje në ankand, Kryetari I komunës së Sarajit në emër të Republikës së Maqedonisë arrijnë marrëveshje për tjetërsim të tokës ndërtimore në pronësi të Republikës së Maqedonisë;

18. Pas arritjes së marrëveshjes, komuna e Sarajit në afat prej një dite, në mënyrë elektronike e dorëzon kontratën deri tek Njësia për tatime lokale dhe taksa për caktim të tatimit të fitimit në patundshmëri. Blerësi është i obliguar që në afat prej 15(pesëmbëdhjetë) ditësh nga marrja e vendimit për caktim të tatimit të fitimit në patundshmëri që ta paguaj tatimin dhe të dorëzojë dëshmi për pagesën e realizuar;

19. Pas dorëzimit të dëshmisë për pagesën e realizuar të tatimit të fitimit në patundshmëri , blerësi në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh marrëveshjen në mënyrë elektronike e dorëzon tek noteri i autorizuar për ta bërë solemnizimin. Blerësi është i obliguar solemnizimin ta bëjë në afat prej 30(tridhjetë) ditësh nga dorzimi I kontratës tek noteri i autorizuar;

20. Mos plotësimi i obligimeve nga pika 17, 18 dhe 19 nga kjo shpallje me faj të blerësit paraqet bazë për prishje të kontratës së njëanshme prej çka 80% nga shuma e përgjithshme e tjetërsimit nuk i kthehet blerësit;

21. Me marrëveshjen ofruesi më i volitshëm(blerësi) obligohet të sigurojë leje për ndërtim të objektit të paraparë në afat prej 12(dymbëdhjetë) muajve nga realizimi i solemnizimit të po të njëjtit ku si mjet i kontratës është parcela ndërtimore me hapësirë mbi 5000 m2 dhe është i obliguar që ta ndërtojë objektin në pajtim me planin urbanistik nëpërmjet të cilit toka është tjetërsuar, në afat jo më gjatë se 2(dy) vjet nga marrja e lejes së plotfuqishme për ndërtim të objektit me bruto hapësirë të ndërtuar deri 1000m2 në pajtim me lejen e marrur për ndërtim, respektivisht në afat jo më gjatë se 4(katër) vjet nga marrja e e lejes së plotfuqishme për ndërtim të objekteve me hapësirë bruto për ndërtim mbi 1000 m2 në pajtim me lejen e fituar për ndërtim. Në të kundërtën, në rast se blerësi nuk nxjerrë leje për ndërtim në afatin e paraparë, respektivisht në rast se objekti nuk është ndërtuar në afatin e paraparë me faj të blerësit , i njëjti do të ketë obligim të paguaj dënimin e caktuar prej 1.5% të çmimit të arritur në ankandin publike tokës në fjalë për secilin muaj të kaluar në vitin e pare nga kalimi i afatit , respektivisht 3% nga çmimi i arritur në ankandin publik të tokës në fjalë për secilin muaj të kaluar në vitin e dytë nga afati i kaluar, respektivisht 4,5% nga shuma e përgjithshme e çmimit e arritur në ankandin publik e tokës në fjalë për secilin muaj të kaluar në vitin e tretë dhe secilit vit me radhë nga skadimi i afatit. Mosplotësimi i këtyre obligimeve, respektivisht pas ramjes së blerësit në vonesë të plotësimit të këtyre obligimeve tre muaj me radhë, paraqet bazë që tjetërsuesi pas tre muajve thirrje të njëpasnjëshme për realizim, si kreditor me deklaratë për mosplotsim të obligimeve nga kontrata të kërkojë vërtetim për realizim të kontratës , respektivisht të kërkojë pagesën e dënimit kontraktues i cili paraqet edhe bazë për prishje të njëanshme të kontratës, prej çka 80% nga shuma e përgjithshme e tjetërsimit nuk i kthehen blerësit;

22. Përqindja minimale e cila duhet të ndërtohet nga gjithsej hapësira e zhvilluar për ndërtim e paraparë me planin urbanistik për lëndën e parcelës ndërtimore, nuk duhet të jetë më e vogël se 30%;

23. Ofertuesi më i volitshëm është I obliguar që ta paguaj tatimin e fitimit I cili do të del si obligim pas marrëveshjes së arritur për tjetërsim të tokës ndërtimore;

24. Në çmimin e tokës ndërtimore nuk është përfshirë kompensimi për rregullim të tokës ndërtimore;

25. Shpenzimet për procedurën noteriale dhe paraqitjen në evidencën e patundshmërive në Agjencinë për kadastër të patundshmërive bien në ngarkesë të blerësit të tokës ndërtimore.

26. Pronari i tokës ndërtimore të fituar në procedure për tjetërsim nëpërmjet ankandit publik nuk i lejohet të njëjtën që ta transferojë në persona të tretë, para plotësimit të obligimeve të kontraktuara për tjetërsim të së njëjtës. Ndalesa për transferim tek persona të tretë regjistrohet në librin publik për regjistrim e të drejtave të patundshmërisë;

27. Pjesëmarrësit e pakënaqur në ankandin publik mund të deklarojnë kundërshtim deri tek Komisioni në afat prej 3(tre) ditësh nga dita e mbajtjes së ankandit publik në mënyrë elektronike. Kundërshtimi dorëzohet në formë të shkruar deri tek Komisioni i cili vendosë për kundërshtimin me vendim. Komisioni është I obliguar të vendosë për kundërshtimin në afat prej pesë ditë pune nga pranimi i të njëjtit.

28. Kundër vendimit të sjellë nga ana e komisionit, me të cilin vendoset për kundërshtimin e paraqitur, pala ka të drejtë të paraqesë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit deri tek Komisioni shtetëror që vendosë për procedurë administrative dhe procedurë për marrëdhënie pune në shkallë të dytë.

Kjo shpallje do të jetë e publikuar edhe në WEB faqen e Komunës së Sarajit ww.sara.gov.mk

Komisioni për realizim të procedurës për ankand publik të tokës
Ndërtimore në pronësi të Republikës së Maqedonisë

Komuna e Sarajit

TËRHEQJA E NJOHJEVE, PROPAGANDË E SERBISË

Anëtarja e Komisionit për Punë të Jashtme nga ana e Lëvizjes Vetëvendosje, Fitore Pacolli, për "Zërin" ka thënë që deklaratat për tërheqjen e njohjeve janë vetëm propagandë e shtetit serb karshi Kosovës.

Diplomacia serbe është duke e vazhduar ofanzivën për të siguruar sa më shumë "çnjohje" të shtetit të Kosovës. Madje ministri i Punëve të Jashtme, Ivica Daçiq, ka thënë se shpresojnë se deri në fund të vitit numri i njohjeve të Kosovës të bjerë nën 100. Në anën tjetër, Kosovën nuk e ka njohur asnjë shtet i ri që nga shkurti i këtij viti, shkruan "Zëri".

Anëtarja e Komisionit për Punë të Jashtme nga ana e Lëvizjes Vetëvendosje, Fitore Pacolli, për "Zërin" ka thënë që deklaratat për tërheqjen e njohjeve janë vetëm propagandë e shtetit serb karshi Kosovës.

"Sa i përket tërheqjes së njohjeve, në marrëdhëniet ndërkombëtare nuk njihet koncepti i 'tërheqjes së njohjeve' dhe nuk mund të ketë tërheqje. Kjo është një propagandë dhe lojë e Serbisë që po bën me Kosovën", ka thënë ajo.

Ndërsa e pyetur nëse diplomacia kosovare po bën mjaftueshëm për të marrë njohje të reja, Pacolli ka thënë se me sjelljen e udhëheqësve të institucioneve të Kosovës nuk mund të ketë njohje të reja.

"Jo, Kosova nuk është duke bërë mjaftueshëm. Sot ne kemi një president i cili ka hedhur në tavolinë të diskutimit me Serbinë sovranitetin dhe kufijtë e shtetit të Kosovës, ministri i Punëve të Jashtme po jep deklarata tejet të dëmshme për shtetin e Kosovës, duke theksuar se nuk ka nevojë të kemi kufij në mes të Kosovës dhe Serbisë. Ndërsa kryeministri po kujdeset që të ruajë postin e kryeministrit. Me këtë sjellje të udhëheqësve të politikës së jashtme nuk mund të ketë njohje të reja dhe as nuk do të ketë", ka thënë ajo.

Kërkohet suspendimi i profesorëve plagjiatorë

ORCA dhe ADMOVERE kanë ringritur edhe njëherë çështjen e avancimit të profesorëve të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike.

Në një konferencë për media, përfaqësues të organizatave përkatëse kërkuan nga rektori i UP-së Marjan Dema, krijimin e një komisioni të veçantë me pjesëmarrës ndërkombëtare për të hetuar rastet në fjalë.

Rron Gjinovci nga ORCA tha se pavarësisht se u kanë dërguar senatorëve vlerësimin për punimet e këtyre kandidatëve nga FIM dhe bërjes publike të të gjeturave të analizës së ORCA-a, të njëjtit janë avancuar nga profesorë të asocuar në profesorë të rregullt.

"Në mbledhjen e 23 korrikut të këtij viti, Senati vendosi pozitivisht për avancimin e Ahmet Shalës, Ramë Likajt, Azem Kyçykut, Mirlind Bruçit, Naser Lajçit, Nexhat Qehajës, Rexhep Selimajt dhe Xhevat Berishës, edhe pse të njëjtit kanë publikuar 5-19 artikuj në revista të pretenduara shkencore gjatë periudhës 2017-2018", tha ai.

Edhe Shkëlzen Gashi nga ADMOVERE tha se nga gjithsej 16 pjesëtarë të stafit akademik të UP-së të cilëve u janë shpalosur plagjiaturat në media, shumica nuk kanë reaguar asnjëherë ndaj akuzave.

"Prej këtyre rasteve, vetëm 3 janë suspenduar nga procesi mësimor, mirëpo më pas janë rikthyer. Vetëm njërit i është ndërprerë kontrata e punës", tha Gashi.

BLLOKOHET ANËTARËSIMI I SHQIPËRISË

Brukseli dhe Franca janë kundër

Prestigjiozja britanike, "Express", i është rikthyer çështjes së integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian. Pavarësisht se është vendosur Qershori i vitit të ardhshëm si datë për hapjen e negociatave, e përditshmja shkruan se, vendet anëtare duket se janë të bindura t`a bllokojnë anëtarësimin e Shqipërisë.

Madje shkrimi i "Express" mban titullin: "Pengohet kandidimi për anëtarësim në BE i Shqipërisë, Brukseli dënon korrupsionin dhe kanabisin".Sipas britanikes, në krye të vendeve që kërkojnë të bllokojnë hapjen e negociatave me Shqipërinë, qëndron pikërisht Franca, vend i cili dhe në të shkuarën ka shprehur haptazi rezerva në lidhje me anëtarësimin e vendit tonë në familjen e përbashkët europiane.

Franca ishte gjithashtu një prej vendeve që i mëshoi më fort idesë së shtyrjes me një vit të datës së çeljes së negociatave, që do të duhej të ndodhte që në Qershor të këtij viti.

Bosnjë, Kroatët kundër përfaqësuesit të tyre

Rreth 10.000 kroatë morën pjesë në një protestë në Mostar kundër zgjedhjes së Zheljko Komshiqit si anëtar të Presidencës së Bosnjës. Pjesëmarrësit paralajmëruan se bashkëjetesa në Bosnje nuk mund të ndërtohet duke mohuar vullnetin politik kroat dhe duke bërë thirrje për ndryshime në Ligjin zgjedhor, raporton Hina.

Një ditë më parë, Zheljko Komshiq ka thënë se Kosova është një shtet i pavarur.

"Unë me të vërtet dua që marrëdhëniet midis Serbisë dhe Kosovës të zgjidhen në atë mënyrë si dy vende fqinje dhe miqësore. Nuk kam dilema se Kosova është shtet i pavarur. Që ta dini, ky është mendimi im, tha ai.

Kjo deklaratë e tij ka nxitur reagime të shumta në Serbi

Bosnja nuk do ta njeh Kosovën

I sapozgjedhuri në presidencën tripalëshe të Bosnje Hercegovinës, Sefik Xhaferoviç nga Partia për Aksion Demokratik, ka thënë në një intervistë për Radion Evropa e Lirë, se pa pasur një konsensus të të gjithë anëtarëve të presidencës, Bosnja nuk mund të ndryshojë qëndrim sa i përket njohjes së Kosovës.

"Bosnje dhe Hercegovina e ka qëndrimin zyrtar kur është në pyetje kjo çështje, i cili thotë se për çfarëdo vendimi është i nevojshëm konsensusi i të gjithë anëtarëve të Presidencës, dhe këtë konsensus në këtë moment nuk e kemi dhe kështu do të jetë derisa nuk ndryshojnë gjërat" ka thënë Xhaferoviç.

Megjithatë, Xhaferoviç, kandidati që mori më së shumti vota në zgjedhjet e fundit në Bosnje, ka thënë se Kosova dhe Bosnja duhet të kenë nivelin e bashkëpunimit të paktën siç e ka sot Serbia me Kosovën.

" Unë mendoj se Bosnje dhe Hercegovina dhe Kosova duhet të ketë nivelin e bashkëpunimit, të paktën siç e ka sot Republika e Serbisë me Kosovën. Sepse ne me Kosovën jemi në nivel më të ulët bashkëpunimi se që është Serbia. Më shumë ka liri të lëvizjes së mallrave, kapitalit dhe njerëzve mes Kosovës dhe Serbisë sesa mes Kosovës dhe Bosnjës, dhe kjo për shkak se nuk ekziston gatishmëria nga ana e politikanëve të Republikës Serbe që kjo situatë të përmirësohet. Unë mendoj se këto raporte duhet të ndërtohen mes Bosnjës dhe Kosovës në interes të të dyja vendeve, edhe përkundër qëndrimit politik kur është fjala për njohjen e Kosovës" ka thënë Xhaferoviç për Shërbimin e Ballkanit të Radios Evropa e Lirë.

Në zgjedhjet e 7 tetorit në Bosnje, përveç kandidatit boshnjak Sefik Xhaferoviç, një vend në presidencën tripalëshe e ka fituar edhe nacionalisti nga Republika Serbe Millorad Dodik, i cili njihet për raporte të afërta me Rusinë. Anëtari i tretë është zgjedhur social-demokrati Zheljko Komshiç, që ka shërbyer dy mandate në presidencë.

KHASHOGGI U VRA BRENDA KONSULLATËS

"Washington Post" ka publikuar një artikull me titull "Turqit kanë njoftuar zyrtarët amerikanë se posedojnë audio/video xhirime të cilat dëshmojnë se Khashoggi është vrarë". Gazeta amerikane, ku Khashoggi punonte si gazetar dhe kolumnist, në këtë artikull citon disa zyrtarë turq dhe amerikanë që kanë kërkuar të mbeten anonim

Një delegacion i Arabisë Saudite mësohet se ka arritur në Turqi në kuadër të hetimeve në lidhje me zhdukjen e gazetarit saudit Jamal Khashoggi. Pritet që gjatë fundjavës të ketë takime në mes të zyrtarëve turq dhe të delegacionit saudit i cili ka arritur në Ankara. Gazetari dhe kolumnisti i gazetës "The Washington Post" Khashoggi u zhduk më 2 tetor, pasi kishte hyrë në kompleksin e konsullatës së Arabisë Saudite në Stamboll. Ai ishte i njohur si kritikues i politikave që udhëheqë Qeveria aktuale saudite. Burimet policore konfirmuan informacionin se Khashoggi nuk kishte dalë nga konsullata pas hyrjes më 2 tetor. Burimet njoftuan se në orën e njëjtë, 15 shtetas sauditë, përfshirë edhe zyrtarë të ardhur në Stamboll me dy avionë, kanë qenë në konsullatë ndërsa më pas janë kthyer në shtetet nga të cilat kishin ardhur.

Ndërkohë, gazeta amerikane "Washington Post" së fundmi ka publikuar se zyrtarët turq kanë informuar Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA) se "posedojnë audio/video xhirime të cilat dëshmojnë se gazetari saudit Jamal Khashoggi është vrarë". "Washington Post" ka publikuar një artikull me titull "Turqit kanë njoftuar zyrtarët amerikanë se posedojnë audio/video xhirime të cilat dëshmojnë se Khashoggi është vrarë". Gazeta amerikane, ku Khashoggi punonte si gazetar dhe kolumnist, në këtë artikull citon disa zyrtarë turq dhe amerikanë që kanë kërkuar të mbeten anonim.

Teksti potencon deklaratat e zyrtarëve në fjalë, ku thuhet se "Në xhirime mund të shihet se si më 2 tetor, një skuadër saudite e sigurisë futet në konsullatën në Stamboll, ku fillimisht kapin Khashoggi-n i cili kishte shkuar për disa dokumente. Më pas e kanë vrarë dhe e kanë copëtuar". Sipas po këtyre zyrtarëve, po ashtu dhe audio xhirimet, në mënyrë bindëse konfirmojnë pretendimet se skuadra saudite është përgjegjëse për vrasjen e Khashoggi-t. "Mund të dëgjoni zërin e tij (Khashoggi) dhe zërat e njerëzve të tjerë që flasin arabisht. Mund të dëgjoni se si është marrë në pyetje, pastaj i është nënshtruar torturës dhe më pas edhe është vrarë", theksohet në deklaratat e publikuara në artikull.

Nuk potencohet nëse zyrtarët amerikanë kanë parë apo dëgjuar xhirimet në fjalë, por nënvizohet se zyrtarët turq kanë informuar SHBA-të për përmbajtjen e xhirimeve". Zëdhënësi i Zyrës së Presidencës së Turqisë, Ibrahim Kalin, dje deklaroi se Turqia dhe Arabia Saudite kanë vendosur për ngritjen e një grupi të përbashkët pune me qëllim të ndriçimit të rastit Khashoggi.

LINJA QË NUK PËRPUTHEN

Turqia dhe Arabia Saudite janë rivalë në garën për të drejtuar botën islamike. Zhdukja dhe ndoshta vrasja e disidentit saudit Jamal Khashoggi në konsullatën e vendit të tij në Stamboll nuk janë lajm i mirë për Lindjen e Afërme të pasur me konflikte. Sepse ato ushqejnë tensionet që ekzistojnë për një kohë të gjatë midis Turqisë dhe Arabisë Saudite dhe shtojnë me këtë barrën e konflikteve. Të dy janë rivalë në konkurrencë për udhëheqjen e botës islamike. Kjo në një kohë që ata janë në krye të kampeve të kundërta: në njërën anë Arabia Saudite, që e ka deklaruar Vëllazërinë Myslimane organizatë terroriste, që imponoi një embargo kundër Katarit dhe që bashkëpunon me Izraelin. Në anën tjetër, Turqia e Erdoganit e mbështet Vëllazërinë Myslimane, bashkëpunon ngushtë me Katarin dhe u jep një zë palestinezëve, për shembull me kritika për njohjen e Jerusalemit si kryeqytet të Izraelit. Khashoggi, njëri nga intelektualët drejtues sauditë u pozicionua gjithnjë e më shumë kundër politikës së vendit të tij dhe përfaqësonte pozicionet e Turqisë. Në këtë mënyrë, rasti i tij nxjerr në pah linja të rrezikshme konflikti në Lindjen e Afërt.

I akuzuari për vrasjen e gazetares bullgare e pranon fajin

Gjykata në Gjermani ka njoftuar se bullgari i akuzuar për vrasjen e gazetares bullgare Viktoria Marinova, ka pranuar se e kishte sulmuar gazetaren dhe se mund të ekstradohet te autoritet bullgare.

Në komunikatë gjithashtu thuhet, se 21-vjeçari i akuzuar për vrasje që ishte kapur më 10 tetor sipas një fletarresti ndërkombëtar, ka deklaruar se gjatë marrjes në pyetje "se nuk ka dashur ta vrasë viktimën dhe kategorikisht ka mohuar akuzat për përdhunim".

Në natën e 10 tetorit, 21-vjeçari me shtetësi bullgare, Severin Krasimirov është arrestuar në Gjermani nën dyshimin se kishte përdhunuar dhe vrarë 30-vjeçaren Viktoria Marinova, gazetaren e televizionit TVN. Vrasje është kryer në pjesën veriore të qytetit bullgar Ruse gjatë 6 tetorit, kurse besohet se Krasimirov menjëherë kishte ikur në Gjermani.

PËRDORUESIT MË TË SHPESHTË TË TRENIT NË EUROPË

Çdo banor udhëton 2.463 km në vit

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:
- niveli i kualifikimeve VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, shkencat organizative dhe menaxhim (menaxhment)
- me ose pa përvojë pune

Kompetencat e përgjithshme:
- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

Orari i punës :
- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:30 - 16:30

Rroga neto: 20.961,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Serb(e) 1.

7. UPR0101G04000 Referent i ri për punë administrative - teknike, Njësia për kujdestarët komunal, Sektori Inspektorati i Qytetit të Shkupit — 1 realizues(ë)

Kushtet e përgjithshme:
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:
- niveli i kualifikimeve VA ose niveli i kualifikimeve IV, sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 ose 240 kredi sipas ECVET ose SMKAP ose së paku arsim të lartë ose të mesëm, gjimnaz ose drejtimi ekonomik
- me ose pa përvojë pune

Kompetencat e përgjithshme:
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

Orari i punës :
- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:30 - 16:30

Rroga neto: 13.140,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Shqiptar(e) 1.

Kushtet e lartpërmendura në shpallje kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit në formë elektronike nëpërmjet profilit të përdoruesit të krijuar në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës.

Afati i aplikimit zgjatë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes. Pas mbarimit të afatit për aplikim, shpallja do të jetë e larguar nga faqja e internetit e Agjencisë.

Pas kalimit të afatit të aplikimit, shpallja do të jetë e hequr nga faqja e internetit e Agjencisë.

Kandidatëve u kërkohet fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, të jenë precizë dhe të japin të dhëna të sakta. Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike në faqen e internetit të Agjencisë së administratës do të informohen, për kohën dhe vendin e mbajtjes së çdo faze të ardhshme të procedurës për selektim të nëpunësit administrativ.

Faza e 1 – rë: selektimi administrativ realizohet në një afat prej 15 ditësh pas mbarimit të shpalljes së publikuar.

Faza e 2 – të: provimi i nëpunësit administrativ realizohet në një afat jo më të shkurtër se 10, dhe jo më të gjatë se 30 ditë pas mbarimit të fazës së 1 – rë. Ai incizohet dhe emetohet drejtpërdrejtë në faqen e internetit të Agjencisë së administratës.

Faza e 3 – të: kontrollimi i vërtetësisë së provave dhe intervista realizohet në një afat prej 10 ditësh pas mbarimit të fazës së 2 – të.

Në bazë të nenit 22 pika 1 dhe nenit 23 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 167/15 – tekst i pastruar) nenit 143 pika 3 e Ligjit për mbrojtje të fëmijëve ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 23/13, 12/14, 44/14, 144/14, 10/15, 25/15, 150/15, 192/15, 27/16, 163/17 dhe 11/18) dhe pëlqimit të Ministrisë së financave nr. 18-5253/2 të datës 29.05.2018 , Drejtori i IPKKF "Breshia " – Dibër publikon

SHPALLJE PUBLIKE Nr. 3
Për punësim për kohë të pacaktuar të punës

1. Një (1) person për vendin e punës – edukator i fëmijëve prej moshës 2-6 vjeçare – ofrues të shërbimeve publike V1 niveli për kohë të pacaktuar të punës;

Kushtet e përgjithshme, të cilat vlejnë për të gjithë kandidatët:
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
-Të jetë i aftë fizikisht dhe psiqikisht;
- Të njeh gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik;
- Të mos i jetë shqiptuar dënim ose sanksion kundërvajtjeje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
-Të mos i jetë shqiptuar dënim me vendim të plotfuqishëm gjyqësor me të cilën dënohet për vepër penale për dhunë familjare, marrje të personit të mitur ose abuzim farefisnor, për vepër penale të grupit të veprave kundër lirisë gjinore, pavarësisht sanksionit të shqiptuar dhe tek i cili në pajtim me ligjin është përcaktuar sjellje diskriminuese.
-të përmbushë edhe kushtet tjera të përcaktuara në aktin për organizim të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës
Krahas kushteve të përgjithshme që vlejnë për të gjithë kandidatët, për secilin vend pune duhet të përmbushen edhe kushtet e posaçme si në vijim

1. Për vendin e punës edukator i fëmijëve prej moshës 2-6 vjeçare
   - Fakultet pedagogjik – grupi pedagogji parashkollore PSP shkalla VII/1 përgatitje profesionale ose 240 kredi sipas SETK,pedagog i diplomuar me 240 kredi.
   - Licencë valide për edukator
   - Licence valide për pedagoge
   - Njohje të gjuhës shqipe dhe alfabetit të saj
   - Me dhe pa përvojë pune

   Marrëdhënia e punës është për kohë të pacaktuar të punës.
   Orari ditor i punës është me shkallëzim prej ora 07:00-15:00 dhe prej ora 10:00-18:00 prej të cilave 6 orë punë me fëmijë.
   Neto pagesa fillestare për vendin e punës: 20.524,00 denarë

Shpallja zgjatë 5 ditë pune nga dita e publikimit. Kandidatët duhet të parashtrojnë lutje së bashku me dokumentet për aplikim. Dokumentet e nevojshme për aplikim në shpallje duhet të jenë në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter. Dokumentet e arritura të paplotësuara nuk do të shqyrtohen nga ana e komisionit për punësim. Zgjedhja do të realizohet në afat prej 45 ditëve.

Kandidatët e interesuar aplikacionet mund t'i parashtrojnë në arkivin e IPKKF "Breshia" – Dibër në rr. 8 Shtatori " nr. 39, objekti amë i Breshias , ose përmes postës me shenjë "për shpalljen publike për punësim", rr. 8 Shtatori nr. 39, – Dibër .

IPKKF "Breshia" –Dibër

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune , Vendimit për përdorimin e punëtorit numër 04-1535/1 nga 08.10.2018 dhe nenit 34 të Statuti të NP Komunalec Kavadar , dhe në bazë të Rregullores për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës , Drejtori i ndërmarrjes publikon

SHPALLJE
Për pranimin e punëtorëve

NP Komunalec- Kavadar ka nevojë për pranimin e punëtorëve në afat të caktuar prej **6 (gjashtë) muaj dhe atë për vendin e punës** :

1. Udhëheqës I sektorit për monitorim fiziko-kimik të ujit në repartin e monitorimit fiziko-kimik të ujit në Sektorin e ujësjellësit me shifrën e vendit të punës me KDR – 03 05 A03 065 me pagën neto themelore 29.500,00 denarë , 1 (një) realizues

Kandidatët , krahas kushteve të përgjithshme të parashikuara me Ligjin për marrëdhënie pune , duhet ti plotësojnë edhe kushtet e veçanta të nevojshme për kryerjen e detyrave si vijon :
- Kualifikime profesionale prej së paku 240 kredi të fituara sipas EKTS , ose të përfunduar shkalla VII/1 : Bioteknologji dhe Kimi .
- Së paku dy vite përvojë pune në profesion , prej të cilave së paku një vit në vendin e punës në sektorin publik , apo së paku katër vite të vendit të punës në profesion , prej të cilave së paku dy vite në vendin udhëheqës të punës në sektorin privat .
- Orari I punës prej 07,00 deri 15,00
- Ditës e punës : prej të hënës deri të premten .
- Orët e punës gjithsej : 40 orë

Kandidatët përveç lutjes për punë, të dorëzojnë edhe dëshmi për arsimin e kryer si dhe dokumente me të cilat I plotësojnë kushtet e veçanta të lartpërmendura .
Shpallja zgjat 5 (pesë) ditë punë, e llogaritur nga dita e publikimit në shtypin ditor – në tre gazeta ditore prej të cilave një nga gazetat në gjuhën që e flasin së paku 20 për qind e qytetarëve ndryshe nga gjuha maqedonase.
Lutja me dokumentacionin e nevojshëm të dorëzohet në arkivën e NP Komunalec- Kavadar rruga "Industriska", pa numër

NP Komunalec- Kavadar
Drejtori
Ing I dipl I bujq, Gjorgji Pop Icov

Republika e Maqedonisë
Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor

МКД СЕРТИФИКАТ
MKC EN ISO 9001:2009

Ministria e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor e Republikës së Maqedonisë

SHPALL

Kërkesë për ndërrimin e A- lejes së integruar ekologjike për NPNTSH KOOP INZHENERRING Kumanovë

Në përputhje me nenin 95 pika 1, neni 99 dhe nenin 116 të Ligjit për mjedisin jetësor (Gazeta zyrtare e RM 53/05, 81/05, 24/07, 159/08, 83/09, 48/10, 51/11, 123/2012, 93/13, 187/13, 42/14, 44/15, 129/15, 192/15 dhe 39/16), deri te Ministria e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor është dorëzuar kërkesë për ndërrimin të A-lejes së integruar ekologjike nr.11-4799/2 e datës 03.09.2018
Dorëzues i kërkesës:
NPNTSH KOOP INZHENERING Kumanovë
Rr. Potok Serava nr.bb
1300 Kumanovë
Republika e Maqedonisë
Koordinatat e lokacionit sipas sistemit nacional koordinativ:
KK 052 Kumanovë
PK 16216, 16217/1, 16218/1, 16219, 16220, 16221, 16222, 16223, 16224
Personi për kontakt:
Agim Ljatifi
Kategoria e instilacionit:
Shtojca 1 pika
3. Industria e mineraleve:
3.5 Bazat stacionare të asfaltit
140 t/orë Kapacitet i projektuar
Lloji i aktivitetit:
Prodhimi i asfaltit me pajisjet shoqëruese në hapësirat e:
Komunës së Kumanovës 10-16:00
Në të njëjtën kohë kërkesa në formë elektronike do të jetë e vendosur edhe në Ueb faqen zyrtare të Ministrisë së mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor www.moepp.gov.mk
Të interesuarit informatat më të detajuara në lidhje me kërkesën do të mund të marrin në Ministrinë e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor në tel. 076 456 717 (e-mail:f.baliu@moepp.gov.mk)
Të interesuarit në afat prej 30 ditëve që nga data e shpalljes së kërkesës për ndërrim, kanë të drejtë të parashtrojnë vërejtje dhe komentet e tyre në formë të shkruar deri te Ministria e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor, bulevardi ,, Goce Dellçev,, nr.18 ndërtesa e RTM (kati 10), 1000 Shkup

---

Në bazë të nenit 156,157 al 1, neni 158 dhe neni 159 prej ligjit për kujdes shëndetësor (Gazeta zyrtare e RM nr. 43/12 ,145/12, 87/13, 39/14, 43/14, 10/15, 154/15, 192/15, 17/16, 37/16),neni 19, 22 dhe 23 prej ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta zyrtare e RM nr. 62/2205 me ndryshime dhe plotësime të Gaz.Zyrtare e RM nr. 167/2015 , nr. 27/2016), dhe njoftim për miratimin e mjeteve financiare për punësim prej Ministrisë të Financave të RM me numër 18-10110/2 dhe nr 18-10116/2 prej 12.10.2018 I.SH.P Spitali i Përgjithshëm Strugë shpall:

SHPALLJE PUBLIKE

Njoftimi publik shpallet për punësimin e punëtorëve shëndetësor në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar

I.SH.P Spitali i Përgjithshëm Strugë ka nevojë për punësimin e 2(dy)për persona në kohë të pacaktuar për punët e mëposhtme:

1. Laborant me AL - 2 zbatues

1. Kandidatët duhet të plotësojnë **kushtet e përgjithshme** të parapara nga ligji për kujdesin shëndetësor:
   -Të jetë nënshtetas i RM-së
   -Të jetë i moshës të rritur
   -Të ketë aftësi të përgjithshme mjekësore
   - Të mos ketë ndalesë të plotfuqishme kryerjen e profesionit,aktivitet ose detyrë.

Për kandidatët për vendin e punës Laborant me AL

Përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj kandidatët për vendin e punës duhet ti plotësojnë kushtet e veçanta:
- Të ketë përfunduar arsimin e lartë me më se paku 180 kredi fituar sipas SETK
- Ta ketë dhënë provimin shtetëror;
- Dëshmi për njohurin e njërës prej gjuhëve më tepër të përdorura në EU-anglisht,frëngjisht,gjermanisht;
- Certifikatë pune për programe kompjuterike;
- Me përvojë pune ose pa përvojë pune

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet e mëposhtme:
- **Aplikim me biografi te shkurtër**
- **Çertifikatën e nënshtetësisë në origjinal ose fotokopje të noterizuar**
- **Certifikatë mjekësore jo më të vjetër se 6 muaj origjinal ose fotokopje të noterizuar**
- **Certifikatë se nuk ka ndalesë të plotfuqishme kryerjen e profesionit,aktivitet ose detyrë origjinal ose fotokopje të noterizuar;**
- **Diplomë ose Certifikatë që ka përfunduar arsimin e lartë me sukses mesatar origjinal ose fotokopje të noterizuar**
- **Certifikatë se e ka kryer provimin shtetëror origjinal ose fotokopje të noterizuar**
- **Dëshmi për njohurin e njërës prej gjuhëve më tepër të përdorura në EU-anglisht,frëngjisht,gjermanisht;**
- **Certifikatë pune për programe kompjuterike;**
- **Kandidatët te cilët kanë kryer arsimin jashtë shtetit duhet të dorëzojnë**
- **Nostifikim diplome me arsim të përshtatshëm;**
- **Dokument për ekuivalencën e vlerësimit të lëshuar nga Ministria e Arsimit;**

Koha e përditshme e punës prej 8 orësh(në ndërrime sipas orarit të përcaktuar nga punëdhënësi) përndryshe 40 orë pune në javë.

Aplikimin me dokumentet e nevojshme të dorëzohen te arkivi i I.SH.P Sitali i Përgjithshëm Strugë kej 8-Noemvri p.n Strugë me etiketë për shpallje publike për punësim, në afat prej 5 ditësh,llogaritur nga data e shpalljes publike në gazetat zyrtare ,,Sloboden peçat,,dhe ,,Koha,,.

Aplikimet që nuk janë të kompletuara dhe që nuk janë dorëzuar në kohë nuk do të shqyrtohen prej komisionit për selektimin e kandidatëve.

Përzgjedhja e kandidatëve do të kryhet sipas nenit 160 dhe nenit 161 prej ligjit për kujdes shëndetësor.

Për përzgjedhjen e bërë të gjithë kandidatët do të njoftohen.

I.SH.P Sitali i Përgjithshëm Strugë

INSTITUCIONI PUBLIK KOMUNAL PËR FËMIJË – ÇERDHJA PËR FËMIJË
"DIMÇE MIRÇEV" – VELES PUBLIKON

SHPALLJE
PËR PRANIM TË PUNËTORIT PËR KOHË TË PACAKTUAR

1.IPKÇF "Dimçe Mirçev" – Veles ka nevojë për punësim për **orar të plotë të punës për kohë TË PACAKTUAR me orar të plotë të punës** edhe atë:

- EDUKATOR PËR FËMIJËT E MOSHËS PREJ 2 – 6 VJEÇARE..... 1 (NJË) realizues;

2. Kushtet e nevojshme:
Krahas kushteve të përgjithshme të parapara me LMP, Ligjin për të punësuarit në sektorin publik dhe Ligjin për mbrojtje të fëmijëve, kandidatët duhet të përmbushin edhe kushtet në vijim:

Për vendin e punës edukator: Profesor i diplomuar për edukim parashkollor, edukator i diplomuar të fëmijëve të moshës parashkollore dhe pedagog i diplomuar për edukim parashkollor – me 240 kredi të arritura sipas SETK ose arsim sipëror të mbaruar shkalla e VII/1 ose arsim të mbaruar përkatës të lartë për edukator dhe licencë valide për edukator; Orari i punës – javor 40 orë prej ditës së hënë deri ditën e premte, orari ditor i punës prej ora 07,00 -13,00, Neto pagesa fillestare: Me arsim sipëror...20.524,00; me arsim të lartë...19.400,00 denarë.

Krahas kushteve të lartpërmendura, kandidatët duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim: **Shtetas i RM, i shëndosh fizikisht dhe psiqikisht, njeh gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik, të mos i jetë shqiptuar dënim ose sanksion kundërvajtje-ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, të mos i jetë shqiptuar dënim me vendim të plotfuqishëm gjyqësor me të cilën dënohet për vepër penale për dhunë familjare, marrje të personit të mitur ose abuzim farefisnor, për vepër penale të grupit të veprave kundër lirisë gjinore, pavarësisht sanksionit të shqiptuar dhe tek i cili në pajtim me ligjin është përcaktuar sjellje diskriminuese dhe të përmbushë kushte të tjera të përcaktuara në aktin për sistematizim të vendeve të punës.**

3. Shpallja zgjatë **5 (pesë) ditë pune** nga dita e publikimit në shtypin ditor, ndërsa zgjedhja do të realizohet në afat prej 15 ditëve, pas kalimit të afatit për paraqitje.

4. Së bashku me fletëparaqitjen, të parashtrohet: diploma për arsimin e mbaruar përkatës në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter, licencë përkatëse valide në origjinal, certifikatë të shtetësisë, dëshmi për masë të pashqiptuar për siguri nga Regjistri qendror dhe dëshmi se nuk është i dënuar nga Gjykata themelore jo më të vjetra se 6 (gjashtë) muaj.

5. Dokumentacioni i kompletuar me fletëparaqitjen të parashtrohen në adresën: **IPKÇF "DIMÇE MIRÇEV" rr. Todor Hristov – Ificerçeto" nr. 1 në Veles, nr. i telefonit 043/231-226, personi për kontakt: Aco Petrushevski.**

UD DREJTOR
Branisllava Naceva

URGJENTISHT

Shitet shtëpi në lagjen Serava-Shkup në rr. "7 korriku" nr. 8 afër spitalit gjinekologjik, shtëpia është e ndërtimit të ri me dokumentacion të kompletuar. Kontakt tel. 071 372 221

Urgjentisht shitet shtëpi në rr. Pere Toshev nr. 30 - Xhon Kenedi, Shkup me sipërfaqe prej 140 m2 oborr dhe 116m2 objekt banimi. Kontakt telefoni 072/643 093

MAQEDONIA GATI PËR TAKIMIN NDAJ LIHTENSHTAJNIT

KËRKOHET FITORJA E TRETË

Reprezentacioni i Maqedonisë të shtunën me fillim prej ora 20:45 në stadiumin "Filipi i Dytë" në Shkup do të zhvillon ndeshjen e tretë në grup në kuadër të Ligës së Kombeve përballë Lihtenshtajnit

Koha Fisnik NUHIU

Shkup, 12 tetor - Të shtunën në mbrëmje me fillim prej ora 20:45 në stadiumin "Filipi i Dytë" në Shkup, reprezentacioni i Maqedonisë në futboll do të zhvillon ndeshjen e tretë në grup në kuadër të Ligës së Kombeve përballë Lihtenshtajnit të cilët janë konkurrenti kryesor i Maqedonisë në grupin D. Të përzgjedhurit e trajnerit Igor Angelovski në dy takimet e zhvilluara kanë arritur të marrin pikët maksimale. Maqedonia në këtë përballje futet për tre pikët e reja pasi në rast se pëson disfatë do të kishte rrezikuar vendin e para në grup. Edhe pse nuk është detyra e tij kryesore për të shënuar gola, mbrojtësi i Shkëndijës, Visar Musliu në takimin e zhvilluar vitin e kaluar përballë Lihtenshtajnin në fitoren 4:0, kishte shënuar një nga katër golat. Ai pret që edhe në ndeshjen e të shtunës të ndihmojë ekipin drejt fitores së radhës, e pse jo edhe për të gjetur rrjetën. "Shpresoj se do të kemi mundësi që përsëri të shënoj ndaj Lihtenshtajnit, por më e rëndësishmja është që të marrim tre pikët e reja. Gjatë këtyre ditëve jemi përgatitur me intensitet të lartë, jemi të përgatitur maksimalisht, gjithashtu kemi analizuar kundërshtarin për ti gjetur pikat e dobëta për ta pasur më lehtë në ndeshje. Kundërshtarë të lehtë nuk ka në futbollin e sotëm, vitin e kaluar kemi luajtur dhe i kemi fituar me rezultat 4-0, në letër dukej rezultat i thellë, por në fushë disi në fillim e patëm më vështirë, edhe pse loja prej lojës dallon shpresoj që me dhënien e maksimumit dhe koncetrim maksimal mund të arrijmë deri te tre pikët. Shpresoj të më jepet rasti, por kryesorja është që tre pikët të ngelin në Maqedoni. Kemi nisur mjaftë mirë, duke shënuar dy fitore në dy ndeshjet e para. Shpresoj të vazhdojmë me këtë ritëm dhe të fitojmë vendin e parë në grup", ka deklaruar Visar Musliu. Edhe futbollisti Kire Ristevski është i disponushëm për përballjen ndaj Lihtenshtajnit. Ai pret që gjithçka të shkojë sipas planit dhe në fund ti gëzohen fitores së tretë me radhë . "Në grup kemi një atmosferë të mrekullueshme, e gjithë kjo për faktin se nuk kemi asnjë problem me lëndimet. Po përgatitemi maksimalisht dhe mendojë se jemi të gatshëm për takimin ndaj Lihtenshtajnit. Neve duhet të dëshmojnë se jemi favorit dhe të arrijmë që të marrim tre pikët e reja dhe më pas të mendojmë për takimin ndaj Armenisë ku dhe mund të vendoset lideri i grupit D", deklaroi Kire Ristevski.

Po abuzohet me emrin tim, ja pse nuk luaj te Anderlechti

Shpërthimi në Shqipëri, pastaj transferimi te Anderlecht, edhe pse aventura belge nuk ka nisur ashtu siç mund të priste 22-vjeçari. Në 10 ndeshje kampionat, Abazaj ka qenë vetëm një herë në stol. Është folur shumë për vështirësitë e ambientimit, por vetë futbollisti rrëfen se nuk është kështu duke zbuluar shkakun e vërtetë të mungesës së aktivizimit, gjithmonë me bindjen për të kaluar çdo vështirësi. "Siç dihet unë jam bërë pjesë e Anderlecht në merkaton e verës. Nuk kam arritur të debutojë akoma në fushën e lojës. Diçka që ka krijuar shumë polemika në media dhe gjithandej. Unë mund të them se kam qenë i pafat se në fillim të kampionatit u dëmtova. Situata do të ishte komplet ndryshe nëse unë nuk do të isha dëmtuar, pasi këtë gjë e kisha demonstruar gjatë fazës përgatitore. Por futbolli kështu është, herë është me fat dhe herë është pa fat. Shpresoj të rikthehem sa më shpejtë", ka deklaruar Abazaj. Kristal Abazaj duket i vendosur për të dhënë maksimumin, ndien besimin e klubit, edhe pse të gjithë pyesin se kur do ta shohim në fushë me Anderlecht. "Aktualisht asgjë çfarë flitet lart e poshtë nuk është e vërtetë. Unë nuk bëj stërvitje me asnjë ekip tjetër, veç skuadrës së Anderlecht dhe siç dihet unë jam i dëmtuar dhe kam dy javë kohë rikuperimi dhe më pas unë besoj se shansi im do jepet. Unë do vazhdoj të punoj fortë dhe të arrij të paktën të debutoj sa më shpejtë", ka theksuar Abazaj.

Kosova vijon të magjepsë, por Challandes është i shqetësuar

Pak minuta tronditje, por shumë karakter dhe klas dhe Kosova ka hequr qafe Maltën, duke fituar 3-1 në sfidën e Ligës së Kombeve luajtur në Prishtinë, të enjten në mbrëmje. Një paraqitje e shkëlqyer në aspektin sulmues, me raste të shumta për gol, por edhe një gol naiv i pësuar nga një rival që rrallë sulmoi. Për këtë arsye, trajneri i Kosovës, Bernard Challandes, është i shqetësuar dhe kërkon mbrojtës për të ardhmen. "Tani kemi krijuar një identitet dhe po luajmë futboll të bukur, përgëzoj ekipin, edhe pse duhet t'i mbyllim ndeshjet kur krijojmë aq shumë raste. Pati shumë topa brenda zonës, por mungoi instikti vrasës para golit. Ka shpresë për të ardhmen, por ndeshja e ardhshme ndaj Ishujve Faroe do të jetë shumë e vështirë. "Zhegrova ishte shumë mirë në përballjen e sotme. Problemi është se nuk kemi shumë mbrojtës, jemi në kërkim të dy mbrojtësve", ka deklaruar Challandes, i cili e ka nisur në mënyrë perfekte aventurën te Kosova, sepse ka regjistruar pesë fitore dhe një barazim në 6 ndeshje që ka drejtuar deri tani, me golaverazhin impresionues 11-1.

DILEMAT E PANUCCIT DHE RRESHTIMI QË BËHET KAMELEON PREJ DY MUNGESASH

"Dëmtimet dhe mungesat më kanë detyruar që të aplikoj një rreshtim 3-5-2 dhe shpesh 4-5-1, por skema ime, ajo me të cilën kam nisur te Shqipëria mbetet 4-3-3". Kështu do të shprehej pas barazimit ndaj Jordanisë, trajneri i Shqipërisë, Christian Panucci. i pyetur për mënyrën e rreshtimit taktik dhe skemës së përdorur gjatë këtyre ndeshjeve të fundit dhe nëse do të ripropozohej, italiani la për të kuptuar se nëse nuk rikuperon të gjithë, vështirë të ketë një inversion. Sigurisht, nuk gënjen kur thotë se filozofia e tij është pikërisht rreshtimi me katër mbrojtës, tre mesfushorë dhe tre sulmues, dy nga të cilët, ato që veprojnë në krahë, bëjnë edhe rolin e mesfushorëve të tërhequr. Aventura e pasuesit të De Biasi-t te Shqipëria do të niste pikërisht me një 4-3-3, përballë Lihtenshtejnit, në eliminatoret e Botërorit 2018. Ishte 2 shtatori i vitit 2017 kur në "Elbasan Arena" do të fitonim 2-0. Kuqezinjtë zbritën në fushë me këtë formacion: Berisha, Agolli, Mavraj, Hysaj, Ajeti, Abrashi, Roshi, Basha, Memushaj, Llullaku dhe Grezda. Nuk kishte një sulmues të mirfilltë, me Llullakun që provoi ta bënte. Nga 4-3-3 te një 4-4-2 në sfidën ndaj Maqedonisë dhe Spanjës. Një skemë e cila do të fortifikohej në mendimet e Panucci-t, që megjithatë vazhdonte të mendonte për 4-3-3. E megjithatë ndaj Italisë, në "Loro Borici" të Shkodrës, ndeshja e fundit e eliminatoreve të Botërorit 2018, në fushë kuqezinjtë do të riktheheshin te rreshtimi tipik i De Biasi-t, 4-5-1, me Sadikun të vetëm në sulm. Më pas, sërish rikthim në identitetin e ishmbrojtësit, me miqësoren e fituar në Turqi me dhjetë lojtarë dhe rreshtimi 4-2-2, ndërsa ndaj Norvegjisë një 4-3-3 tipike, me Grezdën dhe Roshin në krahë. Pikërisht Roshi dhe Sadiku janë dy mungesat e mëdha të trajnerit, sepse përveç sulmojnë mirë hapësirat, edhe mbrojnë po aq mirë. Dy përjashtuar dy miqësoret e fundit të majit dhe qershorit, ndaj Ukrainës dhe Kosovës, sigurisht, më pas skema 3-5-2, edhe për nevojë, u aplikua sërish, ndaj Izraelit. Në Skoci

gjithashtu, duke ndjekur miqësoren me Jordaninë. Tashmë, mbetet për t'u parë se si Panucci do të vendosë për në Izrael, ku luhet ndoshta fati i grupit dhe i yni për në Europian. Sa i përket intepretuesve të rolit, sigurisht që në mendjen e Panucci-t janë titullarët: në portë Berisha, mbrojtja e përbërë nga katër me Binakun dhe Hysaj në të majtë e djathtë, Mavraj dhe Gjimshitin në qendër. Në mesfushë kthehet Basha dhe Memushaj, të suportuar nga Xhaka. Ndërsa, krahët janë Grezda në të majtë dhe Gavazaj në të djathtë. Në sulm, i vetëm, Bekim Balaj, për momentin, pasi Manaj duket ende jo gati për të tilla ndeshje me presion.

Valter Zenga, "Spidermani" rikthehet në stol si trajner

Aventura e Stefano Vecchi në stolin e Venecias tashmë ka përfunduar. Katër pikët e grumbulluara në gjashtë javët e para të Seria B janë shumë pak për presidentin Tacopina. Një fitore e vetme, një barazimi dhe katër humbje, kanë dërguar në këtë vendim, për të shkarkuar trajnerin. Por, ajo që e ka precipituar situatën, sipas "Sky Sport", ka qenë humbja në Perugia. Pa vonesa është vazhduar për ndryshimin e stafit teknik. Për trajnerin e ri, tani mungon vetëm zyrtarizimi. Në stolin e Venecias do të vijë një interist i vjetër: Walter Zenga. Ish-portieri i njohur i Italisë është i gatshëm ta rinisë karrierën në trajning nga Seria B, pas ndërprerjes së sezonit të kaluar, me Crotone. Trajneri i ri duhet të arrijë sot dhe pritet të drejtojë stërvitjen e parë, në orën 15:00. Pra, "Spiderman" është gati të kthehet në stol.

NGA MODRIC TE PAQUETA, AUSILIO TREGON STRATEGJINË E INTERIT

Drejtori sportiv i Interit, Piero Ausilio ka zbuluar plane për bisedime të reja me Marcelo Brozovic dhe Mauro Icardi për të rinovuar kontratat

Drejtori sportiv i Interit, Piero Ausilio, ka qenë i pranishëm të enjten në mbrëmje në një event ku u prezantua libri i shefit të stafit mjekësor të Interit, Piero Volpi, "Medico del calcio". Me atë rast, Ausilio foli për gazetarët, duke lëshuar deklarata interesante edhe për merkaton

Derbi - "Interi është i vetëdijshëm për punën që po kryen, objektivi i sezonit të shkuar u arrit. Nëse Milani është i vetëdijshëm për forcën e vet, imagjinoni ne, që po luajmë në maksimum në çdo kompeticion. Skuadra e javëve të fundit është baza për të ndërtuar një formacion edhe më të fortë. Kemi 6-7 lojtarë të rinj, ishte normale që të hasnim disa vështirësi fillimisht. Tani po përmirësohemi dhe po tregojmë cilësinë që ka skuadra, ndaj duam të rritemi edhe më shujmë, duke nisur nga derbi".

Brozovic, D'ambrosio e Vrsaljko - "Kanë qëndruar në Milano për të punuar, për Vrsaljko kemi pasur një bashkëpunim të mirë me Kroacinë. Brozovic po rikuperoj, ndërsa D'Ambrosio ka një problem në gju, por nuk është diçka serioze".

Keita - "Të gjithë mund të përmirësohen. Ai vjen nga Botërori, i duhet pak kohë për të rigjetur formën perfekte, sepse erdhi në ditët e fundit të merkatos dhe nuk ishte shumë mirë. Jam i bindur që do rezultojë një blerje e shkëlqyer, e kemi studiuar mirë".

Icardi - "Spalletti nuk ka nevojë për dhurata, sepse ka edhe 3 vite kontratë dhe nuk përjashtohet të vazhdojmë më gjatë. Rinovimi i Icardi-t? Duam t'ia rinovojmë dhe përmirësojmë kontratën, kemi gjetur bashkëpunim dhe koha është mëse e mjaftueshme, duke parë që Icardi ka edhe 3 vite kontratë. Brozovic? Rinovimi i tij është thuajse çështje e kryer".

Paqueta' te Milani - "Ne jemi në fazën e vëzhgimit të talenteve, si gjithmonë. Po punojmë shumë me skautingun, nëse do kemi mundësinë të përmirësojmë skuadrën në janar, do të veprojmë, sepse pronarët e klubit janë shumë të ndjeshëm në këtë drejtim".

Modric - "Jo, në janar është e pamundur. Shohim edhe merkaton e lojtarëve në fund kontrate dhe e dimë ku të kërkojmë, por kryesorja për merkaton e ardhshme do të jetë cilësia".

Hazard do të ishte zëvendësuesi i duhur i Ronaldos te Reali

Rivaldo ka thënë se Eden Hazard është një lojtar spektakolar dhe se belgu do të ishte transferimi i duhur i Real Madridit si zëvendësim për Cristiano Ronaldon, i cili u largua drejt Juventusit gjatë afatit kalimtar të verës. Pa Ronaldon, i cili tani gjendet në Serie A, madrilenët kanë vuajt në sulm gjatë edicionit të ri, duke mos e gjetur golin në katër ndeshjet e fundit. Rivaldo, i cili kishte shkëlqyer në La Liga me Barcelonën, thotë se Hazard do të ishte zëvendësuesi ideal i Ronaldos. Sulmuesi i Chelseat së fundmi kishte deklaruar se transferimin i tij te Real Madridi është një ëndërr për të. "Sulmuesi belg është një lojtar i madh dhe mund të jetë një opsion shumë i mirë për klubin e tij të ëndrrave, Real Madridin ën afatin e ardhshëm kalimtar. Hazard ka shkëlqyer me Belgjikën në Kupën e Botës dhe gjithashtu e ka nisur shumë mirë sezonin e ri në Premierligë", deklaroi Rivaldo. "Kjo lloj lëvizje di të ishte e mirë për klubin dhe tifozët sepse arritja e një lojtari të madh do të jepte një shtytje të nevojshme pas largimit të Cristiano Ronaldos", shtoi braziliani.

Roma gati t'i blindojë Dzekon dhe Underin

Edin Dzeko dhe Cengiz Under duket se do të vazhdojnë edhe për shumë vite të jenë pjesë e Romës. Skuadra italiane pas një starti jo të mirë iu është kthyer fitoreve në kampionat dhe në Ligën e Kampionëve. Giallorosët janë futur në bisedime me dy yjet e skuadrës, Edin Dzekon dhe Cengiz Underin për vazhdimin e kontratave. Sulmuesit boshnjak i skadon kontrata me Romën në verën e vitit 2020. Por drejtori sportiv i Romës, Monchi i ka ofruar atij kontratë të re deri në vitin 2022. Dzeko me kontratën e re do të ketë rrogë prej 4,5 milionë euro të njëjtë sa aktualen por me bonuse më të mëdha. Në anën tjetër Giallorosët janë duke synuar ta bllokojnë edhe talentin turk Cengiz Under. 21-vjeçari ka shkëlqyer me fanellën e Romës, por kryeqytetasit dëshirojnë ta blindojnë atë. Bayern Munich, Arsenal dhe Chelsea janë interesuar për lojtarin dhe kjo ka bërë që Roma pritet ta blindojë atë. Verdh e kuqtë pritet t'ia vazhdojnë Underit kontratën deri në vitin 2023 ku pritet edhe rritje e ndjeshme e pagës.

Publicitet

SHMTE në Qytetin e Shkupit "Mihajlo Pupin" Shkup publikon

SH P A LL J E

Për dhënie me qira të hapësirës përmes ankandin publik

1. Tri vend të oborrit me sipërfaqe prej 30m2 për vendosjen e objektit për shitje të sandviçëve, me çmim fillestar prej 308,00 denarë për m2 pa përshirë TVSH-në
2. Hapësirë magazine me sipërfaqe totale prej 300m2,me çmim fillestar prej 18.450,00 denarë pa TVSH.
3. Salle e madhe e fizkulturës – jepet me qira për rekreacion pas përfundimit të orëve në shkollë me çmim fillestar 1.400,00 denarë për një orë gjysmë pa TVSH.
4. Salle e vogël e fizkulturës – jepet me qera për rekreacion pas përfundimit të orëve në shkollë me çmim fillestar 820,00 denarë për një orë gjysmë pa TVSH.
5. Hapësirat shkollore jepem me qira 01.09.2019.

Ankandi publik për pikën 1, 2, 3 dhe 4 do të mbahet me datë 29.10.2018 (të hënën) në ora 12:00 në hapësirat e SHMTE në Qytetin e Shkupit "Mihajlo Pupin" Shkup në rrugën "Blagoja Stefkovski" pn. Pjesëmarrësit në ankandin publik nën numër 1 dhe 2 të sjellin me vete dhe regjistrimin e veprimtarisë jo më të vjetër se 6 muaj.

Ronaldo, i gatshëm të dëshmojë mbi akuzat për përdhunim

Cristiano Ronaldo mund të japë versionin e tij të historisë së vitit 2009. Nga Portugalia, ai siguroi gatishmërinë për t'iu përgjigjur pyetjeve të oficerëve të policisë së Las Vegas-it, të cilët po hetojnë pas denoncimit të Kathryn Mayorga, e cila e konsideron veten viktimë të përdhunimit nga CR7, nëntë vite më parë. Natyrisht, ylli portugez nuk ka ndërmend të fluturojë për në Las Vegas, sepse nuk ka kohë fizike për të tilla udhëtime interkontinentale, por është gati të merret në pyetje përmes video-konferencës nga Italia. Ronaldo ka kërkuar leje për të mos qenë edhe në kombëtare për këtë vit, duke parë axhendën e ngjeshur me Juventusin. Madje, edhe në këtë stuhi akuzash mediatike të rënda për përdhunim, numri 7 po teston fuqinë mendore. Cristiano Ronaldo mbetet i fokusuar në punët e fushës së blertë. Avokati i Mayorga, megjithatë, nuk do të përjashtonte thirrjen për të dëshmuar edhe të tjerët, që e shoqëronin pesë herë fituesin e "Topit të Artë" në netët e Las Vegasit.

DASHI — **21. mars - 20. prill**

Po përballeni me një rrugëtim të vështirë por të mbushur me eksperienca dhe mundësi të pafundme. Jini luftarakë dhe mos u dorëzoni përpara kundërshtarëve! Intuita do ju ndihmojë.

DEMI — **21. prill - 21. maj**

Kjo ditë është mjaft e favorshme për të ngadalësuar ritmet frenetike dhe për të shijuar më shumë momentin, sidomos në dashuri dhe në familje, ku së fundmi jeni ndjerë të lënë pas dore. Kjo e premte favorizon takimet dhe dashurinë.

BINJAKET — **22. maj - 21. qershor**

Keni marrë përsipër një rol me shumë përgjegjësi dhe kjo gjë do ju lejojë që të siguroni më shumë autoritet. Megjithatë do të jeni shumë të përqendruar, për shkak se të papriturat janë në qoshe. Kjo e premte parashikon përballje të rëndësishme me familjen ose partnerin/en.

GAFORRJA — **22. qershor - 22. korrik**

Duhet të merrni vendime të rëndësishme për karrierën tuaj aktuale. Ka disa ndryshime, të cilat ju kanë futur në krizë, por gjithçka për shkak se ndryshimi ju tremb. Jini më kurajoz dhe hidhuni në lojë, duke mos lënë pas dore ambiciet tuaja.

LUANI — **23. korrik - 22. gusht**

Kjo e premte do të jetë mjaft e ngjeshur dhe stresuese, por gjithsesi mos u vini nën presion, sidomos sa i takon çështjeve të biznesit. Në dashuri parashikohet të ketë momente tensioni, të cilat do të zgjidhen pa shumë mundim. Por duhet të jeni ju që të hidhni ju hapin e parë.

VIRGJERESHA — **23. gusht - 23. shtator**

Merrni një moment pushimi, për të dalë nga rutina frenetike. Ka disa keqkuptime, ankth dhe tensione të cilat rrezikojnë që t'iu vendosin në vështirësi sidomos në vendin e punës. Nga pikëpamja sentimentale, parashikohet një ditë pasionante.

PESHORJA — **24. shtator - 23. tetor**

Do të jeni të frymëzuar nga një situatë e përditshme e cila do ju lejojë që të arrini diçka më shumë lidhur me një projekt të rëndësishëm. Në raportet familjare mos u tregoni të largët, por shfaqini ndjenjat tuaja.

AKREPI — **24. tetor - 22. nëntor**

Kjo e premte ju fton që të jeni më pak provokues dhe ngacmues, sidomos në dashuri. Provokimi i partnerit/es tuaj, mund të jetë një strategji aspak e frytshme. Dita mundëson kurorëzimin e një çështje me shumë rëndësi.

SHIGJETARI — **23. nëntor - 21. dhjetor**

Dita do të jetë mjaft interesante për të kaluar çdo keqkuptim me të cilin jeni përballur së fundmi dhe që nuk ju ka lejuar të jeni të qetë. Harmonia dhe bashkëpunimi që keni krijuar do të forcojë një lidhje sentimentale, shkruan noa.al. Këshillohet që të jeni më të matur lidhur me shpenzimet.

BRICJAPI — **22. dhjetor - 20. janar**

Parashikohen zhvillime vendimtare lidhur me raportet ndërpersonale. Do të rivlerësoni totalisht pritshmëritë tuaja, të cilat do të favorizojnë ndryshimet. Do të ketë zhvillime interesante për të gjithë ata që janë në kërkim të pikave të reja të referimit. Mjaft të favorizuara janë historitë e nisura prej kohësh, megjithatë duhet të jeni më të kujdesshëm me mënyrën se si shpreheni.

UJORI — **21. janar - 19. shkurt**

Mos u përfshini nga shqetësimet e të tjerëve, pasi në të kundërt rrezikoni vetëm që të humbni kohë dhe energji. Horoskopi i kësaj dite ju fton që të jeni më të qartë dhe të drejtpërdrejtë, në mënyrë që të shmangni keqkuptimet.

PESHQIT — **20. shkurt - 20. mars**

Mos u kushtëzoni nga kritikat apo të papriturat me të cilat do të përballeni në rrugën tuaj. Duhet të jeni të vëmendshëm në realizimin e një projekti të ri, pasi ka ardhur momenti të cilin e prisnit prej kohësh. Në dashuri do të jetoni momente stabiliteti.



FJALËKRYQ KLASIK



HORIZONTALISHT: **1.** Popull nomad në Etiopi; **4.** Qafëz e një veshjeje (shq.); **8.** Elipsoid; **9.** Vullkan aktiv në Itali; **11.** Mbretëreshë ilire; **13.** Aktorja australiane, Kidman; **14.** Aktori, Shvarceneger; **16.** Njolla; **17.** Natrium; **18.** Një sport në akull (shq.); **20.** Zero, oksigjen; **21.** Bën gam-gam, leh; **22.** S. Ll.; **24.** Kënge lirike dashurie arabo-persiane; **25.** Perëndi e egjiptasve, themelues i botës; **26.** Kryetar i një manastiri të murgjëve ortodoksë; **28.** Pjesë e fotoaparatit; **29.** Element radioaktiv (U); **30.** Banor i Trakisë.

VERTIKALISHT: **1.** Liqe në Itali; **2.** Shtazëria (zool.); **3.** Zë i ulët e i thellë i grave; **4.** Monedhë e Japonisë; **5.** Shtëpi e pleqëve (shum.); **6.** Shkrimtari jonë, Rifat; **7.** Që ka të bëjë me aforizmin; **8.** Lumë në Rusi; **10.** Institut i lartë i arteve (shkurt.); **12.** Shkencëtar arab (965-1039); **15.** Fushë e veprimtarisë së njerëzve; **19.** Shtet në Amerikën Jug. (Pashq.); **20.** Liqe në Francë; **21.** Shkornjë greke; **23.** Djalë që ndihmon muratorin; **24.** Shkëmb; **25.** Qytet në Argentinë; **27.** Gram, uran; **28.** Brom.

ZGJIDHJET: D, MARTINA, SHAR, EMIRAT, ROLO, GATIM, MATEM, AN, MEMBRANA, ANET, TAI, FTOHËSE, O, LARIM, KREM, VR, SERUM, I, DOLLAR, TAJ, LUK, RK, PIRO, MOTOSKAF, TUBI, LINDOR, UEA, DENDURI, ASTER, AKUT, REISYL-ULEMA. ***FJALËKR. KLASIK:*** AFAR, JAKA, OVAL, VEZUFI, TEUTA, NIKOL, ARNOLD, LARA, NA, HOKEJI, OO, GAMIT, SLL, R, GAZEL, PTA, IGUMEN, BLIC, URAN, TRAK.

NJERIU NJEH MESATARISHT 5 MIJË PERSONA

Nga familja e miqtë dhe deri te të huajt në tramvaj e te personalitetet nga ekranet e vogla, njerëzit njohin 5000 mijë veta, kanë publikuar shkencëtarët. Njerëzit në pjesën më të madhe të historisë kanë jetuar në grupe të vogla shoqërore, ndërsa në shekujt e fundit kjo ka ndryshuar shumë.

Shkencëtarët nga Universiteti i Yorkut me një hulumtim kanë zbuluar se njerëzit kanë aftësi të njohjes së mijëra personave që nga rrethi i tyre deri tek ata nga televizioni. "Jemi mësuar çdo ditë, që sipas pamjes, t'i njohim miqtë, kolegët, personalitetet e njohura dhe shumë të tjerë", thotë psikologu Rob Jonckins nga ky universitet. "Porse deri më tash askush s'e ka konstatuar se sa njerëz vërtetë i njohim dhe i mbajmë ndër mend".

Për ta gjetur këtë, ai dhe kolegët e tij bënë studimin se sa veta mund t'i njohë një njeri dhe ata konstatuan se njeriu mesatarisht njeh 5 mijë persona. Hulumtimi është publikuar në revistën Proceedings of the Royal Society B.

Ndalohen pantallonat e shkurtra, kompania ajrore lë në tokë pasagjerin

Një biznesmen u refuzua nga një kompani ajrore për shkak se ishte veshur me pantallona të shkurtra, teksa ishte nisur për një fluturim me Saudi Arabian Airlines. Jordan Bishop, themelues dhe këshilltar i fluturimeve 'Yore Oyster', shpjegoi në një artikull për revistën 'Forbes' se u bllokua nga një pjesëtar i stafit të kompanisë ajrore, duke iu thënë se nuk lejohej të ngjitej në avion nëse nuk mbulonte këmbët. Atij ju shpjegua se nuk mund të udhëtonte nga Stambolli, Turqi, drejt Riyadh, kryeqytet i Arabisë Saudite. Bishop shpjegoi se ishte një udhëtar i rregullt dhe se veshja e tij nuk i kishte hapur asnjëherë probleme. Por Saudia Dress Code nëpërmjet një deklarate tha se Saudia iu kërkon mysafirëve të saj që të respektojnë kodin e veshjes, në bazë të së cilit dihet të jenë të veshur në përputhje me normat e publikut dhe jo të fyejnë pasagjerë të tjerë.
Saudia është kompania ajrore kombëtare e Arabisë Suadite, e cila ruan me fanatizëm udhëzimet e islamit. Kështu Bishop u detyrua të blejë një sarong, një copë e gjerë që përdoret si fund, të cilin e lidhi rreth mesit në mënyrë që të udhëtonte.

Përse zogjtë përplasen me motorin e majtë të avionëve

Zbulohet se në pjesën më të madhe të rasteve zogjtë përplasen me motorin e majtë të avionëve. Dhe kjo nuk është rastësore. Duket se zogjtë janë të tërhequr nga ngjyra e kuqe dhe pikërisht në anën e majtë të avionëve ndodhet drita e navigimit. Ky konkluzion i rëndësishëm është arritur pas punës kërkimore dhe statistikore të një eksperti të aksidenteve ajrore Richard Dolbeer. Ai ka analizuar 9000 episode të incidenteve ajrore të shkaktuara pikërisht nga impakti i zogjve me mjetin fluturues. Rezultatet konsiderohen mjaft të rëndësishme pasi tani u kuptua shkaku dhe mund të merren masat për ndryshimin e normave të sigurisë ajrore.

Kërkuesit thonë se mund modifikohen edhe dritat e kuqe që përdoren aktualisht në aeroporte dhe të përdoret një ngjyrë e ftohtë. Deri më sot nga incidentet ajrore pas impaktit me zogj kanë humbur jetën 350 persona nga radhët e ushtrisë dhe 250 civilë.

Kung Fu ndikon në gjendjen shpirtërore

Kung-Fu rivlerësohet në botën perëndimore. Nuk është vetëm një art marcial, por edhe një filozofi jete, pasi është një praktikë që ndihmon të punosh me veten, duke nisur nga analiza e ndjesive personale. Dhe mbi të gjitha, sipas ekspertëve, ndihmon në krijimin e një distance vetëmbrojtëse në betejat emocionale të përditshmërisë.

Sipas konferencierit dhe business coach Bernhard Moestl, kush nuk arrin të kontrollojë emocionet, atëherë ka humbur luftën para se të kuptojë arsyen e saj. Ai ka kaluar një vit me monakët në Kinë, një eksperiencë që i ka shërbyer në mësime jete. Motivimin e ka gjetur gjatë bashkëjetesës në vendin e Lindjes së largët, dhe eksperti thotë se një ndër emocionet më shqetësuese dhe të padëshiruara të shoqërisë sonë frenetike është zemërimi.

Dhe sipas Moestl, arti i luftimit sot është shumë aktual, por më tepër ai i mendjes sesa ai fizik. Dhe në këtë plan, shtron edhe artin antik të Kung Fu-së, që sipas eksperiencës së jetuar në Kinë, i jep një tjetër dimension dhe rëndësi.

KALENDARI HISTORIK 13 TETOR

54 - Neroni hip në fronin e Romës.
1307 - Mbreti francez Filipi IV akuzon templarët për shkak të herezisë.
1702 - Trupat angleze dhe holandeze okupojnë Luikun.
1760 - Ushtria ruse dhe austriake evakuojnë Berlinin.
1845 - Teksasi ratifikon kushtetutën e shtetit.
1862 - Fjalimi i Bismarkut "Gjak dhe Hekur".
1914 - Garrett Morgan shpikë dhe patenton maskën kundër gasit.
1923 - Angora (Ankara) shpallet kryeqytet i Turqisë.
1924 - Vehabistët nën Ibn Saudin marrin Mekën.
1944 - Çlirohet Riga në Latvi.
1960 - Nikita Khrushchev (kryeministri i BRSS) përplasë këpucën e tij në tavolinë në OKB.
1960 - Ekzekutohet oponentët e Fidel Kastros në Kubë.
1981 - Hosni Mubarak zgjidhet kryetar i Egjiptit.

A E DINI SE...

253 MILIONË NJERËZ ME PROBLEME SHIKIMI

Rritet numri i personave me probleme me shikimin në mbarë botën. Shkak duket se janë orët e tepërta para monitorit të kompjuterëve, telefonave e pajisjeve të tjera teknologjike. Sipas OBSH, aktualisht numërohen 253 milionë njerëzit që kanë problem me shikimin, ndër të cilët 36 milionë janë të verbër. Dhe me këto ritme mendohet se brenda vitit 2050 gjysma e popullsisë globale do të jetë e prekur nga miopia. Ekspertët ngrenë shqetësimin se problem kryesor është rritja e numrit të fëmijëve me probleme të tilla, si pasojë e përdorimit të tepruar të teknologjisë dhe orëve të gjata që kalojnë në ambiente të mbyllura. Aktualisht në Evropë në moshën 9 vjeç miopia ka arritur në nivelin 12 % dhe shkon në 18% në moshën 15-vjeçare dhe sipas statistikave janë vajzat, ato më të prekura.

BARSOLETA

DY BIONDINA NË KREVAT

Kanë qenë dy biondina duke fjetur në një krevat të ngushtë. Pas pak, njëra nga biondinat bie poshtë. Tjetra menjëherë thotë: - Motra eja se u lirua një vend.

THËNIA E DITËS

Martohu, patjetër. Po të ra gruaja e mirë, do të jesh i lumtur; po të ra e keqe, do të bëhesh filozof.
(Sokrati)